



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

PUNIM MAGJISTRATURE

TEMA

Konfiskimi i dobisë pasurore e fituar me vepër penale – aspekte
krahasimore Republika e Maqedonisë me Republikën e Kosovës

Kandidati:

Arbër Alija

Mentori:

Prof.dr. Ismail Zejneli

Tetovë, 2019

PËRMBAJTJA

Lënda e hulumtimit	4
Qëllimet e studimit	4
Struktura e punimit	4
HYRJE	6

KAPITULLI I

1. KONFISKIMI DHE MARRJA E SENDEVE	8
1.1. Kuptimi i pasurisë dhe dobisë pasurore dhe rëndësia që ka në shqiptimin e masës së konfiskimit	8
1.2. Nocioni i konfiskimit	11
1.3. Natyra juridike e konfiskimit	12
1.4. Sistemet dhe llojet e konfiskimit	14
2. KONFISKIMI I PRONËS DHE DOBISË PASURORE DHE MARRJA E SENDEVE SIPAS KODIT PENAL TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË	17
2.1. Mënyra e konfiskimit	19
2.2. Kërkesa pasurore e të dëmtuarit dhe mbrojtja e të dëmtuarit	21
2.3. Konfiskimi i zgjeruar	22
2.4. Konfiskimi nga personat juridikë	24
2.5. Marrja e sendeve	25

KAPITULLI II

1. KONFISKIMI I PASURISË DHE DOBISË PASURORE DHE MARRJA E SENDEVE SIPAS LIGJIT PËR PROCEDURË PENALE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË	27
1.1. Sigurimi dhe marrja e pëkohshme e sendeve ose pronës	28
1.2. Konfiskimi i përkohshëm i pasurisë ose sendeve	33
1.3. Konfiskimi i pasurisë dhe dobisë pasurore dhe marrja e sendeve pas shpalljes së aktgjykimit	37
1.5. Realizimi i konfiskimit të pronës dhe dobisë pronësore	41
2. ZBATIMI I KONFISKIMIT TË PRONËS DHE DOBISË PASURORE DHE SEKUESTRIMI I SENDEVE SIPAS LIGJIT PËR EKZEKUTIMIN E SANKSIONEVE	42
2.1. Marrja e sendeve	44
3. MENAXHIMI ME PRONËN E KONFISKUAR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË	45

KAPITULLI III

KONFISKIMI I PASURISË DHE DOBISË PASURORE DHE MARRJA E SENDEVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS DHE REPUBLIKËN E SHQIPËRISË	48
1. Konfiskimi i pasurisë dhe marrja e sendeve në Republikën e Shqipërisë	48
1.1. Konfiskimi sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë	49
1.2. Sekuestrimet sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë	49
1.3. Konfiskimi dhe sekuestrimi sipas Ligji për krimin e organizuar dhe Anti mafia ..	51
2. Konfiskimi i pasurisë dhe marrja e sendeve në Republikën e Kosovës	52
2.1. Konfiskimi sipas Kodit penal të Republikës së Kosovës	53
2.2. Konfiskimi sipas Kodit të procedurës penale të Kosovës	56
2.3. Konfiskimi sipas Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfutur me Vepër Penale	57

KAPITULLI IV

DISA NGA AKTET NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E KONFISKIMIT DHE MARRJES SË SENDEVE	59
1. Konventa e Kombeve të bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar	60
2. Konventa europiane për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit (Konventa e Strasburgut).....	62
3. Konventa e Varshavës ose Konventa e këshillit të europës për pastrimin, depistimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe financimin e terrorizmit.....	63
4. Konventa e Kombeve të bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe të lëndëve psikotrope.....	64

KAPITULLI V

ANALIZA E TË DHËNAVE STATISTIKORE PËR MASAT E SHQIPTUARA TË KONFISKIMIT DHE MARRJES SË SENDEVE DHE DISA RASTE TË KONFISKIMIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË.....	66
1. Analiza e të dhënave statistikore nga Enti për statistika i Republikës së Maqedonisë .	66
2. Analizimi i të dhënave të Agjencionit për menaxhim me pronën e konfiskuar për periudhën 2012 - 2015.....	72
3. Disa raste të konfiskimit në Republikën e Maqedonisë	74
PËRFUNDIM.....	80
BIBLIOGRAFIA.....	84

Lënda e hulumtimit

Duke pasur parasysh arritjet e shkencës juridike si dhe rregullativën ligjore pozitive, me këtë punim synohet që të arrihet zgjerimi i njohurive dhe i pikëpamjeve teorike të konfiskimit të pasurisë dhe dobisë pasurore të fituar me vepër penale dhe marrjen e sendeve, si dhe të arriturat e shkencës juridike në këtë lëmi të së drejtës penale, por edhe rregullimi i kësaj materie në ligjet e disa shteteve të tjera. Lënda e këtij punimi ka të bëjë me përpjekjet e shteteve në luftimin e kriminalitetit të organizuar duke u bazuar në zbatimin e masave për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale dhe marrjen e sendeve

Qëllimet e studimit

Qëllimet e këtij studimi janë trajtimi teorik i konfiskimit dhe marrjes së sendeve në të drejtën penale dhe paraqitja e dispozitave të veçanta në lidhje me konfiskimin dhe marrjen e sendeve si institute të së drejtës penale në të drejtën pozitive të Republikës së Maqedonisë si dhe në të drejtën nërkombëtare. Prandaj ky studim ka për qëllim edhe analizën e zgjidhjeve ligjore të shteteve të tjera në këtë fushë dhe analizimin e disa konventave ndërkombëtare të cilat e rregullojnë këtë materie.

Struktura e punimit

Struktura e këtij punimi është ndërtuar mbi bazë të analizave dhe studimit të bibliografisë mbi konfiskimin dhe marrjen e sendeve, me çrast ky punim është ndarë në pesë pjesë, duke filluar me hyrjen dhe duke përfunduar me bibliografinë e konsultuar.

Në kapitullin e parë shtjellohet një vështrim i përgjithshëm mbi konfiskimin e pasurisë dhe dobisë pasurore dhe marrjes së sendeve, nocioni i konfiskimit, llojet dhe natyra juridike e konfiskimit dhe rregullimi i konfiskimit dhe marrjes së sendeve sipas kodit penal të Republikës së Maqedonisë.

Në kapitullin e dytë do të përfshijë rregullimin e konfiskimit të pasurisë dhe marrjes së sendeve sipas Ligjit për procedurë penale të Republikës së Maqedonisë, duke e paraqitur marrjen e përkohshme të sendeve, procedurën për marrjen e sendeve dhe të konfiskimit, marrjen e përkohshme të sendeve dhe pasurisë me qëllim të sigurimit të tyre gjatë procedurës penale, pastaj procedurën për marrjen e sendeve dhe konfiskimin e pronës dhe dobisë

pronesore të fituar me veper penale, zbatimi i konfiskimit të pronës dhe dobisë pasurore dhe marrja e sendeve sipas Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve dhe Ligjit për menaxhim me pronë të konfiskuar.

Kapitulli i tretë i këtij punimi do të përpiqet të bëjë një analizë të akteve juridike ndërkombëtare, përkatësisht konventave më të rëndësishme të cilat e rregullojnë lëminë e konfiskimit të pasurisë dhe dobisë pasurore.

Në kapitullin e katërt do të paraqitet rregullimi i konfiskimit të pasurisë dhe marrja e sendeve sipas legjislacionit të Republikës së Kosovë dhe Republikës së Shqipërisë dhe një analizë të rregullimit të kësaj materie në këto shtete.

Në kapitullin e pestë do të paraqiten disa të dhëna statistikore në lidhje me konfiskimin e pasurisë dhe dobisë pasurore dhe marrjen e sendeve në Republikën e Maqedonisë, nëpërmjet analizimit të këtyre të dhënave të marra nga raportet e Entit shtetëror për statistika për periudhën 2012-2016, pastaj të dhënat Gjykata themelore Tetovë për periudhën 2013-2017 dhe të dhënat nga raportet e Agjencionit për menaxhim me pronën e konfiskuar në periudhën 2012 – 2016 dhe në fund do të analizohen disa raste specifike të konfiskimit të Republikën e Maqedonisë.

HJRJE

Një ndër fenomenet më negative në shoqërinë bashkëkohore i cili ka pasoja shumë të rënda si për sigurinë e përgjithshme të shtetit dhe individëve ashtu edhe për ekonominë e një shteti paraqitet krimi i organizuar. Kriminaliteti si dukuri negative ka ekzistuar gjatë gjithë fazave të zhvillimit të shoqërisë njerëzore duke u paraqitur në forma të ndryshme. Por në ditët e sotme kriminaliteti paraqitet në një nivel tjetër të panjohur më parë duke qenë një kërcënim i vërtetë me fitimin e fuqisë financiare dhe politike e që paraqet edhe qëllimin kryesor të organizimit kriminal. Lufta kundër krimit të organizuar në shtetet moderne si dhe në bashkësinë ndërkombëtare paraqet një sfidë por njëkohësisht edhe prioritet të tyre në përcaktimin e politikave dhe qëllimeve për trajtimin e kësaj dukurie.

Krimi i organizuar, në një shtet të caktuar por edhe ndërkombëtarisht, arrin që të shfrytëzojë kushtet e përshtatshme për depërtimin e tij edhe në strukturat shoqërore legale dhe të përshtatet me ndonjë situatë shoqërore politike dhe ekonomike. Në strukturën e kriminalitetit që nga kohrat më të lashta e deri më sot në të drejtën tonë dhe atë ndërkombëtare, mbizotëron kriminaliteti pasuror. Prandaj ligjdhënësit e të gjitha shteteve në sistemin e sanksioneve të tyre parashohin masa të ndryshme pasurore juridiko-penale si një përgjigje efektive e shoqërisë ndaj kryerësve të këtyre veprave penale. Shtetet bashkëkohore kanë vendosur si prioritete të tyre të larta arritjen e qëllimit që kryesve të veprave penale, përkatësisht krimit të organizuar, t'iu pamundësohet përfitimi nga aktiviteti i tyre kriminal. Si masë ligjore e parashikuar për privimin e kryerësve të veprave penale nga përfitimet e paligjshme është konfiskimi i pronës dhe dobisë pasurore të fituar me veprë penale.

Konfiskimi i përkohshëm dhe i përhershëm i pasurisë së fituar me veprë penale paraqitet si një masë efektive për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar prandaj kjo masë nuk paraqet ndonjë risi në legjislacionet e shteteve moderne por ajo e ka zanafillën që nga civilizimet e më hershme në ndjenjën e individëve për t'iu hakmarrë kryerësve të veprave penale. Shumë vende dhe sisteme juridike kanë përpiluar legjislacion të përshtatshëm dhe të organizuar mirë për ngrirjen, sequestrimin dhe konfiskimin e pasurisë, si dhe vendosjen e praktikave gjyqësore të nevojshme për t'iu shërbyer kësaj agjende

Bashkëpunimi i pashmangshëm i shteteve nacionale në luftimin dhe parandalimin e krimit të organizuar ka rezultuar në sjelljen e dispozitave materiale juridike, organizative dhe procedurale në nivel ndërkombëtar, përkatësisht në sjelljen e dokumentave të shumta

ndërkombëtare që e trajtojnë çështjen e konfiskimit të pasurisë dhe dobisë pasurore të fituar me veprë penale.

Rritja e numrit të veprave penale nga të cilat kryerësit e tyre në mënyrë direkte apo indirekte përfitojnë pasuri apo dobi pasurore e imponon nevojën e parashikimit të metodave dhe masave të nevojshme me qëllim të luftimit të kriminalitetit të tillë në përgjithësi. Prandaj legjislacionet penale i kushtojnë një vëmendje të veçantë promovimit të masës së konfiskimit të pasurisë dhe dobisë pasurore të fituar me veprë penale si një sanksion i veçantë ose si një masë e veçantë ligjore. Me zbatimin e kësaj mase duhet që të arrihet qëllimi i caktuar e që është vendosja e gjendjes që ka ekzistuar para kryerjes së veprës penale dhe përcjellja e një mesazhi ndaj kryerësve të veprave penale se nuk do të mund ta mbajnë pasurinë apo dobinë pasurore të fituar me veprë penale. Kështu që pa dyshim masa e konfiskimit të pasurisë dhe dobisë pasurore të fituar me veprë penale paraqet një institut të rëndësishëm për parandalimin e kriminalitetit dhe kthimit të pasurisë së humbur të të dëmtuarve apo viktimës së veprës penale.

Në Republikën e Maqedonisë konfiskimi i pasurisë dhe dobisë pasurore dhe marrja e sendeve janë të rregulluara me Kodin penal dhe me Ligjin për procedurë penale. Ligji për ekzekutimin e sanksioneve e përcakton mënyrën e konfiskimit ndërsa Ligji për menaxhim me pronën e konfiskuar e rregullon menaxhimin, shfrytëzimin dhe disponimin me pronën e konfiskuar dhe sendet e marra me vendim të plotëfuqishëm gjyqësor. Duke u bazuar në standarde ndërkombëtare të parashikuara në aktet ndërkombëtare në fushën e konfiskimit të pronës dhe dobisë pasurore të fituar me veprë penale, Republika e Maqedonisë ka ndërmarrë disa reforma ligjore për të aplikuar zgjidhjet e akteve ndërkombëtare sa i përket marrjes së sendeve dhe konfiskimit të dobisë pasurore nga veprat penale.

Në Republikën e Kosovës si bazë juridike për konfiskim të pasurisë paraqitet Kodi penal i Kosovës dhe Ligji për procedurë penale. Ndërsa në Republikën e Shqipërisë përveç Kodit penale dhe Kodit për procedurë penale të Shqipërisë, konfiskimi bazohet në ligjin Anti-Mafia.

KAPITULLI I

1. KONFISKIMI DHE MARRJA E SENDEVE

1.1. Kuptimi i pasurisë dhe dobisë pasurore dhe rëndësia që ka në shqiptimin e masës së konfiskimit

Një prej institucioneve dhe kategorive juridike të kontestueshme dhe mjaft të ndërlikuara në të drejtën civile si shkencë pa dyshim ka qenë dhe është pasuria. Pasuria është element kyç në qarkullimin juridik dhe ekonomik. Ajo është ngushtë e lidhur me një prej parimeve mjaft të rëndësishme të së drejtës civile – parimin e sanksionit pasuror. Sot kur flasim për pasurinë shpesh herë hasim edhe në terme të tjera duke menduar se kemi të bëjmë me pasurinë. Kështu për shembull përdoret termi “pronësi” në vend të pasurisë. Në kuptimin ekonomik për pasurinë flitet edhe në ato raste kur për një person mendohet se ka vlera të mëdha ekonomike dhe nuk ka obligime të ndryshme. Në këtë kuptim kemi të bëjmë me gjendjen ekonomike të këtij personi. Mandej me pasurinë jo rrallë nënkuptohen edhe vetë sendet.¹

Derisa pasuria përbëhet prej të drejtave dhe detyrimeve të një personi, masa pasurore përbëhet prej të gjitha sendeve të të drejtave subjektive të cilat janë edhe objekt i masës pasurore. Në kornizën e masës pasurore dallohet aktiva prej pasivës. Derisa aktiva përbëhet prej të drejtave, pasiva është kategori e veçantë e cila përbëhet prej obligimeve.²

Në kodin penal të Republikës së Maqedonisë³, në pjesën e përgjithshme ku shpjegohen shprehjet e kodit penal jepet edhe definicioni i pasurisë. Sipas kodit penal të Republikës së Maqedonisë me pasuri nënkuptojmë të holla ose instrumente tjera pagese, letra me vlerë, depozite, pronë tjetër e çdo lloji dhe atë materiale ose jomateriale, e tundshme apo e patundshme, të drejta të tjera mbi sendet, kërkesat, si dhe akte publike dhe dokumente ligjore për pronësi dhe aktiva në formë të shkruar apo në formë elektronike apo instrumente me të cilat dëshmohet e drejta e pronësisë apo interesi mbi atë pasuri. Ndërsa objekte nënkuptohen

¹ Kadriu, Osman. Hyrje në të drejtën civile, Tetovë 2008, fq.246.

² Kadriu, Osman. Hyrje në të drejtën civile, Tetovë 2008, fq.253.

³ Kodi penal i Republikës së Maqedonisë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 37/1996, 80/1999, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/11, 135/11, 185/11, 142/12, 166/12, 55/13, 82/13, 14/14, 27/14, 28/14, 115/14, 132/14 dhe 160/14).

objekte të luajshme apo të paluajshme të cilat janë të përdorura krejtësisht apo pjesërisht apo duhet të jenë përdorur ose janë krijuar me vepër penale.

Sa i përket konfiskimit të pronës dhe dobisë pasurore, aty mund të përfshihet e gjithë ajo pronë ose pasuri e cila është e definuar me ligj. Duke u nisur nga definimi i pasurisë dhe sendeve në kodin penal, pasuria, sendet apo objektet të cilat mund të konfiskohen e kanë kuptimin e tyre si në të drejtën sendore. Sendi është pjesë e natyrës materiale e cila mund të jetë në posedim të njeriut dhe që mund të individualizohet. Egzistojnë lloje të ndryshme të sendeve varrësisht nga natyra e tyre, vendodhja në hapsirë, përbërja, destinimi dhe vetitë e tjera mbi të cilat e drejta e pronësisë rregullohet me ligj në mënyra të ndryshme duke marrë parasysh natyrën e përgjithshme të së drejtë së pronësisë. Sa i përket vendndoshjes së tyre në hapsirë sendet ndahen në sende të luajshme dhe sende të paluajshme. Sende të luajshme janë ato sende të cilat mund të lëvizin nga një vend në një vend tjetër ndërsa të mos ndryshohet thelbi i tyre. Sendet e paluajshme janë ato sende të cilat nuk mundet që të lëvizin nga një vend në një vend tjetër pa mos u dëmtuar thelbi i tyre. Si sende të paluajshme konsiderohen, tokat (bujqësore, ndërtimore, pyjore dhe kullotat) dhe ndërtesat, si dhe instalimet e ndërtuara mbi to ose nën to dhe të cilat janë të ngjitura me ta përgjithmonë, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe. Sendet të cilat sipas natyrës së tyre janë të luajshme në kutimin juridik mundet që të konsiderohen të paluajshme nëse janë pjesë të një sendi të paluajshëm ose nëse ligji i njëjtëson me sendet e paluajshme. Në rast kontesti se një send a është i luajshëm apo i paluajshëm konsiderohet se ai është i paluajshëm.⁴

Nocioni dobi pasurore nënkupton çfardollos zmadhimi të pasurisë që rezulton nga vepra penale, sendet e vjedhura, të hollat e fituara nga shitja e drogës, shpërblimi për veprën e kryer, ryshfeti i marrë etj. Me dobi pasurore nënkuptohet edhe pjesa e pronësisë së kryesit e cila nuk është zvogluar për shkak të kryerjes së veprës penale (evazion fiskal, falsifikim dokumenti për pranimin e borxhit etj), si dhe të drejtat e themeluara në mënyrë joligjore si dhe mundësitë faktike për realizimin e dobisë pasurore. Dobia mundet që të paraqitet si direkte apo indirekte varësisht nga ajo se realizimi i saj a është pasojë e veprës penale (kështu për shembull të kërcënimi – dorëzimi i parave kryerësit) ose si rezultat të aktiviteteve plotësuese të kryerësit apo viktimës (kështu për shembull, kontratë e lidhur me dhunë me të cilën kryerësit në të ardhmen i njihen të drejt të caktuara ndaj pronës së viktimës). Dobia pasurore mundet që të përbëhet nga para, sende të luajshme apo të paluajshme me vlerë si dhe çdo lloj tjetër prone. Konfiskimi i përfshin edhe sendet e veprës të cilat paraqiten si objekt i kryerjes,

⁴ Ligji për pronësi dhe të drejtat e tjer sendore, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.18/200, neni 12 dhe 13.

kur ligji përcakton marrjen e detyrueshme të tyre në pjesën e veçantë (kështu për shembull marrja e egërsirës së gjuajtur te vepra penale gjueti joligjore ose peshku i gjuajtur te vepra penale peshkim joligjor) nëse këto objekte kanë vlerë materiale dhe e zmadhojnë pasurinë e kryerësit. Objektet të cilat janë përdorur si mjet për kryerjen e veprës penale nuk merren si dobi pasurore por lëndë të veprës.⁵

Pasuria dallohet prej konfiskimit në atë se konfiskimi është masë e karakterit penalo-juridik ose masë e ndonjë delikti tjetër kundërligjor. Mund të jetë i plotë ose i pjesërishtë, është masë shtetërore. Dallimi ndërmjet pasurisë dhe konfiskimit ka të bëjë me një fakt dhe rethanë mjaft relevante. Tek pasuria kemi edhe ndarjen e saj prej titullarit. Me vdekjen e titullarit të pasurisë ajo njëherë e përgjithmonë e ndërpret lidhjen me bartësin e saj. Tek konfiskimi situata është krejt tjetër. Edhe sikurse të ndodhë konfiskimi total titullari i tyre mund të krijojë pasuri tjetër dhe të re. Pra te konfiskimi vazhdon të ekzistojë subjektiviteti juridik i personit ndaj të cilit është shqiptuar një masë e tillë.⁶

Kur bëhet fjalë për pronën dhe dobinë pasurore e cila është fituar si pasojë e kryerjes së veprës penale, kryerësi nuk ka të drejtën e pronësisë mbi atë pronë ose pasuri pasiqë në këto raste bëhet fjalë për mënyrë jo ligjore të fitimit të kësaj pronësie apo pasurie, prandaj edhe kryerësit e veprave penale nuk mund të konsiderohen si pronarë por vetëm si posedues të pasurisë dhe dobisë pasurore të fituar me vepër penale. Në këtë kuptim edhe çdo punë juridike të cilën ato do ta lidhin për të disponuar në çfado mënyrë me pronën apo pasurinë e fituar me vepër penale do të konsiderohet si joligjore dhe e pavlefshme, prandaj edhe nuk mund të gëzojnë mbrojtje juridike si pronar.

Në legjislacionin tonë nuk jepet definimi i dobisë pasurore të fituar me vepër penale, por ajo nënkupton çdo dobi të fituar direkt apo indirekt me kryerjen e veprës penale. Këtu hyn çdo e ardhur apo çdo e mirë materiale ose jomateriale e cila është krijuar nga këto të ardhura apo është e përzier me këto të ardhura. Dobia e fituar pasurore në çdo rast vërtetohet dhe ndahet nga pasuria të cilën kryerësi i veprës penale mundet që ta ketë fituar në mënyrë ligjore.

Definicioni i dobisë pasurore jepet në disa konventa ndërkombëtare. Kështu Konventa e Strasburgut mbi pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimin, me termin "produkt" nënkupton çdo avantazh ekonomik të nxjerrë nga veprat penale. Ky avantazh mund të konsistojë në çdo pasuri, ndërsa me termin "pasuri" nënkupton pasuri të çdo natyre, fizike ose jofizike, e luajtshme ose e paluajtshme, si dhe aktet juridike ose dokumentet

⁵ Камбовски, Владо. Научен и практичен коментар на Кривичниот законик на Република Македонија, Скопје 2015., fq.592.

⁶ Kadriu, Osman, Hyrje në të drejtën civile, Tetovë 2008, fq.257.

që vërtetojnë një titull ose interes mbi këtë pasuri, ndërsa "instrument" nënkupton të gjitha objektet e përdorura ose të destinuara për t'u përdorur në çfarëdolloj mënyre, plotësisht ose pjesërisht, për të kryer një ose disa vepra penale.⁷ Në Konventën e Këshillit të Europës për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit me "pasuri" nënkupton pasuritë e çdo lloji, fizike ose jofizike, të luajtshme ose të paluajtshme, reale ose joreale, dhe dokumentet ose instrumentet ligjore, të cilat vërtetojnë një titull ose interes tek këto pasuri, ndërsa "të ardhura nga krimi" nënkupton çdo pasuri që rrjedh ose që është fituar, direkt ose indirekt, nëpërmjet kryerjes së një vepre penale.⁸

1.2. Nocioni i konfiskimit

Konfiskimi i dobisë pasurore të fituar me vepër penale është një çështje e rëndësishme që lidhet me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Një nga orientimet kryesore të politikës së sotme kriminale në shkallë ndërkombëtare është goditja e përfitimeve të veprave penale. Në mënyrë të veçantë po sulmohen përfitimet e siguruar nga krimi i organizuar dhe veprimtaritë kriminale që lidhen me të. Kjo politikë ka si qëllim jo vetëm ndëshkimin e krimit, por edhe parandalimin e tij, madje kësaj të fundit po i vihet një theks i posaçëm sepse duke u hequr kriminelëve përfitimet u heq njëkohësisht motivimin dhe mjetet për tu marr me veprimtari kriminale. Shqetësimi i kriminelëve se përfitimet e tyre nga krimi mund të konfiskohen është një faktor i madh që i motivon ata për të pastruar përfitimet e krimit. Një sistem efektiv konfiskimi është një komponent i nevojshëm në masat që merren në çdo vend kundër pastrimit të parave.⁹

Sipas parimeve të përgjithshme juridike askush nuk mund të mbajë dobinë pasurore të cilën e ka fituar në mënyrë të kundërligjshme. Përkatësisht çdo fitim pasuror që është rezultat i ndonjë vepre penale nuk ka bazë juridike dhe për këtë shkak dobinë e këtillë askush nuk mund ta mbajë. Në bazë të këtij parimi, rezulton se askush nuk mund të mbajë dobinë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale. Dobia pasurore e fituar me vepër penale mund të jetë me të holla apo gjësende të tjera të vlefshme. Intenca e kësaj mase është që të bëhet i pamundshëm fitimi pasuror me anë të kryerjes së veprës penale.¹⁰ Konfiskimi i pasurisë dhe i

⁷ Konventa mbi pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit e nënshkruar në Strasburg më 8 nëntor 1990.

⁸ Konventa e Këshillit të Europës për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit e nënshkruar në Varshavë më 16 maj 2005.

⁹ Veseli, Latif. Luftimi i korrupsionit dhe konfiskimi i dobisë pasurore të fituar me vepër penale, Instituti Evropian për Studime Juridike dhe Administrim Publik, Prishtinë 2011, fq.8

¹⁰ Salihu Ismet, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Prishtinë 2012, fq.542.

dobisë pasurore është masë e veçantë penalo juridike me shqiptimin e së cilës merret në mënyrë të dhunshme dobia pasurore direkte ose indirekte e krijuar me vepër penale. Baza e saj është parimi juridik se nga jo e drejta nuk mund të bëhet e drejtë. Prezumime për konfiskim janë: kryerja e veprës penale dhe realizimi direkt ose indirekt i dobisë me veprën penale të kryer.¹¹

Kështu, nocionin e konfiskimit e hasim në disa konventa ndërkombëtare. Në Konventën e Këshillit të Europës për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit, me termin konfiskim nënkuptohet një dënim ose masë të urdhëruar nga një gjykatë pas një procedimi, lidhur me një ose disa vepra penale, dënim ose masë që përfundon me privimin e përhershëm të pasurisë. Ndërsa në Konventën e kombeve të bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar me termin "bllokim" ose "konfiskim" nënkuptohet ndalimin e përkohshëm të transferimit, shkëmbimit, rregullimit ose zhvendosjes së pasurisë, ose marrjen përkohësisht në ruajtje ose kontrollimin e pasurisë në bazë të një urdhëri të lëshuar nga gjykata ose ndonjë autoritet tjetër kompetent. Më tej me termin "konfiskim", i cili përfshin në raste të veçanta gjobën, nënkuptohet privimin e përhershëm nga pronësia me anë të një urdhri gjykate ose të ndonjë autoriteti tjetër kompetent.

1.3. Natyra juridike e konfiskimit

Për dallim prej sanksioneve juridiko penale, vlera e përbashkët e të cilave është përvetësimi i disa të drejtave dhe lirive të kryrësit të veprës, konfiskimi i pasurisë dhe dobisë pasurore dhe marja e sendeve si masa të posaçme penalo juridike janë pasoja juridike të vetë veprës të cilat nuk janë të lidhura për zbatimin e sanksionit kundrejt kryrësit të saj.¹² Vepra penale mund të ketë pasoja të ndryshme, qytetare (dëmshpërblimin), administrative (marrjen e koncesioneve të ndryshme ose lejeve) etj që janë lëndë e normativës së posaçme juridike. Disa prej tyre duhet të jenë lëndë e regjimit penalo juridik dhe të jenë të shqiptuara me vendim gjyqësor që të sigurohet parimi themelor i drejtësisë penale. Nuk është në rregull që të realizohet çfardollos dobie pasurore në mënyrë antiligjore dhe kjo duhet dhe mundet që të ndërpritet me zbatimin e rregullave të së drejtës civile ose degëve të tjera të së drejtës. Joadekuate është që të lejohet cilidoqoftë që të fitojë dobi pasurore me veprim anti ligjor në kuptimin penalo juridik dhe kjo është secili veprim me të cilin realizohen shënimet ligjore

¹¹ Kambovski, Vllado. E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, Shkup 2007. fq.601.

¹² Kambovski, Vllado & Zejneli, Ismail. E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, Tetovë 2018, fq.323.

objektive të ndonjë vepre penale në mungesë të bazës për përjashtim të kundërligjshmërisë së saj. Nuk është e drejtë gjithashtu që ti lihen kujtdoqoftë produktet e veprës penale gjegjësisht lëndët e krijuara me relizimin e saj. Parimi i drejtësisë imponon zgjerim të masave penalo juridike të konfiskimit edhe mbi (lëndë) mjete të tjera që janë në lidhje me veprën penale, lëndët të cilët ishin dedikuar ose shfrytëzuar për kryerjen e veprës.¹³

Konfiskimi i pasurisë si masë e posaçme penalo-juridike nuk konsiderohet një lloj i sanksionit penal. Edhe pse me të në mënyrë specifike realizohet qëllimi të cilin e kanë edhe sanksionet penale – luftën kundër kriminalitetit. Qëllimi kryesor i kësaj mase është që të rivehet aso gjendje pasurore çfarë ka qenë para kryerjes së veprës penale.¹⁴ Vet përfitimi i dobisë pasurore mundet që të përbëhet nga zmadhimi i pasurisë, pengimi i rritjes së saj apo në mënjanimin e pengesave për realizimin e dobisë pasurore. Me rëndësi është që dobia pasurore të jetë fituar me vepër penale. Baza e sekuestrimit të dobisë pasurore ka të bëjë si me dobinë e cila i ka paraprirë kryerjes së veprës penale si dhe dobinë e përfituar drejtëpërdrejtë me vetë kryerjen e veprës penale por edhe me atë pasuri tek e cila kryesi do të vijë pas kryerjes së veprës penale. Natyra juridike e sekuestrimit të dobisë pasurore qëndron në atë se ajo është një masë juridiko-penale specifike e cila nuk lejon që kryesi të pasurohet ilegalisht, për atë sekuestrimi i dobisë pasurore të kundërligjshme në thelb nuk është një dënim në kuptimin juridiko-penal të dënimit pasi që nga kryesi sekuestrohet diçka që nuk është e tij deri tek e cila ka ardhur me veprim kriminal.¹⁵

Nga definimi i natyrës juridike të masave të posaçme si konsekuenca penale juridike të vetë veprës paraqiten edhe dallimet themelore të masave të posaçme prej nocionit të sanksioneve dhe pastaj edhe prej nocionit të dënimit dhe masave të sigurisë. Ato nuk janë sanksione sepse nuk prekin në asnjë të drejtë dhe liri të kryerësit të veprës. Askush nuk mund të pretendojë për ndonjë të drejtë të fituar nga ndonjë krim, të drejtën në pronësi apo posedim mbi një objekt – send, që është përdorur për kryerjen e një vepre penale, ose një send me të cilin ekziston rreziku se mund të përdoret përsëri për kryerjen e një vepre penale, marrjen e sendeve – mjeteve e imponojnë shkaqet e interesit për mbrojtje të shoqërisë prej kriminalitetit i cili është parim i pranuar juridik.¹⁶ Konfiskimi ose marrja e instrumenteve dhe produkteve të veprës nuk është dënim sepse nuk ka natyrë retributive, me shqiptimin e tyre asgjë nuk i rikthehet kryerësit të veprës. Këto masa nuk janë as masa të sigurisë jo vetë në dritën e qasjes

¹³ Kambovski, Vllado. E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Shkup 2007, fq.595.

¹⁴ Salihu Ismet. E drejta penale pjesa e përgjithshme, Prishtinë 2012, fq.543.

¹⁵ Ингилизова – Ристова, Лилјана. Конвенција на обединетите нации против транснационалниот организиран криминал и казната – конфискација на имот, Судиска ревија, Здружение на судиите на Република Македонија, Година VIIIбр.4/2002, Скопје 2002, fq.49.

¹⁶ Kambovski, Vllado & Zejneli, Ismail. E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, Tetovë 2018, fq.324.

restriktive të legjislaturës sonë që si të tilla i trajton vetëm masat mjekësore por edhe sipas konceptit difuz pjesëmarrës në disa legjislatura i bazuar në idenë e rrezikut të kryerësit. Nuk bëhet fjalë për rrezik të kryerësit por atje ku megjithatë bëhet fjalë për konfiskim sendesh për shkak rrezikut që përsëri të përdoren për kryerje të veprës penale, për rrezik të përgjithshëm i lidhur për vetë sendin dhe jo për kryerësin ose dikë tjetër. Nga këto shkaqe, konfiskimi i pasurisë dhe i dobisë pasurore dhe marrjes së sendeve është i ndarë nga sistemi i sanksioneve dhe janë të parapara si masa të posaçme penale juridike.¹⁷

1.4. Sistemet dhe llojet e konfiskimit

Përgjithsisht ekzistojnë tre lloje të konfiskimit që përdoren për të marrë dobinë dhe instrumentet e korupsionit dhe atë: konfiskimi penal, konfiskimi që nuk bazohet në dënim dhe, në disa juridiksione, konfiskimi administrativ. Konfiskimi penal apo kriminal kërkon një dënim penal nga gjyqi pasiqë i akuzuari të jetë shpallur fajtor. Pasi që të shqiptohet dënimi, gjyqi mund të sjellë një urdhëresë finale të konfiskimit si pjesë e dënimit. Në disa legjislacione, konfiskimi bëhet me urdhër, në disa të tjerë gjyqi apo trupi gjykues ka të drejtë diskrecionale për ta shqiptuar këtë lloj mase. Sistemet e konfiskimit kriminal mund të jenë sisteme të bazuar në pronë ose sisteme të bazuar në vlerë.¹⁸

Konfiskimi i cili nuk bazohet në dënim i njohur nganjëherë si “konfiskim objektiv” e autorizon konfiskimin e dobisë pasurore pa patur një dënim. Pasiqë shpesh bëhet fjalë për një veprim kundrejt vetë pronës e jo kundër personit i cili e posedon ose e ka në pronësi atë pasuri, ky lloj konfiskimi përgjithsisht kërkon dëshmi se prona është pasojë ose produkt i veprës penale. Ky lloj konfiskimi shpesh realizohet në njërin nga dy mënyra të mundshme, e para është konfiskimi në kuadër të procedurës penale por pa pasur nevojë për një dënim final ose shpalljen fajtor të të akuzuarit. Në këto situata dispozitat e konfiskimit objektiv janë të inkuorporuara në kodet penale ekzistuese, ligjet kundër larjes së parave ose legjislacionet e tjera penale dhe konsiderohen si procedura në fushën e të drejtës penale ku zbatohen rregullat e procedurës penale. Mënyra e dytë është konfiskimi nëpërmjet sjelljes së një ligji të veçantë i cili parasheh një procedurë të veçantë e cila mundet që të zhvillohet pavarësisht ose paralelisht me procedurën penale dhe zakonisht zhvillohet sipas rregullave të së drejtës civile. Konfiskimi administrativ realizohet pa pasur nevojë për një vendim gjyqësor. Shpesh përdoret

¹⁷ Kambovski, Vllado. E drejta penale e përgjithshme, Shkup 2007, fq.596.

¹⁸ Brun, Jean-Pierre & Gray, Larissa & Scott, Clive & M. Stephenson, Kevin. Asset Recovery Handbook A Guide for Practitioners, The International Bank for Reconstruction and Development The World Bank, 2011, fq.105.

për të konfiskuar objektet në raste kur konfiskimi nuk kontestohet dhe kur plotësohen disa kushte (për shembull, njoftimi palëve ku me shpalljen e konfiskimit nuk ka kundërshtim). Në lidhje me këtë mund të ketë kufizime ligjore sa i përket konfiskimit administrativ, si për shembull maksimumi i vlerës së objektit ose objekteve të caktuara të cilat mund të konfiskohen. Ligjet të cilat e parashohin konfiskimin administrativ shpesh kërkojnë që vendimi për konfiskim të miratohet nga gjyqi.¹⁹

Sistemi i bazuar në pronë mundëson që të merret pasuria e cila është vërtetuar se është fituar me vepër penale ose mjete i cili është përdorur për të kryer veprën penale. Ky sistem zakonisht mund të gjendet në shtetet e sistemit kontinental prandaj edhe përdoret në shumicën e shteteve europiane (Italia, Spanja). Në Kanada, (në provincat në të cilat ekziston ky sistem) për shembull gjyqi i cili e shqipton aktgjykimin mund të urdhërojë marrjen e pasurisë e cila është e fituar me kryerjen e veprës penale kur vepra penale për të cilën është shqiptuar aktgjykimimi ka sjellë deri te fitimi i pasurisë. Prandaj sipas kësaj, gjyqi në këto sisteme, edhe nëse pasuria nuk ka të bëjë me vepër penale të caktuar, mund të urdhërojë që e njëjta të merret nëse nuk ka dyshim se ajo është fituar me vepër penale. Pasiqë ky sistem është i bazuar në pasurinë, gjyqi mundet që të shqiptojë pagesën e dënimit me të holla nëse nuk mund të gjendet pasuria, nëse i është bartur personave të tretë, nëse gjendet jashtë shtetit, nëse vlera e saj ka rënë ndjeshëm ose nëse është e përzier me pasuri tjetër.²⁰

Sistemi i bazuar në vlerën ose dobinë pasurore e ka prejardhjen nga Britania e Madhe dhe sipas këtij sistemi llogaritet vlera e dobisë pasurore së fituar dhe e mjeteve të cilat janë të përdorura për kryerjen e veprës penale dhe konfiskohet vlera ekuivalente e tyre. Ky sistem është i njohur në të drejtën e sistemit anglosakson, edhe pse duhet të theksohet se Holanda dhe Austria edhe pse shtete kontinentale, e kanë përvetësuar këtë sistem. Në këtë sistem, gjyqi e llogarit “dobinë pasurore” të fituar nga vepra penale e caktuar për të cilën është dënuar kryerësi i veprës penale. Pasiqë përcaktohet vlera e dobisë së fituar gjyqi e vlerëson aftësinë e kryerësit për të paguar shumën e llogaritur, domethënë e përcakton shumën e cila do të mund që të konfiskohej nga pasuria e kryerësit. Duke u bazuar në këtë (këto llogaritje) gjyqi sjell urdhëresë për konfiskim dhe atë në shumën më të ulët të dobisë ose pasurisë e cila mund të konfiskohet. Shpesh qyqi përcakton edhe dënim plotësues me burgim të cilën kryerësi duhet ta mbajë nëse nuk e paguan shumën e cila i është caktuar ta paguajë. Sistemi i kombinuar

¹⁹ Brun, Jean-Pierre & Gray, Larissa & Scott, Clive & M. Stephenson, Kevin. Asset Recovery Handbook A Guide for Practitioners, The International Bank for Reconstruction and Development The World Bank, 2011, fq.106.

²⁰ Građanskopravno oduzimanje (konfiskacija in rem), Pojašnjenje i studija o uticaju, Savet Evrope Kancelarija u Beogradu, Beograd 2013, fq.10.

përdoret në disa shtete dhe mundëson marrjen e vlerës ekuivalente në kushte të caktuara, për shembull kur kryerësi e ka shfrytëzuar, shkatëruar ose e ka fshehur pasurinë. Të gjitha këto modele të konfiskimit e kanë si bazë vendimin gjyqësor, gjersa procedura pas dënimit, jo gjithmonë, e ka natyrën e procedurës civilo-juridike.²¹

Në të drejtën penale bashkëkohore dallohen dy lloje konfiskimi: gjeneral (marrja e pasurisë së përgjithshme ose të pjesëshme të kryerësit dhe speciale (marrja e mjeteve sendeve të veprës). Konfiskimi gjeneral më parë ishte dënim i rregullt që përbënte marrjen e tërë pasurisë të kryerësit pa asnjë kompenzim.²² Skepticizimi në lidhje me këtë dënim të egër në të drejtën penale bashkëkohore i bazuar në argumentet e ashpërsisë së pashembullt dhe karakterin e depresionalizmit solli deri te ajo konfiskimi të shqiptohet prej sistemit të dënimeve dhe të transformohet në dënim ose masë të posaçme të marrjes së dobisë pasurore të krijuar me vepër penale. Sot si dënim që ka të bëjë me marrjen e pasurisë së kryerësit e njohin vetëm disa legjislatura, kryesisht shtetet në tranzicion. Konfiskimi special përbëhet në marrjen e sendeve që janë përdorur, janë dashur ose sipas disa legjislatrave janë objekte të veprës penale. Përveç reales si formë e konfiskimit special në disa legjislatura është e pranuar edhe konfiskimi vlerësues, ku prej kryerësit nuk merret sendi por dobia pasurore që vlen sa vlera e produktit kriminal. Poashtu është pranuar edhe vendimi kur bëhet fjalë për sende të rrezikshme, marrjes së tyre prej personave të tretë. Për natyrën ambivalente të marrjes (instrumente, prodhime, objekte të veprës, sende të rrezikshme) mjaft flet edhe laramiania e legjislacioneve bashkëkohore në raport me pozicionin e kësaj mase në sistemin e pasojave juridike të veprës penale, derisa në të tjera si masë e sigurisë.²³

Ka disa lloje konfiskimi të përfitimeve të veprave penale: Konfiskimi i përfitimeve që kanë rrjedhur nga një sjellje e caktuar kriminale (Gjykata mund të konfiskojë përfitimet e krimit për të cilin personi është dënuar. Ky është konfiskimi që jepet në përfundim të procesit penal si pjesë e dënimit për të pandehurin); Konfiskimi i përfitimeve të sjelljes së përgjithshme kriminale (Gjykata mund të konfiskojë përfitimet e kriminelit që kanë ardhur nga e gjithë e kaluara e tij kriminale. Ky quhet edhe konfiskim i zgjeruar dhe aplikohet zakonisht për krimet e rënda, si ato që lidhen me organizatat kriminale, drogën, pastrimin e parave etj. Ky lloj konfiskimi është i parashikuar në shumë shtete si në Gjermani, Angli, Itali, Finlandë, Danimarkë, Zvicër, SHBA, Norvegji, Shqipëri etj.), konfiskimi në vlerë (të gjitha pasuritë konsiderohen si përfitime nga krimi dhe konfiskohen në qoftë se krimineli nuk do të

²¹ Građanskopravno oduzimanje (konfiskacija in rem), Pojašnjenje i studija o uticaju, Savet Evrope Kancelarija u Beogradu, Beograd 2013, fq.10.

²² Kambovski, Vllado & Zejnli, Ismail. E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, Tetovë 2018, fq.324

²³ Kambovski, Vllado. E drejta penale e përgjithshme, Shkup 2007, fq.596.

provojë se ai i ka fituar ato nga një burim jo kriminal). Disa shtete në legjislacionin e tyre konfiskimin me vlerë e kanë parësor, ndërsa të tjera dytësor. Konfiskimi në vlerë parashikohet edhe në konventat ndërkombëtare, me të cilat u sugjerohet shteteve që të marrin masa për të mundësuar edhe konfiskimin e pasurive vlera e të cilave korrespondon me vlerën e përfitimeve të veprimtarive të paligjshme.²⁴

Konfiskimi i pasurisë mund të shtrihet edhe kur ajo mbahet nga të afërm të personit ose nga persona të tretë fizikë apo juridikë, pasi shpesh herë kriminalët i vendosin pasuritë e fituara me veprimtari kriminale në emër të personave të tjerë me qëllim që të fshehin zotërimin apo pronësinë e vërtetë të tyre mbi to. Me këtë rast, duhet veçuar konfiskimin penal si konfiskim tradicional të cilin e kanë pak a shumë të gjitha legjislacionet penale të vendeve të tjera. Veçoritë e këtij lloj konfiskimi janë: ka natyrën juridike të një dënimi penal, pasi parashikohet në ligj si një nga dënimet plotësuese që jep gjykata ndaj personave që kanë kryer vepra penale, aplikohet për të gjitha veprat penale, konfiskohen vetëm instrumentet dhe përfitimet e veprës penale konkrete për të cilën është shpallur dënimi, është pjesë e procedimit penal ndaj të pandehurit; Lejohet konfiskimi i vlerave ekuivalente; Është një konfiskim i detyrueshëm²⁵

2. KONFISKIMI I PRONËS DHE DOBISË PASURORE DHE MARRJA E SENDEVE SIPAS KODIT PENAL TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në Republikën e Maqedonisë, në Kodin penal parashihet baza dhe llojet e konfiskimit si masë e veçantë penale juridike për veprat penale ekonomike dhe financiare e cila konsiston në marrjen e pasurisë së fituar me vepër penale në mënyre direkte apo indirekte.

Askush nuk mund ta mbajë dobinë pasurore direkt apo indirekt të fituar me vepër penale. Dobia pasurore konfiskohet me vendim gjyqësor me të cilën është vërtetuar kryerja e veprës penale, sipas kushteve të parapara me ligj.²⁶ Vendim për konfiskim gjyqi do të sjellë në procedurë të përcaktuar me ligj edhe kur për shkak të pengesave faktike dhe juridike nuk është e mundur zhvillimi i procedurës penale ndaj kryesit të veprës penale. Në kushte të parapara me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare, prona e konfiskuar mundet që ti kthehet

²⁴ Veseli, Latif. Luftimi i korupsionit dhe konfiskimi i dobisë pasurore të fituar me vepër penale, fq.9.

²⁵ Veseli, Latif. Luftimi i korupsionit dhe konfiskimi i dobisë pasurore të fituar me vepër penale, fq.9.

²⁶ Kodi penal i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 37/1996 datë 29.07.1996, neni 97 paragrafi 1 dhe 2.

ndonjë shteti tjetër.²⁷ Pengesa faktike dhe juridike mund të jenë sëmundja shpirtërore e kryesit të veprës penale, përfshirja e veprës penale me amnesti ose falje, vjetrsimi i veprës penale.

Përmbajtja e kësaj mase të veçantë penalo-juridike është marrja e detyrueshme nga kryerësi i veprës penale ose nga persona të tretë, e dobisë pasurore direkte apo indirekte e cila është e fituar me vepër penale. Baza e saj është parimi i drejtësisë se nga padrejtësia nuk mund të bëhet drejtësi. Kjo dispozitë përcakton dy kushte për konfiskimin: kryerjen e veprës penale dhe përfitimin direkt apo indirekt të dobisë pasurore. Duke u nisur nga kuptimi i përgjithshëm i veprës penale, kushti elementar për konfiskim është vepra e kundërligjshme, vepër e cila si minimum i plotëson karakteristikat objektive të veprës penale, dhe nuk ka bazë për përjashtimin e kundërligjshmërisë. Dobia pasurore konfiskohet me vendim gjyqësor me të cilën është vërtetuar kryerja e veprës penale. Por ligji aspak nuk e përcakton këtë vendim gjyqësor si aktgjykim dënues, por përkundrazi, përcakton se vendimi për konfiskim gjyqi e sjell në procedurë të veçantë të përcaktuar me ligj edhe në rastet kur për arsye faktike ose juridike nuk është e mundur zhvillimi i procedurës penale kundër kryerësit të veprës penale. Kjo zgjedhje ligjore është logjike për arsye se është pasojë e zgjerimit të aplikimit të kësaj mase edhe ndaj personave të tretë.²⁸

Përpos dobisë pasurore direkt të fituar me vepër penale, kodi penal parasheh se nga kryesi i veprës penale do të konfiskohet edhe dobia indirekte e cila përbëhet nga: pasuria në të cilën është transformuar apo shëndruar dobia e fituar me vepër penale, prona e fituar nga burime ligjore në qoftë se dobia e fituar me vepër penale është e përzier, pjesërisht ose tërësisht, me atë pronë, deri në vlerën e llogaritur nga dobia e përzier e fituar me vepër penale, dhe të ardhurat apo dobia tjetër e cila rrjedh nga dobia e fituar me vepër penale, nga pasuria në të cilën dobia e fituar me vepër penale është transformuar ose shëndruar ose nga pasuria me të cilën është përzier dobia e fituar me vepër penale, deri në vlerën e llogaritur të dobisë së përzier të fituar me vepër penale.²⁹ Kjo dispozitë ligjore është marrë nga Konventa e Këshillit të Europës për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për finansimin e terrorizmit ku shtetet që e kanë ratifikuar këtë konventë janë detyruar që të marrin masa legislative dhe të tjera të nevojshme për të siguruar që masat për ngrirjen, bllokimin dhe

²⁷ Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit penal të Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë 19/04 datë 30.03.2004, neni 53.

²⁸ Камбовски, Владо. Научен и практичен коментар на Кривичниот законик на Република Македонија, Второ изменето издание, Матица, Скопје 2015, fq.588.

²⁹ Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit penal të Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.114/09 datë 14.09.2009, neni 13.

konfiskimin të përfshijnë edhe dobinë pasurore direkte të fituar me vepër penale ashtu siç është përshkruar në dispozitat e mësipërme.

Në ligj janë të përcaktuara strikt procedurat me të cilat mund të shqiptohet masa e konfiskimit të pasurisë dhe nga kush mund të konfiskohet dobia pasurore. Këto dispozita për konfiskim të pasurisë dhe dobisë pasurore janë veçënisht të rëndësishme kur bëhet fjalë për vepra penale në fushën e kriminalitetit financiar. Po të mos ekzistonin këto dispozita atëherë të akuzuarit do të mund ta mbanin dobinë pasurore të fituar me vepër penale dhe do të shtrohej pyetja për kuptimin e zhvillimit të këtyre procedurave. Kjo nuk do të thotë se vetë dënimi i kryerësve të veprave penale nuk është i rëndësishëm, por vetëm dënimi nuk mund të prodhojë asnjë efekt dhe as nuk mund të ndikojë në mënyrë preventive nëse të akuzuarit përkatësisht të dënuarit do të mund ta mbanin dobinë pasurore të fituar në mënyrë të kundërligjshme. Nga këto dispozita del se vendim për konfiskim mund të sjellet vetëm nga gjyqi dhe atë me vendim gjyqësor me të cilën është vërtetuar kryerja e veprës penale.³⁰

2.1. Mënyra e konfiskimit

Varësisht nga lloji i pronës dhe dobisë pasurore për të cilin gjykata ka sjellë vendim për tu konfiskuar, përcaktohet edhe mënyra e konfiskimit. Nga kryesi i veprës penale do të konfiskohet dobia pasurore direkte dhe indirekte e fituar me vepër penale e cila përbëhet nga të holla, sende të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo pronë tjetër, pasuri apo aktivë, të drejta materiale dhe jomateriale, e nëse konfiskimi i tyre nuk është i mundur nga kryesi do të konfiskohet pronë tjetër e cila i përgjigjet vlerës së dobisë pasurore të fituar.³¹ Gjyqi sipas detyrës zyrtare e konfiskon nga kryesi dobinë pasurore direkte apo indirekte të fituar me vepër penale.

Të gjitha format e mundshme të dobisë pasurore janë objekt të dy lloje të konfiskimit: real dhe vlerësues. Konfiskimi real konsiston në marrjen e parave, të objekteve të tundshme apo të patundshme, si dhe çdo pasuri tjetër apo aktivë si dhe të drejta materiale dhe jomateriale. Varësisht nga natyra e dobisë pasurore konfiskimi mundet që të ketë formë të marrjes fizike (marrja e parave, shtëpisë, automobilit të fituar me vepër penale etj.) ose të veprimeve të tjera me të cilat anulohen të drejtat materiale ose jomateriale (anulimi i

³⁰ Финансиски истраги и конфискација на приходи стекнати од криминал, Прирачник за обука на органите за кривичен прогон и судство, Совет на Европа, 2006, fq.59.

³¹ Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit penal të Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.80/99 datë 17.12.1999, neni 55 paragrafi 1.

kontratës së lidhur me dhunë, konfiskimi i të gjitha ekzemplarëve të veprës së botuar me cenimin e së drejtës së autorit etj.)³²

Dobia pasurore direkte dhe indirekte konfiskohet edhe nga personat e tretë. Dobia pasurore konfiskohet edhe nga anëtarët e familjes së kryesit të veprës penale tek të cilët është bartur ajo pasuri, nëse është e dukshme se nuk kanë dhënë kompensim i cili korespondon me vlerën e dobisë pasurore të fituar, ose nga personat e tretë, nëse nuk dëshmojnë se për sendin apo pasurinë kanë dhënë kundër kompensim i cili korespondon me vlerën e dobisë së fituar pasurore.³³ Përveç prej kryerësit, pra dobia pasurore konfiskohet edhe prej personave të tretë të cilëve iu është bartur pa kompensim përkatës, kur pasuria e krijuar me vepër penale u është bartur personave të tretë me kompensim përkatës atëherë nuk ka vend për konfiskim të pasurisë së tij sepse ekuivalenca e dobisë pasurore ose me para (gjatë ndërrimit për shembull të veturës me banesë) gjendet te kryerësi. Kërkesa që personi i tretë të mundet ose të jetë i detyruar të dijë se dobia pasurore është krijuar me vepër penale e sjell atë në pozicion të ngjajshëm të kryerësit të veprës penale fshehje (ai i cili blen, pranon hipotekë, peng, furnizon etj., send për të cilin mund të dihet se është krijuar me vepër penale). Megjithatë dallimi është aty se prej personit të tretë dobia pasurore konfiskohet edhe kur ajo të ishte e detyrueshme (mundësi potenciale) dhe jo vetëm kur ka mundur të dihet se është krijuar me vepër penale dhe e dyta detyra e tij nuk ka të bëjë gjithmonë me sendet e krijuara me vepër penale ose ajo që për të është e fituar me shitje ose ndërrim, por dobisë pasurore që i është bartur pa kompensim përkatës. Kur personi i tretë ka mundur të dijë se sendi konkret është i krijuar me vepër penale do të përgjigjet për vepër fshehje pa marrë parasysh nëse për këtë ka dhënë kompensim.³⁴

Sendet të cilat janë shpallur trashëgimi kulturore dhe sende të ralla natyrore, si dhe ato me të cilat i dëmtuari është i lidhur personalisht, konfiskohen edhe nga personat e tretë pa marrë parasysh faktin se ato sende janë bartur tek ta me kompensim adekuat.³⁵

³² Камбовски, Владо. Научен и практичен коментар на Кривичниот законик на Република Македонија, Скопје 2015, fq.592,

³³ Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit penal të Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.80/99 datë 17.12.1999, neni 55 paragrafi 2.

³⁴ KAMBOVSKI, Vllado. E drejta penale; pjesa e përgjithshme, Shkup 2007, fq.601.

³⁵ Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit penal të Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.80/99 datë 17.12.1999, neni 55 paragrafi 3.

2.2. Kërkesa pasurore e të dëmtuarit dhe mbrojtja e të dëmtuarit

E drejta penale e mbron edhe pasurinë e qytetarit edhe në rastet kur ajo është e dëmtuar me vepër penale. Një ndër mënyrat e mbrojtjes së pasurisë është pikërisht masa e marrjes së dobisë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale. Personi i dëmtuar me vepër penale ka përparësi në realizimin e kërkesës pasurore juridike.³⁶ Prona e konfiskuar i kthehet të dëmtuarit e nëse nuk ka të dëmtuar shëndrohet në pronë të shtetit. Nëse të dëmtuarit në procedurë penale i është gjykuar kërkesa pasurore juridike gjyqi do të shqiptojë konfiskimin e dobisë pasurore nëse ajo e tejkalon vlerën e kësaj kërkesë.³⁷ Dobia pasurore shpesh herë fitohet në dëm të ndonjë personi fizik ose juridik i cili paraqitet si i dëmtuar me veprën penale (vjedhje, mashtrim, falsifikim i parave etj.). Është e mundur gjithashtu që dobia pasurore të jetë e fituar nga i dëmtuari i cili nuk ekziston më (ka vdekur, ose personi juridik është likuiduar) ose i dëmtuari nuk është identifikuar (kështu gjatë mashtrimit masiv të blerësve, gjatë keqpërdorimit të detyrës zyrtare – nga buxheti ose nga fondet publike). Në disa raste të përcaktuara me ligj dobia pasurore mund të realizohet në llogari të dikujt tjetër i cili nuk është i dëmtuar por paraqitet si kryes i veprës penale (te dhënia e ryshfetit ai i cili ka dhënë ryshfet në rast të zbulimit nuk mundet që ti kërkojë paratë përsëri, poashtu edhe te rasti i nxitësit i cili i ka dhënë kryesit një shumë të caktuar të hollash që ta kryejë veprën).³⁸

Lidhur me kërkesën e personit të dëmtuar me vepër penale mund të paraqiten dy situata, kur i dëmtuari e ka paraqitur kërkesën pasurore-juridike dhe situata kur kërkesën pasurore juridike nuk e paraqet. Në rastin kur i dëmtuari në procedurën penale e paraqet kërkesën pasurore juridike gjykata mund të vendosë për tërë kërkesën, përkatësisht për tërë kompenzimin e dëmit i cili është shkaktuar me veprën penale. Nëse fitimi pasuror të cilin kryerësi e ka realizuar me veprën penale është në lartësi të vlerës së kompenzimit të dëmit të cilin ia ka caktuar gjykata atëherë nuk ka arsye që gjykata të shqiptojë edhe masën e konfiskimit të pasurisë ndaj kryerësit të veprës penale, ngase kjo dobi tashmë është marrë. Mirëpo nëse fitimi pasuror të cilin kryerësi e ka realizuar me veprën penale është më i madh se vlera të cilën gjykata ka vendosur lidhur me kërkesën pronësore – juridike, gjykata do të shqiptojë masën e marrjes së dobisë pasurore. Mund të ndodhë që i dëmtuari i cili e ka paraqitur kërkesën pasurore juridike në procedurën penale lidhur me këtë kërkesë të

³⁶ Salihu Ismet, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Prishtinë 2012, fq.544.

³⁷ Kodi penal i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 37/1996 datë 29.07.1996, neni 98, paragrafi 4.

³⁸ Камбовски, Владо. Научен и практичен коментар на Кривичниот законик на Република Македонија, Скопје 2015, fq.596.

udhëzohet në procedurën e kontestit civil. Në rastet e tilla i dëmtuari mund të kërkojë që të kompenzohet nga shuma e vlerës e cila është konfiskuar nëse fillon procedurën kontestimore.³⁹ I dëmtuari i cili gjatë procedurës penale është udhëzuar në kontest për kërkesën pasurore juridike, mund të kërkojë kompensim nga shuma e pasurisë së konfiskuar nëse fillon kontesti brenda gjashtë muajve nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit që e udhëzon atë për inicimin e kontestit dhe nëse brenda tre muajve nga dita kur vendimi gjyqësor për vendosjen e kërkesës pasurore juridike është bërë i plotfuqishëm kërkon kompensim të vlerës së konfiskuar.⁴⁰

Situata e dytë shprehet nëse i dëmtuari nuk e paraqet kërkesën pasurore juridike në procedurën penale. Në rastin e këtillë i dëmtuari mund të kërkojë kompensimin e dëmit nga vlera e konfiskuar nëse e fillon procedurën e kontestit civil në afat të caktuar. I dëmtuari i cili gjatë procedurës penale nuk e ka paraqitur kërkesën pasurore juridike, mund të kërkojë kompensim nga vlera e dobisë pasurore të konfiskuar nëse për vërtetimin e kërkesës së tij ka filluar kontestin në afatin prej tre muajve nga dita kur ka mësuar për aktgjykimin me të cilin konfiskohet dobia pasurore dhe më së voni në afatin prej dy vjetësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit mbi konfiskimin e dobisë pasurore, dhe nëse në afat prej tre muaj nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit me të cilin është vërtetuar kërkesa e tij ka kërkuar kompensim nga vlera e dobisë pasurore të konfiskuar.⁴¹

2.3. Konfiskimi i zgjeruar

Si risi në Kodin penal paraqitet konfiskimi i zgjeruar, si një masë me të cilën realizohet efekti i konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale.

Në kodin penal parashihet se nga kryesi i veprës penale e cila është kryer në kuadër të shoqërisë kriminale me të cilën realizohet dobi pasurore dhe për të cilën është paraparë dënim me burg më së paku katër vjet si dhe veprat penale në lidhje me terrorizmin siç janë: rrezikimi terrorist i rendit kushtetues dhe sigurisë, organizim terrorist, teroroizëm, finansim i terrorizmit dhe terrorizëm ndërkombëtar, për të cilat është paraparë dënim me burg nga pesë vjet ose dënim më i rëndë ose është e lidhur me kryerjen e veprës penale larje parash për të cilën është paraparë dënim me burg më së paku katër vjet, do të konfiskohet pasuria e fituar në periudhën

³⁹ Salihu Ismet, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Prishtinë 2012, fq.544

⁴⁰ Kodi penal i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 37/1996 datë 29.07.1996, neni 99 paragrafi 1.

⁴¹ Kodi penal i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 37/1996 datë 29.07.1996, neni 99 paragrafi 2.

kohore para dënimit të cilën gjyqi e përcakton sipas rrethanave të rastit por jo më i gjatë se pesë vjet para kryerjes së veprës penale, kur në bazë të të gjitha rrethanave gjyqi me bazë është i bindur se prona i tejkalon të ardhurat ligjore të kryesit dhe rrjedh nga ajo veprë penale.⁴²

Me inkorporimin e kësaj mase të konfiskimit në kodin penal, Republika e Maqedonisë njëkohësisht i zbaton edhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e konfiskimit të pasurisë së fituar me veprë penale pasi që ky lloj konfiskimi parashihet dhe rekomandohet nga këto marrëveshje. Përkatesisht në nenin 5 të Konventës për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit⁴³, parashihet ngrirja, bllokimi dhe konfiskimi sipas të cilës çdo palë merr ato masa legislative dhe të tjera të nevojshme për të siguruar që masat për ngrirjen, bllokimin dhe konfiskimin të përfshijnë edhe pasurinë në të cilën janë transformuar ose konvertuar produktet; pasurinë e përfituar nga burime të ligjshme, nëse fitimet janë përzier, pjesërisht ose tërësisht, me një pasuri të tillë, deri në vlerën që vlerësohen fitimet e përziera, të ardhurat ose privilegje të tjera që rrjedhin nga fitimet, nga pasuria në të cilën janë transformuar ose konvertuar produktet nga krimi ose nga pasuria me të cilën janë përzier produktet nga krimi, deri në vlerën që vlerësohen fitimet e përziera, në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtën masë sa edhe fitimet. Parashikimi i kësaj mase në kodin tonë penal është edhe në pajtim me Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar⁴⁴ e cila parasheh se shtetet palë duhet të adaptojnë masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të mundësuar identifikimin, zbulimin, bllokimin ose marrjen e çdo sendi, të ardhurave nga krimi, që rrjedhin nga veprat penale ose pasurisë, vlera e së cilës i korrespondon asaj të të ardhurave nga krimi, pasurisë, pajisjeve ose mjeteve të përdorura ose të destinuara për t'u përdorur në veprat penale me qëllim konfiskimin e mundshëm.

Sa i përket përcaktimit të vlerës tek konfiskimi i zgjeruar si dhe procedurës për konfiskim të zgjeruar është e rëndësishme që të shihet edhe barra e të provuarit i cili deri në një masë është specifik tek konfiskimi i zgjeruar për dallim nga procedura e rregullt e konfiskimit. Tek procedura e rregullt e konfiskimit vlejné rregullat e përgjithshme të të provuarit, gjyqi i vërteton këto rethana në bazë të propozimit të paditësit duke u nisur nga parimi i vërtetimit të së vërtetës materiale. Bara e provës nuk bie tek i akuzuari i cili mundet

⁴² Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit penal të Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.114/09 datë 14.09.2009, neni 15.

⁴³ Konventa e Këshillit të Europës për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit e nënshkruar në Varshavë më 16 maj 2005, neni 5.

⁴⁴ Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar e nënshkruar në 12 dhjetor 2000 në Palermo, neni 12, paragrafi 2.

që të mbrohet edhe me heshtje. Tek konfiskimi i zgjeruar me ligj përcaktohet një supozim i rrëzueshëm (presumptio iuris) se prona e kryerësit të akuzuar për veprë penale të kryer në kuadër të një bashkimi kriminal apo ndonjë veprë tjetër të përcaktuar me ligj është e ardhur nga aktiviteti kriminal. Ky supozim bazohet në vetë natyrën e atyre aktiviteteve kriminale dhe si pasojë të drejtëpërdrejtë e ka bartjen e barës së të provuarit tek kryerësi. Nëse ai nuk ka sukses në dëshmimin e prejardhjes ligjore të pasurisë së tij, supozimi nuk është rrëzuar dhe pasuria e tij do të konfiskohet. Këtu qëndron dallimi ndërmjet konfiskimit të zgjeruar dhe dënimit të kahershëm të konfiskimit gjeneral e cila e përfshinte të gjithë pasurinë e të akuzuarit pa marrë parasysh prejardhjen ligjore të saj (prandaj paraqet edhe dënim). Vendosja e një supozimi të tillë ligjor në të drejtën materiale përndryshe është e zakonshme dhe e shpeshtë, megjithatë metodë e praktikuar me të cilën, probleme të rënda procedurale të provuarit të cilat rëndë mund të zgjidhen, transformohen në institute materiale.⁴⁵

2.4. Konfiskimi nga personat juridikë

Me vendosjen e përgjegjesisë penale për personat juridik dhe dënimin e personave juridik në Kodin penal të Republikës së Maqedonisë parashihet konfiskimi i pasurisë dhe dobisë pasurore nga personi juridik si kryerës i veprës penale nën kushtet e parapara me ligj. Kur me anë të veprës penale të kryer nga ana e kryesit përfitohet dobi pasurore për personin juridik, dobia pasurore konfiskohet nga ai.⁴⁶ Me këtë dispozitë rregullohet konfiskimi i dobisë pasurore nga personi juridik i cili nuk është kryerës i veprës penale por e ka statusin e “personit të tretë” për të cilin është realizuar dobia pasurore (për shembull te vepra penale mashtrim ku parashihet se “për vete apo për ndonjë tjetër të fitojë dobi pasurore të kundërligjshme”) ose tek të cilët është bartur dobia pasurore (me dhuratë, me kompenzim fiktiv etj.).⁴⁷ Nëse nga personi juridik nuk mundet që të konfiskohet prona ose dobia pasurore për shkak se ka pushuar së ekzistuari para zbatimit të konfiskimit, pasardhësi përkatësisht pasardhësit juridik të atij personi juridik, themeluesi ose themeluesit e personit juridik, përkatësisht akcionerët ose bashkëthemeluesit tek shoqëritë tregtare në rastet e parapara me

⁴⁵ Камбовски, Владо & Мисоски, Бобан. Материјално - правни и процесно - правни аспекти на конфискацијата на имотна корист и на имот, Истражување во рамки на проектот „Реформа на казненото право и почитување на човековите права - подготовки за доследна примена на новиот ЗКП—, Скопје, 2009.

⁴⁶ Kodi penal i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 37/1996 datë 29.07.1996, neni 100.

⁴⁷ Камбовски, Владо. Научен и практичен коментар на Кривичниот законик на Република Македонија, Скопје 2015, fq.602.

ligj, solidarisht do të detyrohen të paguajnë një shumë të hollash e cili korespondon me dobinë pasurore të fituar.⁴⁸

2.5. Marrja e sendeve

Askush nuk mund ta mbajë ose ti përvetësojë sendet të cilat janë paraqitur nga kryerja e veprës penale. Nga kryesi i veprës penale do të merren edhe sendet të cilat kanë qenë të destinuara ose të përdorura për kryerjen e veprës penale pa marrë parasysh se a janë pronë e tij apo pronë e ndonjë personi të tretë nëse këtë e kërkojnë interesat e sigurisë së përgjithshme, shëndeti i njerëzve apo arsytet e moralit. Sendet e përdorura apo të destinuara për kryerjen e veprës penale mund të merren nëse ekziston rrezik që ato përsëri të përdoren për kryerjen e veprës penale. Nuk do të konfiskohen sendet të cilat janë në pronësi të personit të tretë përveç nëse ai e ka ditur apo ka qenë i detyruar ta dijë se kanë qenë të përdorura ose të destinuara për kryerje të veprës penale. Gjyqi do të sjellë vendim për marrjen e sendeve në procedurë të përcaktuar me ligj edhe kur për shkak të pengesave faktike dhe juridike nuk është e mundur zhvillimi i procedurës penale ndaj kryesit të veprës penale. Në kushte të parapara me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare, prona e konfiskuar mundet që ti kthehet ndonjë shteti tjetër.⁴⁹ Bëhet fjalë për marrje prej kryerësit ose personit të tretë produktet e veprës penale (producta sceleris) siç janë për shembull falsifikimi i parave, armë e përpunuar, droga e prodhuar etj. Është e përshkruar edhe marrje obliguese prej kryerësit të veprës penale të sendeve të cilat kanë qenë të dedikuara ose të përdorura për të kryer veprë penale pa marrë parasysh nëse është në pronësi. Marrja ka të bëjë me instrumentet e veprës (instrumenta sceleris) mjetet me të cilat është kryer vepra penale siç janë pistoleta e përdorur për vrasje automjeti me të cilin transportohet droga etj. Këto mjete i meren kryerësit edhe kur janë në pronësi të personave të tretë nëse këtë e kërkojnë interesat e përcaktuar në mënyrë ligjore, siguria e përgjithshme (ndalesa për armë) shëndeti i njerëzve (helmet materiale e tjera të rrezikshme) ose principet e moralit (materiale me pornografi fëmijësh). Bëhet fjalë për sende të cilat janë jashtë qarkullimit juridik gjegjësisht i nënshtrohen regjimit të posaçëm të kujdesit ose lejeve. Marrja fakultative është e paraparë për sendet të shfrytëzuara për të kryer veprë penale nëse ekziston rrezik përsëri të shfrytëzohen për veprë penale. Marrja e instrumenteve

⁴⁸ Кошевалиска Олга & Максимова Елена. Конфискација на имот и имотана корист во случај на аболиција, Општествените промени во глобалниот свет Зборник на трудови, Универзитет „Гоце Делчев“ - Штип, Правен факултет, Центар за правно политички истражувања, Штип 2016, fq. 315-316

⁴⁹ Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit penal të Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.19/04 datë 30.03.2004, neni 59.

të rezikshëm të veprës penale është e përafërt me të mëparshmen, marrje e detyrueshme e sendeve kur atë e kërkojnë interesat e posaçme të sigurisë ose shëndetit të njerëzve, bëhet fjalë për sende të cilat në konstelacion konkret të rrethanave mund përsëri të shfrytëzohen si mjete për kryerje të veprës (automobil me bunker special për të fshehur sende, aparate për të hapur arkë etj.).⁵⁰

Nga instrumentet dhe produktet e veprës penale dallohen “corpora delicti” objektet, gjegjësisht sendet mbi të cilat kryhet vepra. Kështu për shembull te vepra penale mbajtja e armës pa leje ose materiale plasëse dënohet edhe vetë mbajtja e armës pa leje. Sendet e tilla nuk janë produkt i veprës penale por mund të llogariten për sende të dedikuara për të kryer veprë penale edhe në kuptimin më të gjërë. Megjithatë që tu shmanget dyshimeve të mundshme ligji më shpesh me dispozita të posaçme për veprat e tilla parasheh marrje të detyrueshme edhe të objekteve të veprës (drogë, armë etj.). Së bashku me sendet e dedikuara ose të shfrytëzuara për të kryer veprë penale kur është paraparë marrje e detyrueshme e mallrave dhe mjeteve për bartjen dhe shpërndarjen e tyre gjyqi mund të lëshohet në vlerësimet e ekzistimit të kushteve për shqiptim të kësaj mase sipas dispozitave të pjesës së përgjithshme.⁵¹

Marrja e sendeve dhe konfiskimi janë të parapara me ligj si masa karakteristike të drejtuara kundrejt pasurisë e cila është produkt i ndonjë veprë penale ose ka shërbyer për kryerjen e saj. Qëllimi i këtyre masave është që kryerësi i veprës penale të privohet nga posedimi dhe shfrytëzimi i pasurisë së fituar në kundërshtim me ligjin.

Duhet theksuar se marrja e sendeve dhe konfiskimi dallohen nga njëra tjetra. Derisa marrja e sendeve është masë e cila shqiptohet për marrjen e përkohshme të sendeve ose pronës të cilat kanë shërbyer për kryerjen e veprës penale dhe të njëjtat mund të konsiderohen edhe si prova materiale për të dëshmuar ekzistimin e veprës penale, konfiskimi nga ana tjetër paraqet një masë përfundimtare e drejtuar ndaj pasurisë së kryerësit të veprës penale të cilën gjyqi e shqipton me sjelljen e aktgjykimit.

⁵⁰ Kambovski, Vllado. E drejta penale e përgjithshme, Shkup 2007, fq.606.

⁵¹ Камбовски, Владо. Научен и практичен коментар на Кривичниот законик на Република Македонија, Скопје 2015, fq.604.

KAPITULLI II

1. KONFISKIMI I PASURISË DHE DOBISË PASURORE DHE MARRJA E SENDEVE SIPAS LIGJIT PËR PROCEDURË PENALE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Kur flasim për mënyrën e zbatimit të procedurës gjyqësore në lidhje me konfiskimin në të drejtën krahasimore, mund të theksojmë se ekzistojnë dy modele të marrjes së sendeve dhe konfiskimit të pronës dhe dobisë pasurore. Nga njëra anë ekzistojnë shtete të cilat shqiptimin e masave të marrjes dhe konfiskimit të pronës e zbatojnë në kuadër të procedurës penale ekzistuese, të cilat nuk kanë sjellë ligje të posaçme, por me modifikimin e ligjeve ekzistuese vetëm kanë inkuadruar dispozita të posaçme si përjashtim nga dispozitat e përgjithshme, me të cilat mundësohet zbatimi i konfiskimit të pasurisë. Shtete të tjera e kanë reformuar legjislacionin e tyre në masë më të madhe dhe kanë sjellë ligje të posaçme nga fusha e konfiskimit të pasurisë dhe e kanë rregulluar procedurën për konfiskim dhe marrje të sendeve me dispozita të veçanta. Republika e Maqedonisë është nga ato shtete të cilat procedurën për marrjen e sendeve dhe konfiskimin e pronës dhe dobisë pronësore të fituar me veprë penale e parasheh në kuadër të ligjit për procedurë penale. Përkatësisht procedura e konfiskimit pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit me të cilin është shqiptuar kjo masë rregullohet me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve dhe me Ligjin për menaxhim me pronë të konfiskuar.

Është e rëndësishme që të bëhet ndarja dhe dallimi i marrjes së përkohshme të sendeve ose pronës nga konfiskimi i përkohshëm i pronës dhe nga konfiskimi përfundimtar. Derisa marrja e përkohshme e sendeve ose pronës realizohet para se të sjellet aktgjykimi dhe shërben për sigurimin dhe marrjen e sendeve ose pronës të cilat i kanë shërbyer kryerjes së veprës penale ose janë produkt i veprës penale, konfiskimi i përkohshëm nga ana tjetër ka të bëjë me konfiskimin e dobisë pasurore e cila supozohet se është fituar me kryerjen e veprës penale, e cila procedurë gjithashtu realizohet para se të sjellet aktgjykimi si masë e përkohshme. Ndërsa konfiskimi përfundimtar paraqitet si një procedurë e veçantë dhe realizohet pas sjelljes së aktgjykimit të plotfuqishëm me të cilin i akuzuari shpallet fajtor dhe përcaktohet konfiskimi i pasurisë dhe dobisë pasurore të fituar me veprë penale.

1.1. Sigurimi dhe marrja e përkohshme e sendeve ose pronës

Gjatë procedurës penale paraqitet nevoja për zbatimin e masave për sigurimin e provave materiale të cilat do të shërbejnë në procedurën penale si dëshmi në bazë të të cilave gjyqi do ta sjellë vendimin e vet.

Sigurimi dhe marrja e përkohshme e sendeve, paraqesin veprime hetimore me të cilat mblidhen prova dhe objekte të cilat mund të shërbejnë për vërtetimin e fakteve ose janë të nevojshme për zhvillimin e procedurës penale. Këto veprime përmbajnë në vete masën e një detyrimi procedural me të cilat arrihen disa qëllime: të sigurohen prova të nevojshme për zhvillimin e procedurës penale, garantohet siguria e njerëzve në rastet kur merren sendet me të cilat mundet që të kryhen veprat penale, sigurohet efikasitet më i madh në zbatimin e procedurës penale dhe parandalimin e kriminalitetit.⁵²

Në ligjin për procedurë penale⁵³ parashihet se sendet që sipas Kodit penal duhet të merren ose që mund të shërbejnë si prova në procedurën penale perkohesisht do të konfiskohen dhe do t'i dorezohen në ruajtje prokurorit publik ose organit të percaktuar me ligj të veçantë ose në menyre tjetër do të sigurohet ruajtja e tyre. Urdhri për konfiskim të perkohshëm të sendeve e lëshon gjykata me propozim të policisë së jurisprudence ose prokurorit publik. Urdhri për konfiskimin e perkohshëm të sendeve i përmban: emrin e gjykates, bazen juridike për konfiskimin e perkohshëm të sendeve, percaktimin dhe përshkrimin preciz të sendeve që duhet perkohesisht të konfiskohen, emrin dhe mbiemrin e personit nga i cili perkohesisht duhet të konfiskohen sendet, vendin në të cilin perkohesisht duhet të konfiskohen sendet, afatin në të cilin duhet të konfiskohen dhe keshilla për mjetin juridik.⁵⁴

Nga dispozitat ligjore mund të konstatojmë se këtë masë të veçantë gjyqi e shqipton para sjelljes së aktgjykimit ose aktvendimit me të cilin përfundon procedura penale, ndërsa sa u përket sendeve të marra në këtë fazë të procedurës penale me anë të kësaj mase, të njëjtat pas plotëfuqishmërisë së vendimit duhet ti kthehen ose ti merren përfundimisht të akuzuarit varësisht nga lloji i vendimit të cilin e ka sjellë gjyqi për fajsinë e të akuzuarit. Domethënë se nëse i akuzuari është shpallur fajtor këto sende do të merren, ndërsa nëse i akuzuari lirohet

⁵² Напредни обуки за новиот ЗКП, МОДУЛ: 2, ИСТРАЖНА ПОСТАПКА –Прирачник, Академија за судии и јавни обвинители “Павел Шатов,, Скопје 2013, fq.26

⁵³ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010 datë 18.11.2010.

⁵⁴ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 194 paragrafi 1, 2 dhe 3.

nga aktakuza ose aktakuza kundër tij refuzohet për ndonjë arsye tjetër, atëherë sendet e marra nga gjyqi me këtë masë do ti kthehen të akuzuarit.

Ligji për procedurë penale⁵⁵ parasheh se secili që mban sende të cilat duhet të konfiskohen ose që mund të sherbejnë si prova në procedurën penale është i obliguar që t'i dorëzojë. Gjykatesi i procedurës paraprake sipas propozimit të arsyetuar të prokurorit publik do ta denojë personin i cili do të refuzojë t'i dorëzojë sendet me denim në para e nëse personi edhe mëtej refuzon t'i dorëzojë sendet do të dënohet edhe me dhjetëfishin e shumës së paraparë me ligj. Për ankesën kundër aktvendimit me të cilin është shqiptuar denim me para, vendos keshilli penal i gjykatës kompetente që parashihet në ligjin për procedurë penale. Ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e aktvendimit.⁵⁶

Siç mund të shohim kjo masë mund të ketë efekt edhe ndaj personave të tretë e jo vetëm ndaj të akuzuarit. Mirëpo në këtë rast personat e tretë do ti nënshtrohen një dënimi nga gjyqi nëse refuzojnë të dorëzojnë sendet e tilla të cilat i kanë në posedim ose pronësi, domethënë se në këtë rast përjashtohet marrja e detyrueshme e sendeve pasi që një gjë e tillë do të mund të ndodhte pas sjelljes së aktgjykimit me të cilin i akuzuari është shpallur fajtor dhe me të cilin do të vërtetohet se sendet e tilla kanë shërbyer për kryerjen e veprës penale ose janë produkt i veprës penale.

Sendet mundet përkohesisht të merren edhe pa urdher nga gjykata nëse ekziston rrezik nga prolongimi dhe për të cilat ekzistojnë baza për dyshim se janë lëndë të veprës penale. Nëse personi i cili bastiset në menyrë të prerë kundërshton në konfiskimin e sendeve, prokurori publik në afat prej 72 orëve nga bastisja e realizuar do të parashtojë kërkesë te gjykatesi në procedurën paraprake për konfiskimin e sendeve. Nëse gjykatesi i procedurës paraprake e refuzon kërkesën e prokurorit publik, sendet e konfiskuara nuk mund të shfrytezohen si prova në procedurën penale. Sendet e konfiskuara përkohesisht, menjëherë do t'i kthehen personit nga i cili janë marrë.⁵⁷

Edhe pse në dispozitat e Ligjit për procedurë penale është paraparë se personi i cili mban sende të tilla është i detyruar që ti dorëzojë por megjithatë karakteri i detyrueshëm tek kjo masë hetuese është më i ndryshëm nga karakteri i detyrueshëm i masës hetimore të bastisjes. Pasiqë te bastisja në raste të tilla sendet merren dhunshëm, në këto raste prokurori publik paraqet propozim të arsyetuar deri te gjykatesi i procedurës paraprake për shqiptimin e

⁵⁵ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010.

⁵⁶ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 195 paragrafi 1

⁵⁷ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 196.

dënimit ndaj atij personi (përveç të dyshuarit). Për të gjitha sendet e marra përkohësisht lëshohet vërtetim në të cilat duhet që të përcaktohet përshkrim i detajuar i sendeve me karakteristikat të cilat e përcaktojnë identitetin e tyre. Nga kushtet e përmendura më lartë për marrjen e përkohshme të sendeve del se të gjitha sendet të cilat mund të shërbejnë si provë në procedurë penale në rast se ekziston urdhëresë gjyqësore mundet që të merren por kjo nuk është gjithmonë kështu. Ligji e ka bërë distinkcionin e sendeve të cilat mund të merren dhe sendeve të cilat nuk mund të merren me urdhëresë gjyqësore.⁵⁸

Ligji për procedurë penale i parashih shprehimisht edhe rastet kur sendet nuk mund të konfiskohen. Kështu, me urdher gjyqësor nuk mund të konfiskohen: shkresa ose dokumente tjera të organeve shtetërore me publikim e të cilave do të shkelej ruajtja e sekretit shtetëror ose ushtarak, derisa organi kompetent ndryshe nuk vendos, paraqitjet me shkrim të të akuzuarit të mbrojtjes ose personat të cilat nuk mund të jenë dëshmitarë ose nuk janë të detyruar që të jenë dëshmitarë, përveç nese i akuzuari vullnetarisht nuk i dorezon, inçizimet teknike që gjenden te personat e liruar nga detyra për të dëshmuar e të cilat ata i kane bere për faktet për të cilet jane liruar nga detyra për dëshmim, pastaj shënimet, ekstraktet nga regjistri dhe dokumente të ngjashme të cilat gjenden tek personat të cilët janë të liruar nga detyrimi për të dëshmuar e të cilat i kane bere për faktet për të cilat ato në kryerjen e profesionit të vet i kanë mësuar nga i akuzuari dhe shenimet për faktet që i kane bërë gazetaret ose redaktoret e tyre në mjetet për informim publik nga burimi i informimit dhe të dhenat të cilat i kane mësuar në kryerjen e profesionit të vet dhe të cilat jane përdorur gjate redaktimit të mjeteve për informim publik, të cilat gjenden nën zoterimin e tyre ose në redaksine në të cilen jane punesuar. Sa i përket kësaj ndalesë për marrjen e sendeve parashihen edhe disa përjashtime, kështu që ndalesa e tillë nuk zbatohet në lidhje me mbrojtjesin ose personin e liruar nga detyra e dëshimit nese ekziston dyshim i bazuar se të akuzuarit i ka ndihmuar në kryerjen e vepres penale, ose i kane dhene ndihme pas kryerjes së vepres penale ose kane vepruar si fshehes, ose nese behet fjale për sende që duhet të konfiskohen sipas Kodit penal.⁵⁹

Si një lloj i veçantë i marrjes së përkohshme të sendeve në ligjin për procedurë penale paraqitet marrja e të dhënave kompjuterike. Në këtë rast vlejné të gjitha rregullat e lartpërmendura për marrjen e përkohshme të sendeve por këtu si lëndë e marrjes janë të dhëna të ruajtura në kompjuter dhe pajisje të ngjashme për perpunim automatik, perkatesisht perpunim elektronik të të dhenave, pajisje të cilat shërbejnë për grumbullimin dhe

⁵⁸ Напредни обуки за новиот ЗКП, МОДУЛ: 2, ИСТРАЖНА ПОСТАПКА –Прирачник, Академија за судии и јавни обвинители “Павел Шатев,, Скопје 2013, fq.27.

⁵⁹ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 197.

transmetimin e të dhënave, bartës të të dhënave dhe informacioneve parapaguese me të cilat disponon dhënësi i shërbimeve. Me kërkesë me shkrim të prokurorit publik, keto të dhëna duhet t'i dorëzohen prokurorit publik në afatin që ai e përcakton. Në rast të refuzimit të dorëzimit, do të merren edhe pa urdhër gjyqësor. Gjykatësi i procedurës paraprake me propozim të prokurorit publik mundet me aktvendim të përcaktojë mbrojtje dhe ruajtje të të dhënave kompjuterike derisa ajo është e nevojshme, ndërsa më së voni 6 muaj. Pas skadimit të kësaj periudhe të dhenat do të kthehen, përveç nëse nuk janë të përfshira në realizimin e veprës penale dëmtim dhe depërtim në sistemin kompjuterik, mashtrim kompjuterik, dhe falsifikim kompjuterik, nëse nuk janë të përfshira në realizimin e veprës tjetër penale me ndihmën e kompjuterit dhe nëse nuk shërbejnë si provë për vepër penale. Kundër aktvendimit të gjyqësit të procedurës paraprake me të cilën janë përcaktuar masat e lartpërmendura personi që e shfrytëzon kompjuterin dhe personi që është dhënësi i shërbimeve kanë të drejtë ankese në afat prej 24 orësh. Për ankesën vendos këshilli penal i gjykatës kompetente.⁶⁰

Përkohesisht mund të konfiskohen letrat, telegramet dhe dërgesat tjera të dërguara te i akuzuari ose ato që ai i ka dërguar, e të cilat gjenden te personat juridik në lëmin e komunikimeve postare, telegrafike dhe komunikim tjetër, nëse ekzistojnë rrethana për të cilat mund të pritet se ato do të shërbejnë si dëshmi në procedurë.⁶¹ Pa dyshim se këtu bëhet fjalë për një masë shumë specifike me të cilën depërtohet në privatësinë e njerëzve dhe respektimin e të drejtës së lirisë së shprehjes dhe mos cenimit të fshehtësisë së letrave dhe mjeteve të komunikimit të cilat janë të parapara në nenin 8 të Konventës europiane për të drejtat dhe liritë e njeriut. Për këtë arsye mund të themi se me këtë veprim hetimor mblidhen dëshmi me efekt të ngjajshëm si në rastin e zbatimit të masave të veçanta hetimore. Për këtë arsye ligji për procedurë penale i parasheh në mënyrë precize dhe përcakton kushtet dhe mënyrën e zbatimit të kësaj mase hetimore. Kështu, kushti i ekzistimit të rrethanave për të cilat mund të pritet se ato do të shërbejnë si dëshmi në procedurë, nuk është i përcaktuar për marrjen e sendeve të tjera, dhe me këtë theksohet nevoja që prokurori publik gjatë parashtrimit të kërkesës për dhënien e urdhërësës të konkretizojë ekzistimin e rrethanave të tilla për dallim nga veprimet e tjera hetimore ku është e mjaftueshme që vetëm të ekzistojë supozimi se të dhënat e tilla do të mund të kishin shërbyer si provë në një procedurë penale.⁶²

⁶⁰ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 198.

⁶¹ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 199, paragrafi 1.

⁶² Напредни обуки за новиот ЗКП, МОДУЛ: 2, ИСТРАЖНА ПОСТАПКА –Прирачник, Академија за судии и јавни обвинители “Павел Шатев,, Скопје 2013, fq.29.

Urdhrin për marrje të perkohshme të dërgesave e lëshon gjykatësi i procedurës paraprake me propozim të prokurorit publik. Urdhrin për marrjen e perkohshme të dërgesave mund ta lëshojë edhe prokurori publik nëse ekziston rrezik nga prolongimi, me atë që ky urdher duhet të jetë i vërtetuar nga ana e gjykatësit të procedurës paraprake në afat prej 72 orëve nga konfiskimi i perkohshëm i dërgesave. Nëse urdhri nuk vërtetohet ato dërgesa nuk mund të shfrytëzohen si prova në procedurën penale.⁶³

Nëse ekziston dyshim i bazuar se ndonjë person i caktuar në llogaritë e veta bankare pranon, ruan, transmeton ose në mënyrë tjetër disponon me të ardhura nga vepra penale, e ajo e ardhur është e rëndësishme për procedurën hetuese të asaj vepre penale ose sipas ligjit i nënshtrohet marrjes së detyrueshme, me kërkesë të arsyetuar nga prokurori publik, gjykata mund të lëshojë aktvendim me të cilin bankës ose institucioneve tjera financiare do t'i urdhëroje që t'i dorëzojnë dokumentacion dhe të dhënat për llogaritë bankare dhe transaksionet tjera financiare dhe punët e atij personi, si dhe për personat për të cilët në mënyrë të bazuar besohet se janë të përfshirë në ato transaksione financiare ose punë të të dyshuarit, nëse të dhënat e tilla do të mund të jenë prova në procedurën penale. Kërkesa e prokurorit publik ka të bëjë me të dhënat e personit juridik ose fizik, për të gjitha të ardhurat që i pranon, ruan, transmeton ose në mënyrë tjetër disponon me to. Nëse personi ruan në arkë bankare, ose në mënyrë tjetër disponon me të ardhura nga vepra ndëshkuese, ndërsa ajo e ardhur është e rëndësishme për procedurën hetuese për atë veper penale ose sipas ligjit i nënshtrohet konfiskimit me detyrim, me kërkesën e arsyetuar nga prokurori publik, gjykata mund të lëshojë aktvendim me të cilin do t'i urdhërohet bankës që t'i mundësojë prokurorit publik qasje te arka. Në aktvendim do të përcaktohet edhe afati në të cilin banka ose institucioni tjetër financiar doemos duhet të veprojë sipas tyre.⁶⁴

Para fillimit dhe gjatë procedurës hetuese vendimin sipas kërkesës së prokurorit publik e sjell gjykatësi i procedurës paraprake, ndërsa pas ngritjes së akuzes gjykata para të cilës do të mbahet shqyrtimi. Gjykatesi i procedurës paraprake vendos sipas kërkesës së prokurorit publik menjëherë, e më së voni në afat prej 12 orësh nga pranimi i kërkesës. Nëse gjykatësi i procedurës paraprake nuk e pranon kërkesën e prokurorit publik, pa prolongim do të kërkojë

⁶³ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 199, paragrafi 2, 3 dhe 4.

⁶⁴ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 200 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4.

që vendimin ta miratojë keshilli penal i gjykatës kompetente. Keshilli miraton vendim në afat prej 24 orësh nga pranimi i kërkesës.⁶⁵

Nëse ekzistojnë rrethanat e parapara me ligj, me propozim të arsyetuar të prokurorit publik, gjykatësi i procedurës paraprake mundet me aktvendim ta detyrojë bankën ose institucionit tjetër financiar që t'i hetojë qarkullimin pagesor, transaksionet e llogarive ose punët tjera të personit të caktuar dhe rregullisht ta njoftojë prokurorin publik për kohën e përcaktuar në aktvendim. Me propozimin e arsyetuar të prokurorit publik, gjykata me aktvendim mund ta urdhërojë institucionin financiar ose personin juridik që përkohësisht ta ndërpresin realizimin e transaksionit të caktuar financiar ose punës, ndërsa prona përkohësisht konfiskohet. Në raste urgjente prokurori publik mund t'i shqiptojë masat e lartpërmendura edhe pa urdhër gjyqësor. Për masat e ndërmarra prokurori publik menjëherë e njofton gjykatësin e procedurës paraprake, i cili në afat prej 72 orësh duhet ta lëshojë urdhrin. Në rast se gjykatësi i procedurës paraprake nuk lëshon urdhër, prokurori publik do t'i kthejë të dhënat pa i hapur paraprakisht.⁶⁶

Nga dispozitat e lartë përmendura shihet se për shqiptimin e masës së marrjes së sendeve të cilat mund të shërbejnë si dëshmi në procedurën penale e cila është duke u zhvilluar ose ende nuk ka filluar, prokurori publik duhet të bëjë të besueshme se këto sende gjenden tek i akuzuari ose tek personi tjetër me çrast duhet që të ndërmerren një varg veprimesh hetimore. Kjo si pasojë mund të ketë edhe zvarritjen e procedurës që mund të ndodhë edhe për shkak të mosgadishmërisë së institucioneve të ndryshme të cilat kanë sende të cilat duhet të merren, për të bashkëpunuar.

1.2. Konfiskimi i përkohshëm i pasurisë ose sendeve

Në dispozitat e kodit penal si dispozita materiale përcaktohen rregullat e përgjithshme të konfiskimit, baza e konfiskimit, llojet e konfiskimit dhe rastet kur duhet të zbatohet konfiskimi, ndërsa me dispozitat e Ligjit të procedurës penale përcaktohet mënyra e zbatimit të masës së konfiskimit por edhe sekuestrimi paraprak i pronës së fituar me vepër penale si një masë siguroese për konfiskim i cili do të shqiptohet me aktgjykimin me të cilin i akuzuari

⁶⁵ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 200, paragrafi 5.

⁶⁶ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 200, paragrafi 6, 7 dhe 8.

shpallet fajtor. Kështu, në ligjin për procedurë penale parashihet marrja e përkohshme e pasurisë.

Përveç nevojës për zbatimin e masave për sigurimin e provave materiale në procedurë penale mund të paraqitet nevoja edhe për sigurimin e interesave pasurore. Masa për sigurimin e interesave pasurore zbatohet me vendim të gjykatës ex officio ose në bazë të iniciativës së personit të autorizuar. Te konfiskimi i dobisë pasurore masa në fjalë merret kryesisht, përndryshe masa me të cilën sigurohet interesi pasuror ka karakter të përkohshëm.⁶⁷

Sigurimi dhe konfiskimi i përkohshëm i pasurisë ose sendeve konsiston në marrjen e dobisë pasurore e cila supozohet se është fituar me kryerjen e veprës penale para se të sjellet aktgjykimi, me qëllim të parandalimit të fshehjes së kësaj mënyre të fitimit të dobisë pasurore. Konfiskimi i përkohshëm i pasurisë ose sendeve është masë me karakter preventiv, e cila njëkohësisht është edhe një procedurë e mëvetësishme e marrjes së sendeve dhe pronës të cilat rrjedhin nga vepra penale, e cila është themeluar me qëllim të pengimit të tjetërsimit të pronës e cila merret. Karakteri i saj është para se të gjithash preventiv prandaj edhe kohëzgjatja e saj është e përkohshme. Kjo procedurë nuk është ndonjë risi në legjislacionet penale por ajo paraqet një procedurë të zakonshme e paraparë në procedurën e rregullt penale. Në procedurën penale është e mundur që të merret dobia pasurore e fituar me veprë penale por ajo është e kushtëzuar me sjelljen e aktgjykimit, domethënë se dobia pasurore merret pasi që të ketë përfunduar procedura gjyqësore dhe i akuzuari të jetë shpallur fajtor.

Gjykata mundet në çfarëdo kohe gjatë procedurës penale ta miratojë me kërkesë të prokurorit publik, masën e përkohshme konfiskim të pronës ose sendeve të cilat sipas Kodit penal duhet të konfiskohen, masën e konfiskimit ose masë tjetër të domosdoshme që të pengohet shfrytëzimi, tjetërsimi ose posedimi me atë pronë ose send.⁶⁸

Kushtet për përcaktimin e këtyre masave nga ana e gjykatës duhet të bazohen në: ekzistimin e dyshimit se pasuria, përkatësisht sendet, rrjedhin nga vepra penale dhe të ekzistojë besueshmëria se deri në fund të procedurës penale do të vështirësohet veçanërisht ose do të pamundësohet marrja e pasurisë ose sendeve.⁶⁹ Këto kushte i parasheh ligjdhënësi si elemente kryesore të cilat duhet ti përmbajë kërkesa e prokurorit drejtuar gjyqit për konfiskim të përkohshëm të sendeve ose të pronës. Kërkesa e prokurorit publik për konfiskimin e përkohshëm të pronës ose sendeve për shkak të sigurimit të tyre permban përkohshëm të

⁶⁷ Sahiti, Ejup & Zejneli Ismail. E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, Universiteti i Europës juglindore në Tetovë, Fakulteti i drejtësisë, Tetovë 2017, fq.150

⁶⁸ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 202 paragrafi 1.

⁶⁹ Напредни обуки за новиот ЗКП, МОДУЛ: 2, ИСТРАЖНА ПОСТАПКА –Прирачник, Академија за судии и јавни обвинители “Павел Шатев,, Скопје 2013, fq.32.

shkurtër të veprës penale dhe emërtimin e saj ligjor, përshkrimi i pronës ose sendeve që rrjedhin nga kryerja e veprës penale, të dhëna për personin që e posedon atë pronë ose sende, prova në të cilat bazohet dyshimi se prona, përkatesisht sendet, rrjedhin nga vepra penale dhe shkaqet e probabilitetit se deri në fund të procedurës penale do të jetë veçanërisht e rënduar ose e pamundur konfiskimi i pronës ose sendeve.⁷⁰

Nga dispozita e lartpërmendur del se si kushte kryesore për shqiptimin e masës së përkohshme të konfiskimit të pasurisë dhe dobisë pasurore paraqiten dy. Kushti i parë është që të ekzistojë dyshim i bazuar se prona ose sendi i caktuar rrjedhin nga kryerja e veprës penale. Ky kusht është tepër i rëndësishëm për arsye se përcakton një nivel më të lartë të provuarit për përcaktimin e kësaj mase të cilën duhet ta vërtetojë prokurori publik me kërkesën për shqiptimin e kësaj mase. Rëndësia e ekzistimit të dyshimit të bazuar qëndron edhe në atë se me shqiptimin e kësaj mase preken të drejta pronësore të të akuzuarit ose të dyshuarit të cilat janë të garantuara me kushtetutë dhe konventa ndërkombëtare. Kushti i dytë është që të ekzistojnë shkaqet e probabilitetit se deri në fund të procedurës penale do të jete veçanërisht e rënduar ose e pamundur konfiskimi i pronës ose sendeve, të cilin kusht prokurori publik duhet që në çdo rast konkret ta arsyetojë.

Konfiskimi i përkohshëm i pasurisë fillon me kërkesë të prokurorit publik. Kjo mund të konsiderohet si një fazë e veçantë e konfiskimit të pronës e cila ka për qëllim mënjanimin e rezikut nga tjetërsimi të pronës dhe në pamundësinë e zhvillimit të kësaj procedure pas sjelljes së aktgjykimit. Varësisht se në cilën fazë gjendet procedura penale përcaktohet edhe kompetenca për të vendosur në lidhje me kërkesën për konfiskim të përkohshëm.

Para fillimit edhe gjatë procedurës paraprake sipas kërkesës së prokurorit publik aktvendim sjell gjykatësi i procedurës paraprake, ndërsa pas ngritjes së akuzës gjykata para të cilës do të mbahet shqyrtimi. Gjykatësi i procedurës paraprake vendos sipas kërkesës së prokurorit publik menjëherë, e më së voni në afat prej 12 orësh nga pranimi i kërkesës. Nëse gjykatësi i procedurës paraprake nuk e pranon kërkesën e prokurorit publik, pa prolongim do të kërkojë që vendim të miratojë këshilli penal i gjykatës kompetente. Këshilli miraton vendim në afat prej 24 orësh nga pranimi i kërkesës. Në aktvendimin për shqiptimin e masave të konfiskimit gjykata do ta theksojë vlerën dhe llojin e pronës, përkatesisht sendit, dhe kohën për të cilën konfiskohet.⁷¹

⁷⁰ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 202 paragrafi 2.

⁷¹ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 202 paragrafi 3 dhe 4.

Në këto dispozita nuk është përcaktuar se a duhet që gjyqi të caktojë seancë të posaçme në të cilën do të shqyrtohet kërkesa e prokurorit publik për konfiskimin e përkohshëm ku i akuzuari do të mundej që me mbrojtjen e tij të deklarohet lidhur me kërkesën.

Kundër aktvendimit të gjykatësit të procedurës paraprake me të cilën janë caktuar masat mund të parashtrohet ankesë në afat prej 24 orësh. Për ankesën vendos këshilli penal i gjykatës kompetente. Ankesa nuk e ndalon zbatimin e aktvendimit.⁷²

Duke e pasur parasysh se procedura penale mund që të prolongohet me rastin e përcaktimit të konfiskimit të përkohshëm ligdhënësi ka paraparë afate të shkurtëra për sjellejn e vendimit nga ana e gjyqit si dhe vendimit në lidhje me ankesat.

Nëse ekziston rrezik nga prolongimi, policia e jurisprudencës përkohësisht mund ta konfiskojë pronën ose sendet, t'i konfiskojë ose të ndërmarrë masa tjera të domosdoshme që të pengohet çfarëdo shfrytëzimi, tjetërsimi ose posedimi i tyre. Për masat e marra duhet menjëherë të informohet prokurori publik, ndërsa masat e ndërmarra duhet të jenë të lejuara nga ana e gjykatësit të procedurës paraprake në afat prej 72 orësh nga marrja e tyre. Në qoftë se gjykatësi i procedurës paraprake nuk jep leje, masat e ndërmarra do të ndërpriten, ndërsa prona ose sendet e konfiskuara paraprakisht menjëherë do t'i kthehen personit nga i cili janë konfiskuar.⁷³

Sa i përket kohëzgjatjes së masave për konfiskim të përkohshëm ligji nuk parasheh ndonjë afat minimal të kohëzgjatjes së masave të përkohshme por parasheh kohëzgjatjen maksimale të tyre. Prandaj sa i përket kohëzgjatjes gjyqi e përcakton atë vetë sipas rethanave të rastit konkret.

Masat e shqiptuara mund të zgjasin më së shumti deri në përfundimin e procedurës penale para gjykatës së shkallës së parë. Nëse masat janë përcaktuar në procedurën paraprake, do të ndërpriten sipas detyrës zyrtare nëse procedura hetuese nuk fillon në afat prej tre muajsh nga dita e miratimit të aktvendimit me të cilin janë përcaktuar. Para skadimit të afateve masat mund të ndërpriten sipas detyrës zyrtare nga gjykata ose me kërkesë të prokurorit publik, përkatësisht personi i interesuar, nëse tregohet se nuk janë të nevojshme ose të arsyeshme duke marrë parasysh peshën e veprës penale, rastet pronësore të personit të cilat i përkasin ose rastet e personave të cilat sipas ligjit ky person është i obliguar që t'i mbajë edhe rrethanat të

⁷² Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 202 paragrafi 5.

⁷³ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 202 paragrafi 6 dhe 7.

cilat tregojnë se konfiskimi i pronës ose sendeve nuk do të pamundesohet ose veçanerisht rëndohet deri në perfundimin e procedurës penale.⁷⁴

Të gjitha veprimet mbi pronën dhe sendet që janë lëndë e sigurimit, e të cilat janë ndërmarrë pas parashtrimit të kërkesës për konfiskim, janë të pavlefshme.⁷⁵ Me këtë dispozitë ligjore përcaktohet ndalimi i disponimit me pronën e cila është objekt i konfiskimit të përkohshëm me qëllim që mos të vështirësohet ekzekutimi i mëtutjeshëm i konfiskimit pas sjelljes së aktgjykimit. Sendet që gjatë procedurës penale janë konfiskuar përkohësisht do t'i kthehen pronarit, përkatësisht mbajtësit nëse ndërpritet procedura, ndërsa nuk ekzistojnë shkaqe për konfiskimin e tyre.⁷⁶

1.3. Konfiskimi i pasurisë dhe dobisë pasurore dhe marrja e sendeve pas shpalljes së aktgjykimit

Pasi që të ketë përfunduar procedura penale dhe i akuzuari të jetë shpallur fajtor, me sjelljen e aktgjykimit mund të shqiptohet edhe masa përfundimtare e marrjes së sendeve ose konfiskimit të pasurisë dhe dobisë pasurore. Prandaj dispozitat të cilat kanë të bëjnë me marrjen e sendeve dhe konfiskimin e pasurisë dhe dobisë pasurore si masa të veçanta që shqiptohen pas përfundimit të procedurës penale e bëjnë të qartë se shqiptimi i kësaj mase është i kushtëzuar me përfundimin e procedurës penale dhe sjelljen e aktgjykimit.

Ligji për procedurë penale e rregullon procedurën për marrjen e sendeve të cilat janë përdorur për të kryer veprën penale ose janë pasojë e veprës penale. Sendet që sipas Kodit penal duhen të merren, do të merren edhe kur procedura penale nuk do të mbarojë me aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor. Aktvendim të posacëm për këtë miraton organi para të cilit është mbajtur procedura në momentin kur procedura është kryer, përkatësisht kur është ndërprerë. Aktvendimin për marrjen e sendeve e sjell gjykata edhe kur në aktgjykimin me të cilin i akuzuari është shpallur fajtor, është lëshuar marrja e vendimit të atillë. Kopja e vërtetuar e vendimit për marrjen e sendeve do të dorëzohet te pronari i sendeve nëse pronari është i njohur. Kundër aktvendimit për marrjen e sendeve pronari i sendeve ka të drejtë ankese për shkak të mosekzistimit të bazës ligjore për marrjen e sendeve. Nëse

⁷⁴ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 202 paragrafi 8, 9 dhe 10

⁷⁵ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 202, paragrafi 11.

⁷⁶ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 203.

aktvendimin nuk e ka sjellë gjykata, për ankesën vendos keshilli penal i gjykatës që ka qenë kompetente për gjykimin në shkallë të parë.⁷⁷

Nga këto dispozita ligjore shihet se ligjdhënësi i ka garantuar pronarit të sendeve të cilat janë të marra me vendim që të ankimojë vendimin e tillë nëse ai konsideron se nuk ka bazë ligjore për marrjen e sendeve. Në këtë mënyrë mbrohet e drejta e pronësisë si një e drejtë e garantuar me kushtetutë.

Konfiskim të dobise pasurore gjykata mund të shqiptojë në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, me aktvendimin për vërejtje gjyqësore ose aktvendimin për zbatimin e masës edukative, si dhe aktvendimin me të cilin shqiptohet masa e sigurisë. Në shqiptimin e aktgjykimit ose të aktvendimit gjykata do të theksojë cila pasuri ose send, përkatësisht shumë në para do të konfiskohet.⁷⁸ Kopja e vërtetuar e aktgjykimit, përkatësisht e aktvendimit i dorëzohet edhe personit mbi të cilin është bartur dobia pronësore, si edhe perfaqësuesit të personit juridik, nëse gjykata ka shqiptuar konfiskim të pronës ose dobisë pronësore nga ai person, përkatësisht nga personi juridik.⁷⁹

Duhet të theksohet se konfiskimit përfundimtar i paraprin një procedurë në të cilën ndërmerren shumë veprime hetimore e cila zhvillohet paralelisht me procedurën penale.

Prona dhe dobia pronësore të siguruara me kryerjen e veprës penale përcaktohen në procedurën penale sipas detyrës zyrtare. Prokurori publik është i obliguar që gjate procedurës të grumbullojë prova dhe t'i vëzhgojë rrethanat që janë me rëndësi për percaktimin e pronës dhe dobisë pronësore dhe të propozojë masa të përkohshme për konfiskimin e përkohshëm të sendeve ose pasurisë. Nëse i demtuari ka paraqitur kerkese pronësore-juridike në lidhje me kthimin e sendeve të siguruara me veper penale, përkatësisht në lidhje me shumën që i pergjigjet vlerës së sendeve, dobia pasurore do të përcaktohet vetëm në atë pjesë që nuk është përfshirë me kerkesen pasurorejuridike.⁸⁰

Kur hetohet vepra penale dhe kur mblidhen provat për elementet e veprës penale, për kryerësin dhe bashkëkryerësit e tij, është e domosdoshme që të zhvillohet hetim financiar paralel në rastet kur vepra penale rezulton në dobi pasurore. Duke e pasur parasysh faktin se qëllimi i hetimit financiar është që të mundësohet konfiskimi i të ardhurave, ky hetim duhet që të fillojë sa ë parë me qëllim që kryerësi të pengohet nga fshehja e pasurisë. Prandaj hetimi

⁷⁷ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 529.

⁷⁸ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 536, paragrafi 1 dhe 2.

⁷⁹ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 536, paragrafi 3.

⁸⁰ LPP I RM-së, neni 530.

financiar duhet që të fillojë menjëherë pasiqë të jetë vërtetuar i dyshuari dhe para se ai të kuptojë se kundër tij zhvillohet hetim.⁸¹

Sipas Ligjit për procedurë penale, gjate konfiskimit të pronës dhe dobisë pronësore të siguruar me vepër penale personi mbi të cilin është bartur dobia pronësore, si dhe përfaqësuesi i personit juridik, do të thirren për marrje në pyetje në procedurën paraprake dhe në seancën kryesore. Në thirrje do të paralajmërohen se procedura do të zbatohet edhe pa praninë e tyre.⁸² Përfaqësuesi i personit juridik do të merret në pyetje në seancën kryesore pas të akuzuarit. Në të njëjten mënyrë do të veprohet në lidhje me personin mbi të cilin është bartur dobia pronësore nëse nuk është thirrur si dëshmitar. Personi mbi të cilin është bartur dobia pronësore si dhe përfaqësuesi i personit juridik, janë të autorizuar që në lidhje me përcaktimin e dobisë pronësore të propozojnë prova edhe pas autorizimit të kryetarit të keshillit t'i parashtrajnë pyetje të akuzuarit, dëshmitarëve dhe ekspertëve. Përjashtimi i publikut në seancën kryesore nuk ka të bëjë me personin mbi të cilin janë bartur prona dhe dobia pronësore dhe përfaqësuesit të personit juridik. Kur gjatë seancës kryesore konstatohet se ekzistojnë kushte për zbatimin e masës konfiskim të pronës dhe dobisë pronësore, prokurori publik do të propozojë që seanca kryesore të ndërpritet dhe të thirret personi mbi të cilin janë bartur prona dhe dobia pronësore si dhe përfaqësuesi i personit juridik.⁸³

Hetimi i aseteve të konfiskimit mundet që të jetë më i vështirë se hetimi i krimeve të organizatave kriminale. Kjo pasiqë te konfiskimi, pa marrë parasysh se a bazohet në vlerë ose në pronë, duhet që të vërtetohet se pasuria rrjedh direkt ose indirekt nga kryerja e një vepre penale. Shpesh kriminelët nuk e pranojnë këtë fakt dhe shumica e tyre ndërmarrin veprime që ta fshehin atë pasuri duke shpresuar se do ti mashtrojnë ose do ti devijojnë organet hetimore.⁸⁴

Prokurori publik në grumbullimin e provave të nevojshme për përcaktimin e vlerës së shumës së pronës dhe dobisë pronësore të fituar me vepër penale, mund të kërkojë njoftime të nevojshme nga organe tjera shtetërore, institucione financiare, persona tjerë juridike dhe qytetare, të cilët detyrohen që pa prolongim të njëjtat t'i ofrojnë. Kur ekziston dyshim se prona

⁸¹ Финансиски истраги и конфискација на приходи стекнати од криминал, Прирачник за обука на органите за кривичен прогон и судство, Совет на Европа, 2006, fq.42.

⁸² Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 531 paragrafi 1.

⁸³ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 531 paragrafi 2, 3, 4 dhe 5.

⁸⁴ Manual on International Cooperation for the Purposes of Confiscation of Proceeds of Crime, United Nations, New York 2012, fq.35.

gjendet jashtë vendit, gjykata është e obliguar që të lëshojë urdhër arresti ose shpallje ndërkombëtare.⁸⁵

Gjykata do të shqiptojë masë të konfiskimit të zgjeruar nën kushtet e përcaktuara në Kodin penal, nëse i akuzuari në afat prej një viti nga dita e fillimit të seances kryesore nuk mund të dëshmojë se prona ose dobia pronësore është e fituar ligjërisht. Nëse në afatin më të shkurtër se afati i përcaktuar më lartë gjykata miraton aktgjykim të shkallës së parë për veprën penale, kur ekzistojnë kushte ligjore për shqiptimin e masës konfiskim i zgjeruar, gjykata atë masë do ta shqiptojë me aktgjykim plotësues kundër të cilit lejohet ankesë në pajtim me dispozitat e ligjit.⁸⁶ Me këtë dispozitë parashihet shqiptimi i masës së konfiskimit edhe para sjelljes së aktgjykimit por njëkohësisht janë vendosur edhe kushte për shqiptimin e konfiskimit të zgjeruar në këto raste. Kjo dispozitë mund të kuptohet gjithashtu edhe si një masë preventive në rastet kur i akuzuari në procedurën penale me rastin e shqyrtimit të konfiskimit dëshmon se prona ose dobia pronësore janë të fituara ligjërisht.

1.4. Procedurat e veçanta për konfiskim

Ligji për procedurë penale parasheh edhe disa procedura të veçanta të konfiskimit edhe atë sa i përket konfiskimit të zgjeruar ndaj personave të tretë si dhe në rastet kur ekzistojnë pengesa faktike ose juridike për zhvillimin e procedurës penale.

Gjykata me aktvendim do të shqiptojë masë konfiskim të zgjeruar me kushtet e përcaktuara në Kodin penal edhe kundër personit të tretë, nëse në afat prej dy vjetësh nga dita e fillimit të procedurës së posaçme për konfiskim, nuk dëshmon se për pronën ose dobinë pronësore ka dhënë kundërkompensim që i përgjigjet vlerës së tyre.⁸⁷ Procedura për shqiptimin e masës konfiskim i zgjeruar mbahet sipas propozimit të prokurorit publik. Kundër aktvendimit me të cilin shqiptohet konfiskimi i zgjeruar personi ka të drejtë ankese drejtpërdrejt te gjykata më e lartë në afat prej tetë ditësh.⁸⁸

Kur ekzistojnë pengesa faktike ose juridike për mbajtjen e procedurës penale kundër kryerësit të veprës penale, gjykata sipas propozimit të prokurorit publik do të zbatojë

⁸⁵ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 532.

⁸⁶ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 533.

⁸⁷ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 534, paragrafi 1.

⁸⁸ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 534, paragrafi 2.

procedurë të veçantë për konfiskim të pronës dhe dobisë pronësore dhe marrjen e sendeve, nëse janë përmbushur kushtet për zbatimin e këtyre masave të vecanta nga Kodi penal.⁸⁹

Në këtë procedurë me propozim të prokurorit publik do të nxirren provat e nevojshme. Gjykata me aktvendim do të shqiptojë masën konfiskim të pronës dhe dobisë pasurore dhe marrjen e sendeve, nëse dëshmohet se bëhet fjalë për pronë ose dobi pasurore të fituara me veprën penale, ose për sende të cilat janë përdorur ose janë krijuar me kryerjen e veprës penale ose duhet të konfiskohen sipas dispozitave të Kodit penal. Kundër këtij aktvendimi personi prej të cilit konfiskohet prona ose dobia pronësore ose merren sendet, ka të drejtë ankese te gjykata drejtpërdrejt më e lartë në afat prej tetë ditësh.⁹⁰

Edhe pse procedura për konfiskim realizohet paralelisht me procedurën penale megjithatë nga dispozitat e përmendura më lartë konstatojmë se mund të zhvillohet edhe procedurë e veçantë për konfiskim të zgjeruar ndaj personit të tretë apo kur ekzistojnë pengesa faktike apo juridike për zhvillimin e procedurës penale.

Sipas këtyre dispozitave ligjore nëse procedura penale është ndërperë për arsye faktike ose juridike (vdekja e të akuzuarit, vjetërsimi, përfshirja e veprës penale me falje apo amnisti) mund të zhvillohet procedurë e veçantë vetëm për konfiskimin e pasurisë së fituar në kundërshtim me ligjin me qëllim që kjo pasuri të mos mbetet tek kryerësi i veprës penale edhe pse ai nuk është dënuar me vendim të plotëfuqishëm. Edhe në këto raste prokurori publik duhet të zhvillojë hetim financiar me qëllim që me parashtrimin e propozimit për zhvillimin e procedurës së posaçme për konfiskim të paraqesë edhe dëshmi para gjyqit se pasuria të cilën e posedon i akuzuari ose personat e tretë është e kundërligjshme.

1.5. Realizimi i konfiskimit të pronës dhe dobisë pronësore

Konfiskimi i pronës dhe dobisë pronësore përmbarohet në afat prej 30 ditëve pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit. Urdhër për përmbarim lëshon gjykata që e ka miratuar aktgjykimin e plotëfuqishëm. Përmbarimi zbatohet mbi pronën dhe dobinë pronësore të përcaktuara me vendim gjyqësor, e nëse kjo është pjesërisht ose plotësisht nuk është e mundur, realizimi zbatohet nga prona e mbetur e personit të cilit i është shqiptuar masa e atillë. Kundërshtimi ndaj zbatueshmërisë nuk lejohet, ndërsa realizimi me detyrim do të ndërpritet vetëm nëse personi vullnetarisht e kthen pronën ose e paguan lartësinë e dobisë

⁸⁹ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 540, paragrafi 1.

⁹⁰ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 540 paragrafi 2.

pasurore në llogari të gjykatës. Bankat dhe institucionet tjera financiare ku është llogaria në të cilën është realizuar kjo masë, janë të obliguara që ta kryejnë pa asnjë prolongim dhe të mos pengojnë bartjen eventuale ose transaksionet financiare.⁹¹ Pasi që të ketë përfunduar procedura penale apo procedura e veçantë e konfiskimit konfiskimi realizohet përfundimisht, sigurisht pasi që vendimi për konfiskim të jetë i plotëfuqishëm. Ligdhënësi në këtë fazë nuk lejon ndonjë mjet juridik ndaj urdhëresës për konfiskim pasi që i akuzuari gjatë procedurës penale ose procedurës së veçantë për konfiskim i ka pasur në disponim të gjitha mjetet juridike dhe garancat për prezumimin e pafajsisë. Veprimet juridike të lidhura pas kryerjes së veprës penale, e me qëllim të zvogëlimit të vlerës së pronës që është lëndë e konfiskimit, janë të pavlefshme.⁹²

2. ZBATIMI I KONFISKIMIT TË PRONËS DHE DOBISË PASURORE DHE SEKUESTRIMI I SENDEVE SIPAS LIGJIT PËR EKZEKUTIMIN E SANKSIONEVE

Me ligjin për ekzekutimin e sanksioneve është paraparë procedura për konfiskim të pronës dobisë pasurore dhe sekuestrimi i sendeve. Mirëpo në praktikë gjykata në raste të konfiskimit dhe sekuestrimit i zbatojnë dispozitat e Ligjit për menaxhim me pronën e konfiskuar.⁹³

Ky ligj parasheh se, personit të cilit i është shqiptuar konfiskim i pronës dhe përfitimit nga prona, i sekuestrohet prona dhe përfitimet që i ka pasur në kohën kur aktgjykimi përmes të cilit i është shqiptuar është bërë i plotëfuqishëm. Gjatë zbatimit të konfiskimit të pronës dhe përfitimit nga prona, sekuestrohet prona dhe përfitimet të cilat sipas dispozitave të Ligjit për përmbarim, nuk përjashtohen nga përmbarimi në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.⁹⁴ Në ligjin për përmbarim është paraparë se janë përjashtuar nga përmbarimi të ardhurat në bazë të alimentacionit ligjot, kompensimi për dëmet që kanë ndodhur për shkak të problemeve shëndetësore, zvogëlimi apo humbja e aftësive të punës dhe kompensimi i dëmit për mbështetjen e humbur për shkak të vdekjes së dhënësit të mbështetjes, të ardhurat në bazë

⁹¹ Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 541 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4.

⁹² Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010, neni 541 paragrafi 5.

⁹³ Gjykata themelore Shkupi 1 Shkup, Raport për punën e Gjykatës themelore Shkupi 1 Shkup për vitin 2015.

⁹⁴ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë 2/2006 datë 09.01.2006, neni 343 paragrafi 1 dhe 2.

të kompensimit për shkak të dëmtimit trupor sipas dispozitave për sigurim invalidor, të ardhurat në bazë të drejtave të ndihmës në para të ndihmës sociale, të ardhurat në bazë të papunësisë së përkohshme, të ardhurat në bazë të shtesës për fëmijë, të ardhurat në bazë të bursës, kredisë dhe ndihmës së nxënësve dhe të studentëve; të ardhurat e kadetëve në Akademinë Ushtarake, kompensim për punën e të dënuarit në shtëpitë korrigjuese ndëshkuese, përveç të kërkesave në bazë të alimentacionit ligjor si dhe për kërkesat të kompensimit të dëmit të shkaktuar me vepër penale të të dënuarit, të ardhurat në bazë të shpenzimeve të rrugës dhe mjete të llogarisë së veçantë e cila e posedon përmbaruesi në pajtim me ligjin.⁹⁵

Domethënë se ndaj personave të dënuar të cilëve u është shqiptuar masa e konfiskimit të pronës dhe dobisë pasurore të fituar me vepër penale nuk do të mundet që të zbatohet kjo procedurë nëse pranojnë të ardhura sipas bazave të cilat janë të përjashtuar nga përmbarimi.

Procedurë për zbatimin e konfiskimit të pronës dhe përfitimit nga prona sipas detyrës zyrtare ngre gjykata e cila e ka shqiptuar këtë konfiskim. Për zbatimin e konfiskimit të pronës kompetencë reale ka gjykata, e cila e ka marrë vendimin në shkallë të parë. Për zbatimin e konfiskimit të pronës së patundshme kompetencë vendore ka gjykata në rajonin e së cilës gjendet patundshmëria, ndërsa për sende të tundshme, për kërkesa në para dhe të drejta të tjera pronësore, gjykata në rajonin e së cilës i dënuari ka vendbanim apo vendqëndrim. Nëse vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi i personit të dënuar është jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë, kompetenca përcaktohet në përputhje me marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare.⁹⁶

Zbatimi i dënimit konfiskim i pronës dhe sequestrim i përfitimit nga prona ndaj personit juridik, i cili në ndërkohë i është bashkangjitur një personi tjetër juridik, do të zbatohet ndaj personit juridik të i cili është transferuar prona, edhe atë deri në lartësinë e vlerës së pronës së transferuar. Në qoftë se ndaj personit juridik të dënuar është hapur procedurë falimentimi apo procedurë likuidimi, gjykata është e detyruar të dërgojë pranë gjykatës për falimentim apo gjykatës për likuidim urdhëresë për përparësi gjatë sequestrimit.⁹⁷

Nëse me zbatimin e këtyre masave vjen deri te shuarja e personit juridik, në mënyrë përkatëse aplikohen dispozitat e Ligjit për shoqëri tregtare, me të cilat rregullohet shuarja e

⁹⁵ Ligji për përmbarim, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë 72/2016 datë 12.04.2016, neni 116.

⁹⁶ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë 2/2006, neni 344.

⁹⁷ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë 2/2006, neni 345.

personit juridik. Procedurën për shuarje përmes zbatimit të konfiskimit të pronës dhe të përfitimit nga prona, e ngre gjykata me detyrë zyrtare.⁹⁸

Prona e konfiskuar kalon në pronë shtetërore në ditën e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, me të cilin është shqiptuar dënimi konfiskim i pronës dhe i dorëzohet në shfrytëzim komonës në rajonin e të cilës gjendet. Komuna të cilës i është dorëzuar në shfrytëzim prona e konfiskuar, i ndërmerr obligimet e personit të dënuar të krijuara deri në kryerjen e veprës penale që janë siguruar me heqjen e të drejtës së pengut ndaj patundshmërisë ose të verifikuara me vendim të plotfuqishëm gjyqësor, apo me marrëveshje për kredi konsumimi, edhe atë deri në lartësinë e vlerës së pronës së konfiskuar të dorëzuar. Mjetet e grumbulluara nga zbatimi i dënimit konfiskim i përfitimit nga prona, paguhen dhe sistemohen në mënyrë të caktuar në pajtim me ligjin.⁹⁹

Nëse konfiskimi i pronës ndaj personit të dënuar ndërpritet, prona e konfiskuar do t'i kthehet atij, përkatësisht trashëgimtarëve të tij. Nëse kthimi i pronës së konfiskuar ose të disa pjesëve të saj në mënyrë faktike apo juridike është e pamundur, vlera e tyre faktike kompensohet me para. Vendimin për kthimin e pronës së konfiskuar, si dhe vendimin për lartësinë e kompensimit, e merr gjykata e cila e ka realizuar zbatimin e dënimit konfiskim të pronës. Kundër vendimit të gjykatës ankesë mund të paraqesë personi i gjykuar, përkatësisht trashëgimtarët e tij dhe Avokati Publik kompetent. Ankesa paraqitet brenda tetë ditësh nga dita e pranimit të vendimit të shkallës së parë.¹⁰⁰

Nëse personi i dënuar nuk ka pronë e cila sipas ligjit do të mund të sekuestrohej, ose prona e cila do të mund të sekuestrohej ka vlerë të parëndësishme, gjykata do të marrë aktvendim për ndërprerjen e procedurës për zbatimin e konfiskimit të pronës.¹⁰¹

2.1. Marrja e sendeve

Vendimin e plotfuqishëm me të cilin janë sekuestruar sende të përdorura, ose të cilat kanë qenë të destinuara për kryerje të veprës penale apo janë krijuar përmes kryerjes së veprës penale, e zbaton gjykata e caktuar me ligj në mënyrën e përcaktuar në vetë vendimin, përmes asgjësimit ose përmes bartjes së sendeve ndonjë organi shtetëror apo përmes shitjes së sendeve, apo përmes dorëzimit të tyre në ndonjë muze përkatës, nëse sendet sipas natyrës së tyre nuk janë destinuar për shitje. Nëse qarkullimi i sendeve të sekuestruara është i ndaluar

⁹⁸ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë 2/2006, neni 346.

⁹⁹ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë 2/2006, neni 347.

¹⁰⁰ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë 2/2006, neni 350.

¹⁰¹ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë 2/2006, neni 351.

apo i kufizuar, asgjësimi i tyre do të realizohet edhe gjatë procedurës penale, në qoftë se kjo është e përcaktuar me vendimin gjyqësor. Asgjësimin e sendeve të sekuestruara e zbaton gjykata, e cila e ka marrë vendimin në shkallë të parë në praninë e prokurorit publik, apo të përfaqësuesit të autorizuar të paraqitësit të kërkesës për ngritje të procedurës kundërvajtëse dhe në praninë e inspektorit për zbatimin e sanksioneve. Këto dispozita aplikohen edhe në procedurën e dorëzimit të sendeve të sekuestruara në gjykatën përkatëse. Shitja e sendeve bëhet sipas dispozitave për përmbarim. Në qoftë se me vendimin e gjykatës nuk është urdhëruar që sendet t'i kthehen pronarit, kurse ai sendin nuk e merr brenda afatit përderisa rrjedh përmbarimi, pas skadimit të afatit të parashkrimit të zbatimit të vendimit, sendi mbetet në pronë të shtetit.¹⁰²

3. MENAXHIMI ME PRONËN E KONFISKUAR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Konfiskimi i pasurisë dhe dobisë pasurore të fituar me veprë penale dhe marrja e sendeve të aktiviteteve kriminale, nuk do të ishte mjaftueshëm efikas pa një menaxhim të tyre.

Konfiskimi dhe menaxhimi me pronën e konfiskuar është një mjet i rëndësishëm ligjor i cili ka për qëllim sundimin e së drejtës për arsye se, sa është e rëndësishme që të parandalohen kriminelët në kryerjen e veprave penale apo të dënohen për veprë penale të kryer, po aq e rëndësishme është që edhe pas sjelljes së vendimit të plotfuqishëm për konfiskim, kryerësve të veprave penale t'u konfiskohet përfundimisht pasuria e fituar në kundërshtim me ligjin.

Në Republikën e Maqedonisë është themeluar Agjencia për menaxhimin me pronën e konfiskuar, me perfitimin pronesor dhe me sendet e konfiskuara në procedurën penale dhe kundërvajtëse, me qëllim administrimin e produkteve të sekuestruara dhe të konfiskuara. Krijimi i kësaj agjencie ka sjellë përqendrimin, e produkteve të sekuestruara dhe të konfiskuara në një institucion të vetëm. Me ligjin për menaxhimin me pronën e konfiskuar, me perfitimin pronesor dhe me sendet e konfiskuara në procedurën penale dhe kundërvajtëse, rregullohet menaxhimi, shfrytëzimi dhe disponimi me pronën e konfiskuar perkohësisht, me perfitimin pronesor dhe me sendet e konfiskuara perkohësisht, si edhe me pronën e konfiskuar, me perfitimin pronesor dhe me sendet e konfiskuara me vendim të plotfuqishëm në procedurën penale dhe të kundërvajtjes, si edhe themelimi, kompetencat, menaxhimi,

¹⁰² Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë 2/2006, neni 355.

udheheqja dhe çeshtjet të tjera, që kane të bejne me punen e Agjencise për menaxhimin me pronen e konfiskuar.¹⁰³

Me pronen e konfiskuar Agjencia vepron në pajtim me parimin e nikoqirit të mire dhe afaristit të mire. Gjate veprimit me pronen e sekuestruar Agjencia mund të kerkoje kryerjen e puneve të caktuara nga persona të tjere fizike dhe juridike të specializuar për vleresime për nevojat e vleresimit të prones, shitjen e saj dhe ngjashem. Gjate pranimit të prones, Agjencia bën percaktimin e vleres së saj në treg, me ç'rast mund të shfrytetoje sherbime të vleresuesve të autorizuar. Për lartesine e vleres së percaktuar të prones Agjencia e njofton gjykatën kompetente, Prokurorinë Publike, Avokatin shtetëror, organ tjetër kompetent ose personin nga i cili është konfiskuar prona. Vendimin për sekuestrimin e prones e zbaton Agjencia.¹⁰⁴

Shitja e sendeve të sekuestruara behet me ankand publik.¹⁰⁵ Në baze të aktit për permbarim nga gjykata ose nga organi i cili e ka marre vendimin e plotfuqishem për konfiskimin e prones së patundshme, e me propozim të Agjencise, Qeveria e Republikës së Maqedonise sjell vendim për shitjen e prones së sekuestruar të patundshme. Agjencia, në baze të vendimit miraton konkluzion për shitjen e patundshmerise me të cilën percaktohet menyra dhe kushtet e shitjes, si dhe koha dhe vendi i shitjes.¹⁰⁶ Agjencia mundet me pajtimin paraprakisht të gjyqit, të miratoje vendim për shitjen e prones së tundshme të konfiskuar perkohesisht, nese vlereson se me ruajtjen e sendit zvogelohet vlere e tij ose shpenzimet për ruajtjen e tij jane të medha në menyre joproportionale. Prona e patundshme e konfiskuar perkohesisht, nuk mund të behet lende e shitjes.¹⁰⁷

Mjetet e fituara nga shitja e sendeve të konfiskuara perkohesisht, paguhet në llogarinë e vecante të Agjencise. Nese miratohet vendim i plotfuqishem për kthimin e sendit, Agjencia pronarit ia paguan mjetet e fituara nga shitja. Në rast se mjetet do të jene më të vogla se vlere e percaktuar, dallimi i paguhet pronarit nga mjetet për rezerva të buxhetit të Agjencise. Agjencia e shet pronen e patundshme dhe sendet e konfiskuara me vendim të plotfuqishem,

¹⁰³ Ligji për menaxhimin me pronen e konfiskuar, me perfitimin pronesor dhe me sendet e konfiskuara në procedurën penale dhe kundervajtese, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.98/2008, 145/10, 104/2013, 187/13, 43/14, 160/14, 97/15, 148/15, 64/18, neni 1.

¹⁰⁴ Ligji për menaxhimin me pronen e konfiskuar, me perfitimin pronesor dhe me sendet e konfiskuara në procedurën penale dhe kundervajtese, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.98/2008, neni 26, 27 dhe 28.

¹⁰⁵ Ligji për menaxhimin me pronen e konfiskuar, me perfitimin pronesor dhe me sendet e konfiskuara në procedurën penale dhe kundervajtese, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.98/2008, neni 34 paragrafi 1.

¹⁰⁶ Ligji për menaxhimin me pronen e konfiskuar, me perfitimin pronesor dhe me sendet e konfiskuara në procedurën penale dhe kundervajtese, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.98/2008, neni 37.

¹⁰⁷ Ligji për menaxhimin me pronen e konfiskuar, me perfitimin pronesor dhe me sendet e konfiskuara në procedurën penale dhe kundervajtese, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.98/2008, neni 48.

menjehere pas plotfuqishmerise së vendimit, ndersa mjetet e fituara paguhen në Buxhetin e Republikës së Maqedonise.¹⁰⁸

¹⁰⁸ Ligji për menaxhimin me pronen e konfiskuar, me perfitimin pronesor dhe me sendet e konfiskuara në procedurën penale dhe kundervajtese, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.98/2008, neni 49 dhe 50.

KAPITULLI III

KONFISKIMI I PASURISË DHE DOBISË PASURORE DHE MARJA E SENDEVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS DHE REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

1. Konfiskimi i pasurisë dhe marrja e sendeve në Republikën e Shqipërisë

Shqipëria është pjesë e një lufte globale, kundër krimit të organizuar, akteve terroriste apo të gjitha veprimtarive kriminale që prekin dhe dëmtojnë paqen, sigurinë dhe stabilitetin në botë. Në Shqipëri krimi i organizuar dhe trafikimet ilegale kanë qenë dukuri shumë shqetësuese për shtetin shqiptar dhe mbarë opinion e gjerë. Në raportet e institucioneve ndërkombëtare Shqipëria është përmendur si një vend me kriminalitet të lartë. Duke e pasur parasysh pasojat negative dhe rrezikshmërinë e lartë shoqërore që ka kriminaliteti në një vend, Shqipëria është angazhuar në luftimin e tij me qëllim që të arrijë besueshmërinë në institucionet e shtetit dhe sistemit të tij ekonomik dhe ligjor.

Sekuestrimi dhe konfiskimi i produkteve që rrjedhin nga aktivitetet kriminale edhe nga ligjvënësi Shqiptar konsiderohen si mjete shumë efikase në luftë kundër dukurive të rrezikshme kriminale. Shqipëria është pjesë e një sërë organizatash ndërkombëtare që kanë si qëllim krijimin e politikave, qëndrimeve të përbashkëta, në luftën pa kompromis kundër aktiviteteve të rrezikshme. Ajo gjithashtu ka ratifikuar një sërë marrëveshjesh ndërkombëtare dhe konventash prej të cilave lindin edhe detyrime për t'u përmbushur.

Shqipëria në legjislacionin e saj parasheh konfiskimin e ngushtuar por të detyrueshëm për disa vepra penale të rënda, domethënë konfiskimin e produkteve të veprës penale për një kategori veprash penale specifike të cilat konsiderohen me rrezikshmëri të madhe shoqërore.

Për dallim nga Republika e Maqedonisë, sekuestrimi dhe konfiskimi i produkteve të veprave penale në Republikën e Shqipërisë është paraparë edhe jashtë procedimit penal si masa të drejtuara kundër pasurisë. Por e drejta materiale dhe ajo procedurale penale Shqiptare, ka parashikuar sekuestrimin dhe konfiskimin edhe brenda procedimit penal.

1.1. Konfiskimi sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë

Në të drejtën penale Shqiptare, sekuestrimi dhe konfiskimi ka qenë pjesë e të drejtës materiale dhe procedurale Shqiptare. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë parashikon konfiskimin e mjeteve dhe produkteve të veprës penale ose të çfarë do lloji pasurie tjetër, vlera e të cilës i korrespondon asaj të produkteve të krimit. Ky konfiskim vendoset me vendim të gjykatës dhe ka të bëjë me marrjen dhe kalimin në favor të shtetit: 1. të sendeve që kanë shërbyer për kryerjen e veprës penale, 2. të produkteve të veprës penale, edhe kur këto janë transferuar apo bashkuar me pasuri të tjera të fituara në mënyrë të ligjshme, 3. të shpërblimeve të veprës penale, 4. të çdo pasurie vlera e të cilës i korrespondon asaj të veprës penale, 5. të sendeve, prodhimi, mbajtja e të cilave është vepër penale edhe kur nuk është dhënë dënimi.¹⁰⁹

Ky konfiskim në Kodin Penal Shqiptar, parashikohet si një dënim plotësues, ku personit i konfiskohet gjithë pasuria e cila e ka prejardhjen nga aktivitete kriminale, por edhe kur ajo është përzier me pasuri të ligjshme, deri në vlerën e pasurisë së paligjshme që është përzier. Në këtë kod nuk flitet për sekuestrimin por vetëm për masën përfundimtare atë të konfiskimit, duke e konsideruar konfiskimin si një dënim plotësues. Ky lloj konfiskimi jepet pasi ka përfunduar procedimi penal dhe personi është deklaruar fajtor, jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm dhe realizohet vetëm brenda procesit penal.

1.2. Sekuestrimet sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë

Në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë¹¹⁰ parashikohen disa lloj sekuestrimesh, të cilat ndjekin qëllime të ndryshme. Në dispozitat e tjera të Kodit të Procedurës Penale në Shqipëri parashikohen sekuestrimi i provave materiale, sekuestro konservative dhe sekuestro preventive. Sekuestroja konzervative dhe preventive janë masa

¹⁰⁹ Kodi penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7895 datë 27.1.1995, ndryshuar me ligji nr.8175, datë 23.12.1996, nr.8204, datë 10.4.1997, nr.8279, datë 15.1.1998, nr.8733, datë 24.1.2001, nr.9017, datë 6.3.2003, nr.9030, datë 13.3.2003, nr.9086, datë 19.6.2003, nr.9188, datë 12.2.2004, nr.9275, datë 16.9.2004, nr.9686, datë 26.2.2007, nr.9859, datë 21.1.2008, nr.10 023, datë 27.11.2008, neni 36.

¹¹⁰ Kodi i procedurës penale i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.7905, datë 21.3.1995, ndryshuar me ligjet: nr. 7977, datë 26.7.1995, 8027, datë 15.11.1995, nr. 8180, datë 23.12.1996, nr. 8460, datë 11.2.1999, nr. 8570, datë 20.1.2000, nr.8602, datë 10.4.2000, nr. 8813, datë 13.6.2002, nr.9085, datë 19.6.2003, nr. 9187, datë 12.2.2004, nr. 9276, datë 16.9.2004, nr. 9911, datë 5.5.2008, nr. 10 054, datë 29.12.2008, nr. 145/2013, datë 2.5.2013, nr. 21/2014, datë 10.3.2014, nr.99/2014, datë 31.7.2014, nr. 35/2017, datë 30.3.2017; vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 55, datë 21.11.1997, nr. 15, datë 17.4.2003 dhe nr. 31, datë 17.5.2012), në vazhdim KPP i RSh-ë.

sigurimi me karakter pasuror, të drejtuara ndaj pasurisë, sendeve, produkteve të veprave penale, të personit që dyshohet se ka konsumuar këtë vepër penale.

Sekuestrimi i provave materiale, është mjet për kërkimin e provës, i cili realizohet gjatë fazës së hetimit paraprak. Nëpërmjet këtij mjeti të kërkimit të provës organi i hetimit, kërkon provën gjatë fazës së hetimit paraprak, me qëllimi që t'i shërbejë procesit të provuarit brenda procedimit penal. Duke qenë se sekuestrimi kufizon liritë dhe të drejtat e individit, këto veprime procedurale kryhen me vendim të gjykatës dhe të prokurorit, duke garantuar kështu liritë dhe të drejtat e njeriut. Gjyqtari ose prokurori disponojnë me vendim të arsyetuar sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve. Sekuestrimin e kryen vetë ai që ka nxjerrë vendim ose oficerët e policisë gjyqësore të deleguar me të njëjtin vendim.¹¹¹ Kopja e vendimit të sekuestrimit i dorëzohet të interesuarit. Qëllimi i kësaj sekuestro është që organi procedues nëpërmjet këtyre mjeteve të kërkimit të provës, të gjejë provën dhe të provojë faktet, objekt akuze.

Sekuestroja konservative, siç shihet edhe nga emërtimi, nënkupton bllokimin e pasurisë dhe ruajtjen e saj nga organi procedues deri në momentin që ajo do të përdoret me qëllim përmbushjen e detyrimeve financiare. Kur ka arsye të bazuara për të menduar se nuk ka garanci për pagimin e dënimit me gjobë, të shpenzimeve të procedimit dhe të çdo detyrimi ndaj pasurisë së shtetit, prokurori kërkon sekuestron konservative të pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme të të pandehurit ose të shumave a sendeve që të tjerët i detyrohen atij, në caqet që ligji lejon sekuestrimin e tyre.¹¹² Në këtë sekuestrim, merret përkohësisht e gjitha pasuria që personi i pandehur ka, të ligjshme apo të paligjshme dhe kthehet ajo pjesë e pasurisë që ngelet pasi janë paguar të gjitha detyrimet që personi i pandehur ka ndaj shtetit, personit të dëmtuar nga vepra penale (paditësit civil) dhe shpenzimet e shtetit. Edhe kjo masë sigurimi vendoset vetëm brenda procedimit penal. Sekuestroja konservative vihet me vendim të gjykatës kompetente. Kur është dhënë vendim në shkallë të parë, sekuestroja vihet para se aktet t'i dërgohen gjykatës së apelit. Efektet e sekuestros pushojnë kur vendimi i pafajësisë ose i pushimit të çështjes ka marrë formë të prerë.¹¹³

Sekuestroja preventive, quhet ndryshe edhe sekuestro parandaluese, vendoset nga gjykata me kërkesë të prokurorit, kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi, që lidhet me veprën penale mund të rëndojë apo zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave

¹¹¹ Kodi i procedurës penale i Republikës së Shqipërisë, neni 208.

¹¹² Kodi i procedurës penale i Republikës së Shqipërisë, neni 270 paragrafi 1.

¹¹³ Kodi i procedurës penale i Republikës së Shqipërisë, neni 271.

penale të tjera dhe /ose mund të vendoset edhe për sendet produkt të veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet sipas të Kodit Penal.¹¹⁴ Kjo sekuestro ka si qëllim parandalimin dhe kryerjen e mëtejshme të veprave penale. Sekuestrimet në të gjitha rastet e mësipërme janë masa të përkohshme të drejtuara ndaj pasurisë, të marra këto gjatë dhe brenda procedimit penal. Në fund të procedimit penal, gjykata në vendimin e dënimit vendos konfiskimin e sendeve të sekuestruara kur këto janë produkte apo sende që kanë shërbyer për kryerjen e veprës penale.

1.3. Konfiskimi dhe sekuestrimi sipas Ligji për krimin e organizuar dhe Anti mafia

Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive që rrjedhin nga krimi është pa dyshim një mjet ligjor në luftën kundër veprimtarive më të rrezikshme kriminale. Shqipëria ka një sistem të përzier sekuestrimi dhe konfiskimi, i cili është në përputhje me standardet e vendosura nga aktet ndërkombëtare. Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar 2 ligje konkretisht ligjin nr. 9284 datë 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar” dhe ligjin nr. 10192, 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” i njohur si ligji Anti mafia, të cilët kanë si objekt të tyre pikërisht sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të personave që dyshohen se janë pjesëmarrës në veprimtari kriminale të rrezikshme. Këto ligje kanë si qëllim të përbashkët luftën kundër KO-së, trafikimit dhe akteve terroriste nëpërmjet sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive që rrjedhin nga aktiviteti kriminal.

Ligji nr. 9284, 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar” ishte ligji i parë, që parashikonte, sekuestron, sekuestron paraprake, pezullimin e administrimit të pasurive dhe konfiskimin e atyre pasurive që dyshoheshin se ishin përfitim i veprimtarisë kriminale jashtë procedimit penal. Ky ligj përfaqëson një risi në legjislacionin e Shqipërisë, pasi ai parashikonte marrjen e masave kundër pasurisë jashtë procedimit penal. Shpesh ky lloj procedimi nga teoria dhe praktika konsiderohet si një procedim parandalues, duke qenë se qëllimi i veprimit të këtij instituti është që nëpërmjet sekuestrimit dhe konfiskimit të produkteve të aktivitetit kriminal të parandalojë kryerjen e mëtejshme të veprave penale. Ky ligj parashikonte katër masa kundër pasurisë së personave që dyshoheshin se ishin subjekte të ligjit. Masat kundër pasurisë janë sekuestrimi paraprak, pezullimi i përkohshëm i

¹¹⁴ Kodi i procedurës penale i Republikës së Shqipërisë, neni 274.

administrimit dhe të zotërimit të veprimtarive, sekuestrimi dhe konfiskimi. Këto masa edhe pse kanë qëllimin e njëjtë, vendosen kur plotësohen kushtet ligjore të ndryshme të parashikuara në ligj.

Parashikimi i konfiskimit në legjislacionin shqiptar si mjet për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe të pastrimit të parave nëpërmjet konfiskimit të pasurive që burojnë drejtpërdrejtë apo tërthorazi nga aktiviteti kriminal bazohet në ligjin Anti-Mafia. Ky ligj konstituo i procedimin parandalues, pra parashikoi masat kundër pasurisë së personave të dyshuar në aktivitete kriminale. Ndryshe nga ligji kundër KO-së, ligji Anti-mafia parashikon masa kundër pasurisë produkt i veprave penale, sekuestrimin dhe konfiskimin. Parashikimi vetëm i këtyre masave në ligjin Anti-mafia, ka qenë një ndër arsytet për të cilat ai u miratua. Qëllimi ishte që ligji të ishte më efikas në luftën kundër aktiviteteve të tilla kriminale.

2. Konfiskimi i pasurisë dhe marrja e sendeve në Republikën e Kosovës

Pas shpalljes së pavarësisë më 2008, Kosova iu nënshtrua reformave juridike dhe ligjore të udhëhequra nga institucionet e Kosovës nën mbështetjen e gjerë të komunitetit ndërkombëtar. Përveç kësaj, edhe misioni më i madh i BE-së – EULEX vazhdon të jetë i vendosur me mandatin për monitorim, mentorim, këshillim dhe atë ekzekutiv në fusha të caktuara të luftimit të krimit të organizuar dhe krimeve financiare dhe ekonomike. Reformat ligjore dhe reformat e politikave të ndërmarra në vitet 2011-2013 sikurse verifikimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve, hartimi i kodit penal dhe kodit të procedurës penale e pasuar nga një strukturë e re e gjyqësorit që nga viti 2013, të gjitha kanë avancuar krijimin e infrastrukturës themelore për sundimin e ligjit në Kosovë. Sidoqoftë, rezultatet në krijimin e një shteti funksional, të bazuar në sundimin e ligjit në praktikë janë larg nga përmbushja.¹¹⁵

Dispozitat ligjore në Kosovë për konfiskimin e pasurisë, pas luftës dhe vendosjes së administrimit ndërkombëtar janë përcaktuar fillimisht me Kodin Penal të vitit 2004. Po ashtu, një bazë juridike për konfiskim të pasurisë ka ekzistuar edhe në periudhat e mëhershme gjatë administrimit të Kosovës nga sistemi juridik i ish Jugosllavisë. Baza kryesore e konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me veprë penale në të kaluarën ka qenë Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale, për t'u plotësuar më pas edhe me Ligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurive të fituara me veprë penale.

¹¹⁵ Pandëshkueshmëria në Kosovë: Pasuria e pajustificueshme, Publikuar nga Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave, Prihtinë 2013, fq.4.

2.1. Konfiskimi sipas Kodit penal të Republikës së Kosovës

Sipas Kodit penal të Republikës së Kosovës, konfiskimi parashihet si dënim plotësues.¹¹⁶ Sendet e përdorura apo të destinuara për kryerjen e veprës penale apo sendet të cilat janë rezultat i kryerjes së veprës penale do të konfiskohen.

Dënimi plotësues i marrjes së sendit konsiston në marrjen e sendeve të cilat janë përdorur për kryerjen e veprës penale të cilat kanë qenë të dedikuara për kryerjen e veprës penale apo të cilat janë rezultat i kryerjes së veprës penale. Që të mund të zbatohet ky dënim plotësues duhet të ekzistojnë lidhje të caktuara në mes sendit që merret dhe veprës penale të kryer. Sendet të cilat janë përdorur për të kryer veprën penale janë ato të cilat janë përdorur për kryerjen e veprës penale dhe për përgatitjen e kryerjes së veprës penale. Kështu për shembull send për kryerjen e veprës penale është pushka apo revolva me të cilën është kryer vrasja, mjetet me të cilat janë falsifikuar paratë (letra, ngjyra, makinat dhe mjetet e tjera) mjetet për peshkimin e ndaluar etj. sendet që janë rezultat apo pasojë e veprës penale konsiderohen për shembull paratë e vjedhura, dokumentet e falsifikuara, shkresat pornografike etj. Nga këto duhet dalluar sendet të cilat janë fituar si dhuratë për kryerjen e veprës penale apo të cilat kryerësi i ka fituar duke i shitur sendet e vjedhura.¹¹⁷

Këto sende mund të konfiskohen edhe kur nuk janë pronë e kryesit nëse kjo është në dobi të sigurisë së përgjithshme ose për arsye të moralit, nëse kjo nuk ndikon dëmshëm mbi të drejtat e palës së tretë për të marrë nga kryesi kompensimin e çfarëdo dëmi. Me ligj mund të përcaktohet marrja e detyrueshme e sendit.¹¹⁸

Këto sende nuk merren me këtë lloj dënimi por duke i zbatuar dispozitat e konfiskimit të dobisë pasurore. Ky dënim mund të shqiptohet edhe në rastet kur sendet janë pronë e personit tjetër. Në kësi raste marrja e sendit si dënim plotësues mund të shqiptohet nëse është në dobi të sigurisë së përgjithshme me kusht që marrja e tillë nuk ndikon dëmshëm mbi të drejtat e personave të tretë për të marrë kompensimin e dëmit nga kryerësi. Interseat e përgjithshme të sigurisë shqiptimin e kësaj mase e arsyetojnë në rastet kur është fjala për aso sende, mjete, armë, apo lëndë mbajtja e të cilave është e ndaluar, e rrezikshme dhe e regulluar në mënyrë të posaçme. Të këtilla janë për shembull armët, eksplozivi, droga, helmet. Ndërsa në aspektin moral si sende të cilat janë të dëmshme për shoqërinë dhe të cilat e arsyetojnë shqiptimin e këtij dënimi janë për shembull fotografitë pornografike. Për disa raste të veprave

¹¹⁶ Kodi penal i Republikës së Kosovës nr.04/L-082, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.19/13, neni 62, në vazhdim KP i RK-së.

¹¹⁷ Salihu Ismet, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Prishtinë 2012, fq.488.

¹¹⁸ Kodi penal i Republikës së Kosovës nr.04/L-082, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.19/13, neni 69.

penale kodi penal ka paraparë marrjen e sendeve në mënyrë obligative. Rasti i tillë është për veprën penale të falsifikimit të parave, falsifikimin e shenjave për shënimin e mallit të masave dhe peshave.¹¹⁹

Kodi penale parasheh se askush nuk mund ta mbajë dobinë pasurore të fituar me anë të kryerjes së veprës penale. Dobia pasurore konfiskohet nga gjykata e cila konstaton kryerjen e veprës penale, sipas kushteve të parapara me ligj.¹²⁰ Kjo bazë ligjore nuk është aspak e mjaftueshme, pasi që kodi specifikon kategorinë ligjore të „dobisë pasurore“, pa precizuar asnjërin nga kategoritë e pasurive të përcaktuara në Ligjin për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar. Është e qartë se dobia pasurore dhe pasurimi në mënyrë të paligjshme, përveç që janë dy gjëra krejtësisht të ndryshme, as nuk janë precizuar në asnjërin nga dy ligjet. Kjo bazë e Kodit Penal është e pamjaftueshme dhe e paqartë për të mundësuar luftimin e efektshëm të atyre veprave penale në kryerjen e të cilave përfshihet një rrjet i madh i individëve dhe grupeve.¹²¹

Kryesit i konfiskohet dobia pasurore apo kur konfiskimi nuk është i mundshëm, kryesi detyrohet të paguajë shumën e të hollave e cila i përgjigjet dobisë së fituar pasurore. Dobia pasurore mund t'i konfiskohet personit të cilit i është bartur pa kompensim ose me kompensim që nuk i përgjigjet vlerës reale, nëse personi i tillë e ka ditur ose është dashur ta dijë se dobia pasurore është fituar me kryerjen e veprës penale. Kur dobia pasurore është bartur tek anëtarët e familjes, dobia konfiskohet nga anëtari i familjes, përveç nëse anëtari familjar dëshmon se si kompensim ka dhënë vlerën e plotë.¹²²

Kur me procedurë penale i caktohet dëmi pasuror të dëmtuarit, gjykata urdhëron konfiskimin e dobisë pasurore nëse ajo e tejkalon shumën e dëmeve pasurore që i është caktuar palës së dëmtuar. I dëmtuari i cili gjatë procedurës penale është udhëzuar të fillojë procedurën e kontestit civil për kërkesën pasurore juridike, mund të kërkojë kompensim nga dobia pasurore e konfiskuar. I dëmtuari i cili kërkon kompensim nga dobia pasurore e konfiskuar duhet të fillojë procedurën e kontestit civil brenda gjashtë 6 muajve nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit që e udhëzon atë për iniciimin e kontestit civil dhe brenda tre 3 muajve nga dita kur vendimi gjyqësor për vendosjen e kërkesës pasurore juridike është bërë i plotfuqishëm. I dëmtuari i cili gjatë procedurës penale nuk e ka paraqitur kërkesën pasurore juridike, mund të kërkojë kompensim nga vlera e dobisë pasurore të konfiskuar nëse e ka

¹¹⁹ Salihu Ismet, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Prishtinë 2012, fq.488.

¹²⁰ Kodi penal i Republikës së Kosovës nr.04/L-082, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.19/13, neni 96.

¹²¹ Analizë mbi kornizën ligjore kundër pasurisë së përvetësuar në mënyrë të paligjshme, Publikim i lëvizjes FOL, Prishtinë 2011, fq.5.

¹²² Kodi penal i Republikës së Kosovës nr.04/L-082, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.19/13, neni 97.

filluar procedurën e kontestit civil në afatin prej tre 3 muajve nga dita kur ka mësuar për aktgjykimin me të cilin konfiskohet dobia pasurore dhe më së voni në afatin prej dy 2 vjetësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit mbi konfiskimin e dobisë pasurore, dhe nëse ka kërkuar kompensim nga vlera e dobisë pasurore të konfiskuar brenda afatit prej tre 3 muaj nga dita kur vendimi për caktimin e dobisë pasurore është bërë i plotfuqishëm.¹²³

Në Kodin penal përcaktohen dy mënyra të konfiskimit. Së pari, kryesit i konfiskohen të gjitha të hollat, sendet me vlerë dhe çdo dobi tjetër pasurore që është fituar me kryerjen e veprës penale, ndërsa në rastet kur konfiskimi nuk është i mundshëm, kryesi detyrohet të paguajë shumën e të hollave, e cila i përgjigjet dobisë së fituar pasurore. Sipas nevojës, gjykata mund të lejojë që të hollat të paguhen në këste gjatë një periudhe e cila nuk i tejkalon dy vite. Së dyti, çfarëdo dobie pasurore e fituar me anë të kryerjes së veprës penale mund t'i konfiskohet personit të cilit i është bartur pa kompensim ose me kompensim që nuk i përgjigjet vlerës reale nëse ai e ka ditur apo ka mund ta dijë se dobia pasurore është fituar me anë të kryerjes së veprës penale. Nëse dobia pasurore është bartur te të afërmit e ngushtë, ajo konfiskohet prej tyre nëse nuk ofrojnë prova se si kompensim e kanë dhënë vlerën e plotë. Nga kjo shihet qartë se kjo bazë ligjore është konfuze dhe lejon interpretime dhe mundësi që, për shembull, përmes korrupsionit personit të dënuar t'i jepet mundësi që pasurinë e fituar në mënyrë të paligjshme ta kompensojë në të holla. Konfiskimi lejohet në mënyrë strikte vetëm nëse gjykata kompetente jep aktgjykim të plotfuqishëm për këtë, dhe atë vetëm pasi që personi në fjalë të jetë gjykuar penalisht për vepër të rëndë penale dhe të jetë shpallur fajtor.¹²⁴

Kur me anë të veprës penale të kryer nga ana e kryesit përfiton dobi pasurore organizata e biznesit ose personi juridik, dobia pasurore konfiskohet nga organizata e biznesit ose personi juridik.¹²⁵ Në këtë dispozitë përcaktohet se vetëm në rastin kur personat juridikë përvetësojnë dobi pasurore përmes kryerjes së veprës penale ajo pasuri e organizatës, biznesit apo personit tjetër juridik konfiskohet, e jo në raste të tjera. Edhe kjo demonstroi nevojën që ligji në fjalë të përfshijë në fushëveprimin e tij edhe raste dhe lloje të tjera të veprimeve të kundërligjshme që mundësojnë përvetësim të pasurisë së paligjshme. Marrja e sendit si lloj dënimi plotësues mund të shqiptohet nëse kryerësit të veprës penale i shqiptohet dënimi kryesor, dënimi me kusht, vërejtja e gjykatës apo është liruar nga dënimi. Gjithashtu ky dënim mund të shqiptohet nëse personi e ka kryer vepër penale ka tentuar apo i ka ndërmarrë veprimet përgatitore për kryerjen e veprës penale. Përkatësisht do të merren ato sende të cilat

¹²³ Kodi penal i Republikës së Kosovës nr.04/L-082, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.19/13, neni 98.

¹²⁴ Analizë mbi kornizën ligjore kundër pasurisë së përvetësuar në mënyrë të paligjshme, Prishtinë 2011, fq.6.

¹²⁵ Kodi penal i Republikës së Kosovës nr.04/L-082, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.19/13, neni 99.

janë dedikuar për kryerjen e veprës penale. Në vendimin e gjykatë me të cilin është shqiptuar ky dënim duhet të ceken në mënyrë të qartë se cilat sende merren dhe prej kujt merren.¹²⁶

2.2. Konfiskimi sipas Kodit të procedurës penale të Kosovës

Ligji i procedurës penale i Republikës së Kosovës parasheh dy lloje procedurash të konfiskimit dhe atë para ngritjes së aktakuzës dhe pas ngritjes së aktakuzës.

Procedurat para ngritjes së aktakuzës parashohin konfiskimin e përkohshëm sipas të cilit ndërtesat, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme dhe asetet e konfiskuara përkohësisht nga duhet ose të i kthehen pronarit nga neni ose të mbahen deri në shfrytëzimin e tyre si prova dhe/apo deri në konfiskimin e përhershëm. Brenda gjashtëdhjetë ditëve nga konfiskimi i ndërtesës, pasurisë së paluajtshme, pasurisë së luajtshme apo asetit, prokurori i shtetit kërkon masë të përkohshme për sigurimin e pasurisë.¹²⁷ Në kërkesë për masë të përkohshme përcaktohet ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aset që është objekt i kërkesës, dyshimi i bazuar se ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme apo aset i është rrjedhojë e veprës penale nën hetim ose përdorur ose ka pasur për qëllim të përdoret në kryerjen e veprës penale, nëse ka gjasa të konsiderueshme se ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme apo aset nuk do të jetë e mundur të konfiskohet në përfundim të procedurës penale ose që do të përdoret në kryerjen e veprës penale nëse nuk merren masa mbrojtëse; të gjithë personat që kanë ndonjë të drejtë ligjore në ndërtesë, pasuri të paluajtshme, pasuri të luajtshme apo aset; dhe masat e përkohshme që propozohen të merren.¹²⁸

Nëse ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aset që është objekt i urdhrimit për masë të përkohshme ose i urdhrimit për ndalim afatgjatë nuk ceket në aktakuzë para shqyrtimit të dytë, pronari ose poseduesi mund të paraqesë kërkesë te gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues për t'i liruar pasurinë pronarit apo poseduesit. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues refuzon kërkesën e pronarit ose poseduesit nëse ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aset që është objekt i urdhrimit për masë të përkohshme ose i urdhrimit për ndalim afatgjatë, është objekt i ndonjë procedure tjetër ligjore të konfiskimit ose nevojitet si provë në shqyrtim gjyqësor. Nëse këto sende mund të ceken në aktakuzën e cila ende nuk është ngritur, prokurori i shtetit njofton gjyqtarin e vetëm gjykues

¹²⁶ Salihu Ismet, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Prishtinë 2012, fq.488.

¹²⁷ Ligji i procedurës penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.37/2012 datë 28.12.2012, neni 267, në vazhdim LPP i RK-së.

¹²⁸ Ligji i procedurës penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.37/2012, neni 268.

ose kryetarin e trupit gjykues i cili e pezullon kërkesën e pronarit apo poseduesit por i lejon paraqitësit të kërkesës që të ripërtërijë kërkesën pas gjashtë muajve nëse nuk ngritet aktakuzë tjetër. Nëse nuk ngritet aktakuzë tjetër dhe paraqitësi i kërkesës ripërtërinë kërkesën pas gjashtë muajve, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues nxjerr urdhër për miratimin e kërkesës.¹²⁹

2.3. Konfiskimi sipas Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfitur me Vepër Penale

Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfitur me Vepër Penale përcakton kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar nga personat që kanë kryer vepër penale, kur procedurat e përcaktuara me legjislacionin tjetër nuk janë të mjaftueshme. Ky ligj zbatohet për pasurinë e fituar nga personat të cilët kanë kryer vepër penale të paraparë me Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Pasuria që nuk është dobi pasurore e fituar nga vepra penale e përshkruar në aktakuzë mund t'i nënshtrohen konfiskimit sipas ligjit. Pasuria që i nënshtrohet konfiskimit sipas kompetencave të zgjeruara, e cila është fituar nga i pandehuri i cili ka vdekur mund t'i nënshtrohet konfiskimit sipas ligjit. Pasuria që i nënshtrohet konfiskimit sipas kompetencave të zgjeruara e cila është fituar nga i pandehuri i cili është larguar nga Republika e Kosovës mund t'i nënshtrohet konfiskimit sipas ligjit. Po ashtu dispozitat e ligjit mund të zbatohen edhe për pasurinë e cila i është bartur palës tjetër nga personi i cili është apo bëhet i pandehur apo i dënuar.

Sipas Ligjit pala tjetër ka të drejtë për të provuar se është blerës bona fide i pasurisë. Pasuria nuk mund të konfiskohet nga blerësi bona fide i asaj pasurie. Në këtë ligj rregullohet edhe mënyra se si konfiskohet pasuria, kushtet kur mund të konfiskohet ajo në rastet kur i pandehuri ka vdekur apo është në arrati si dhe aspektet e zbatimit të ekzekutimit dhe administrimit të pasurisë së konfiskuar.¹³⁰

Ligji për Kompetencën e Zgjeruar për Konfiskim të Pasurive të Fituara me Vepër Penale, e ka rregulluar në atë mënyrë që mund të konfiskohen vetëm pasuritë të cilat janë fituar me vepër penale. Duhet të ekzistojë fillimisht një aktgjykim me të cilin një person shpallet fajtor për një vepër penale, pastaj nëse pasuria e të dënuarit është e fituar me atë vepër penale ose në rrethana të njëjta me ato të veprës penale, mund të bëhet kërkesa për

¹²⁹ Ligji i procedurës penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.37/2012, neni 274.

¹³⁰ HAZIRI, Fatos. Vështrim krahasues juridikopenal i fenomenit të shpërlarjes së parave në Kosovë dhe disa shtete të Bashkimit evropian dhe ballkanit perendimor, JURIDICA, Instituti Evropian për Studime Juridike dhe Administrim Publik, Prishtinë 2015.

konfiskimin e asaj pasurie. Dispozita të tilla kanë qenë dhe janë në fuqi në Kodin Penal të Kosovës që nga muaji prill 2004, kur edhe ka hyrë në fuqi Kodi i Përkohshëm Penal, dhe pastaj me Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Përvoja ka dëshmuar se fare pak raste të konfiskimit të formës së prerë janë realizuar bazuar në këto norma penale. Ligjërisht ka qenë dhe mbetet e vështirë për të vërtetuar lidhjen shkak-pasojë, për të vërtetuar atë se me këtë veprë penale është fituar pasuri e caktuar. Fillimisht duhet të vërtetohet dhe faktohet fajësia për veprën e caktuar penale e pastaj të bëhet vërtetimi se me atë veprë penale është fituar edhe pasuria e të dënuarit. Për më tepër, ligji i ri përveçse ka përsëritur dhe është bazuar në bazën ekzistuese ligjore, ka përjashtuar mundësinë për t'u marrë me atë "lloj të pasurisë" të poseduar nga persona me funksione të larta zyrtare, apo atë që teoria bashkëkohore e njeh si "sistemin kleptokratik". Pra, Ligji për Kompetencat e Zgjeruara mund të konsiderohet para së gjithash një aneks mbi kompetencat e prokurorëve, gjykatësve, hetuesve dhe strukturës institucionale mbi konfiskimin e pasurisë, vetëm si zgjatje alternative atëherë kur Kodi i Procedurës Penale nuk ishte i mjaftueshëm, por nuk ishte një ligj themelor që do të vendoste një bazë të mirëfilltë të politikës shtetërore për konfiskim. Karakteri i këtij ligji pretendon të përfaqësojë një sistem të pastër penal, duke iu referuar kryesisht personave që kanë kryer veprë penale. Kjo e minon debatin nëse ky format është i duhuri dhe nëse ai ofron garanci që akterët e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik të nivelit institucional të njohur si "jaka e bardhë" mund të jenë subjekt i tij.¹³¹

¹³¹Veprimi kundrejt reformimit, Konfiskimi i pasurisë në Kosovë, Publikuar nga Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet, Çohu!, Prishtinë 2017, fq.21

KAPITULLI IV

DISA NGA AKTET NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E KONFISKIMIT DHE MARRJES SË SENDEVE

Kriminaliteti në përgjithësi dhe në veçanti krimi i organizuar mund ti kalojë kufijtë e një shteti dhe paraqet një problem për sigurinë ndërkombëtare me tendencë për të depërtuar në të gjitha sferat e shoqërisë. Bashkësia ndërkombëtare duke u ballafaquar me problemin e kriminalitetit ndërkombëtar si një problem i cili nuk ka vetëm dimensione nacionale por edhe ndërkombëtare, për të cilin duhet gjetur zgjidhje për parandalimin e tij, ka sjellë një serë aktesh ndërkombëtare të shumëllojshme dhe të konsiderueshme të miratuara edhe nga shtetet. Këto norma ligjore ndërkombëtare të cilat parashohin ndërmarjen e menjëhershme të masave kanë për qëllim shtypjen e aktiviteteve të paligjshme në nivel ndërkombëtar.

Reagimi i bashkësisë ndërkombëtare ndaj krimit të organizuar ekonomik dhe financiar intensifikohet çdo ditë e më shumë me sjelljen e dokumenteve ndërkombëtare dhe implementimit të tyre në legjislacionin nacional dhe zhvillimit të bashkëpunimit ndërkombëtar si dhe formimin e institucioneve për shkëmbimin e informative dhe bashkëpunimit në hetimet financiare. Bashkësia ndërkombëtare ka ndërmarrë një numër të madh nismash për të parandaluar dhe shtypur aktivitetet e paligjshme në mënyrën sa më të efektshme. Rrezikui vërtetë të krimit të organizuar me karakter ndërkombëtar qëndron në atë se ai nuk njihet kufij politike, shtetërore dhe ideologjike mes kombeve, shteteve dhe kontinenteve, prandaj komuniteti ndërkombëtar e ka paraparë sit ë domosdoshme sjelljen e akteve juridike ndërkombëtare për luftën e përgjithshme kundër llojeve më të rrezikshme të krimit të organizuar.

Republika e Maqedonisë i ka përfshirë në legjislacionin e saj shumicën e rekomandimeve nga aktet ndërkombëtare juridike në të drejtën penale material dhe atë procedural, por edhe në sjelljen e zgjidhjeve të veçanta ligjore dhe formimin e organeve dhe institucioneve të posaçme shtetërore sa i përket masave të konfiskimit të pronës dhe dobisë pasurore dhe marrjes së sendeve si masa të rëndësishme për luftimin e kriminalitetit ekonomik dhe financiar.

Ndër dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare sa i përket konfiskimit të pasurisë së fituar me veprë penale mund të cekem disa konventa siç është Konventa e OKB-së, kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe Konventa e Varshavës ose e Këshillit të Evropës për

Depistimin, Kërkimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Veprave Penale. Këto konventa parashikojnë një sërë masash në luftën kundër këtyre fenomeneve, por theks të veçantë I vënë edhe sekuestrimit dhe konfiskimit të produkteve të veprave penale, si instrument i vjetër për të luftuar fenomene të reja, të cilat sjellin privimin nga pasuria, produkt i veprimtarisë kriminale të këtyre personave.

1. Konventa e Kombeve të bashkuara kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar

Në mbledhjen e saj të mbajtur në Palermo, Dhjetor 2002, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar. Ajo u nënshkrua nga 184 vende anëtare të OKB-së. Nënshkruesit janë të detyruar që brenda sistemeve të tyre të brendshëm penal të përcaktojnë katër vepra penale të dallueshme: pjesëmarrja në një grup të organizuar kriminal pastrimin e parave – korrupsionin, pengimin e drejtësisë. Konventa, e cila përmban norma me karakter material dhe procedural, shpall si qëllim të saj luftën kundër krimin të organizuar ndërkombëtar, duke parashikuar edhe mjetet konkrete në luftën kundër këtij fenomeni kaq shqetësues për mbarë popujt. Në këtë konventë midis shumë masave të tjera, parashikohet, si masë kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar edhe sekuestrimi, ngrirja, pezullimi dhe konfiskimi i produkteve të këtyre aktiviteteve kriminale.

Sa i përket konfiskimit dhe marrjes së sendeve Konfiskimi dhe marrja e sendeve kjo konventë parasheh se, që shtetet palë duhet të adaptojnë, në shkallën më të madhe të mundshme dhe brenda sistemeve të tyre ligjore, masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të mundësuar konfiskimin e të ardhurave nga krimi, që rrjedhin nga veprat penale që mbulohen nga Konventa ose pasurisë, vlera e së cilës i korrespondon asaj të të ardhurave nga krimi, si dhe të pasurisë, pajisjeve ose mjeteve të përdorura ose të destinuara për t'u përdorur në veprat penale që mbulohen nga Konventa.¹³²

Shtetet Palë duhet të adaptojnë masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të mundësuar identifikimin, zbulimin, bllokimin ose marrjen e çdo sendi me qëllim konfiskimin e mundshëm.¹³³ Në qoftë se të ardhurat nga krimi janë transformuar ose konvertuar pjesërisht ose plotësisht në pasuri tjetër, kjo pasuri duhet t'i nënshtrohet masave të përmendura në vend të të ardhurave nga krimi. Në qoftë se të ardhurat nga krimi janë përzier me pasuri të fituara

¹³² Neni 12, paragrafi 1 pika a dhe b.

¹³³ Ibid. Paragrafi 2

nga burime të ligjshme, një pasuri e tillë duhet t'i nënshtrohet konfiskimit deri në masën e vlerës së të ardhurave nga krimi që janë përzier. Mjetet monetare ose përfitimet e tjera, që rrjedhin nga të ardhurat nga krimi, nga pasuria në të cilën janë transformuar të ardhurat nga krimi ose konvertuar ose nga pasuria me të cilën janë bashkuar këto të ardhura, duhet t'i nënshtrohet, gjithashtu, masave të përmendura, në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtën masë si të ardhurat nga krimi. Për këto qëllime secili Shtet Palë duhet t'u japë pushtetin gjykatave të tij ose autoriteteve të tjera kompetente, që të urdhërojnë bankat që t'u vërë në dispozicion ose t'u marrin dokumentet financiare ose tregtare.¹³⁴

Shtetet palë nuk duhet të refuzojnë për të vepruar, në bazë të dispozitave me arsyetimin e ruajtjes së sekretit bankar. Shtetet Palë duhet të vlerësojnë mundësinë që të kërkojnë që autori i veprës penale të demonstrojë origjinën e ligjshme të të ardhurave nga krimi në fjalë ose të pasurisë tjetër që i nënshtrohet konfiskimit, në atë shkallë që kërkesa është në përputhje me parimet e legjislacionit të tyre të brendshëm dhe me natyrën e procedurave gjyqësore dhe procedurave të tjera. Dispozitat e këtij neni nuk do të interpretohen në mënyrë të tillë që të cenojnë të drejtat e palëve të treta në mirëbesim.¹³⁵

Kjo konventë parasheh masa me karakter pasuror, si marrja e sendeve dhe konfiskimin e të ardhurave nga kryerja e veprës penale, vendos disa rregulla, parime të përgjithshme si dhe vendos kufijtë e marrjes së sendeve dhe konfiskimit duke mbrojtur personat e tretë.

Sa i përket masës së konfiskimit janë të rëndësishme rekomandimet e paraparë në këtë konventë që kanë të bëjnë me bashkëpunimin ndërkombëtar me qëllim të konfiskimit të të ardhurave të veprës penale. Këto rekomandime kanë të bëjnë me rregullimin ligjor të procedurës për identifikimin, sigurimin dhe ngrirjen e të ardhurave të veprës penale kur këto të ardhura gjenden në shtet tjetër, si duhet të veprohet në bazë të kërkesës së një shteti të huaj dhe domosdoshmërinë për harmonizimin e ligjeve nacionale me qëllim të bashkëpunimit ndërkombëtar .

Disponimi i të ardhurave nga krimi ose i pasurisë së konfiskuar rregullohet në nenin 14, me çrast parashihet se shtetet palë, kur veprojnë në bazë të kërkesës së bërë nga një Shtet tjetër Palë, duhet t'i japin prioritet në atë shkallë që lejohet nga legjislacioni i brendshëm dhe nëse kërkohet një gjë e tillë, mundësisë së kthimit tek Shteti Palë kërkues të të ardhurave nga krimi ose pasurisë së konfiskuar, në mënyrë që ai të kompensojë viktimat e krimit ose t'ua kthejë këto të ardhura nga krimi, ose pasuri, pronarëve të ligjshëm.¹³⁶

¹³⁴ Neni 12, paragrafi 3, 4, 5 dhe 6.

¹³⁵ Ibid., paragrafi 7 dhe 8.

¹³⁶ Neni 14 paragrafi 2.

2. Konventa europiane për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit (Konventa e Strasburgut)

Kjo konventë e cila është e nënshkruar në Strasburg më 8 nëntor 1990 parasheh realizimin e një bashkimi më të ngushtë midis anëtarëve të saj për shkak të domosdoshmërisë së ndjekjes së një politike penale të përbashkët që synon mbrojtjen e shoqërisë. Kjo konventë e parasheh luftën kundër kriminalitetit të rëndë si një problem ndërkombëtar i cili kërkon përdorimin e metodave moderne dhe efikase në shkallë ndërkombëtare që konsistojnë në privimin e kriminelëve nga produktet e krimit.

Theks të veçantë kjo konventë I vëndon masave të bashkëpunimit ndërkombëtar. Parashihet se palët bashkëpunojnë me njëra-tjetrën sa më shumë që të jetë e mundur me qëllim të hetimeve dhe procedimeve që synojnë konfiskimin e instrumenteve dhe të produkteve. Çdo Palë përshtat masat ligjore dhe masat e tjera që do të jenë të nevojshme për t'i lejuar asaj t'u përgjigjet kërkesave për konfiskimin e pasurive të caktuara që përbëjnë produkte ose instrumente, si dhe për konfiskimin e produkteve që përbëjnë detyrimin për të paguar një shumë parash që i korrespondon vlerës së produktit, si dhe për ndihmën e ndërsjellë për qëllim të hetimit dhe të masave të përkohshme që kanë për qëllim njërën nga format e konfiskimit.¹³⁷

Në konventë parashihet detyrimi I një shteti për konfiskim, me çrast nëse pala që ka marrë nga një palë tjetër një kërkesë konfiskimi lidhur me instrumentet ose produktet që ndodhen në territorin e saj duhet të ekzekutojë vendimin e konfiskimit që del nga një gjykatë e palës kërkuese lidhur me këto instrumente ose këto produkte ose t'ia paraqesë këtë kërkesë autoriteteve të veta kompetente për të marrë një vendim konfiskimi dhe, kur ky është dhënë, atëherë ai ekzekutohet.¹³⁸

¹³⁷ Neni 7.

¹³⁸ Ibd., neni 13 paragrafi 1.

3. Konventa e Varshavës ose Konventa e këshillit të europës për pastrimin, depistimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe financimin e terrorizmit

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe shtetet e tjera nënshkruese të kësaj Konvente, janë të bindur se lufta kundër krimeve të rënda dhe pastrimit të parave, të cilët janë bërë gjithnjë e më shumë problem ndërkombëtar, kërkon përdorimin e metodave moderne dhe efektive në shkallë ndërkombëtare. Njëra prej këtyre metodave konsiston në privimin e kriminelëve nga produktet e krimit dhe instrumenteve për kryerjen e tyre. Në vazhdim dhe të Konventës së Këshillit të Evropës të vitit 1990, dhe për arritjen e këtij qëllimi dhe të rritjes së efektivitetit të luftës kundër pastrimit të parave, në Varshavë më 16 Maj 2005 u miratua Konventa e Këshillit të Evropës "Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit". Kjo konventë është nënshkruar nga Republika e Maqedonisë më 17.11.2005 ndërsa është ratifikuar 27.05.2005 dhe ka hyrë në fuqi më 01.09.2009.

Krahas detyrimeve që çdo palë të marrë masa legislative dhe masa të tjera të nevojshme, për të kriminalizuar financimin e terrorizmit, për të bërë të mundur të kërkojë, ndjekë, identifikojë, ngrijë, bllokojë dhe konfiskojë pasuri me origjinë të ligjshme dhe të paligjshme, të përdorur ose të destinuar për t'u përdorur me çdo mjet, pjesërisht ose tërësisht, për financimin e terrorizmit, ose fitimet e kësaj vepre penale dhe të sigurojë bashkëpunim për këtë qëllim në masën më të gjerë të mundshme.

Kjo konventë parasheh detyrimin e palëve nënshkruese që të ndërmarrin ato masa legislative dhe të tjera të nevojshme për të siguruar që masat për ngrirjen, bllokimin dhe konfiskimin të përfshijnë edhe pasurinë në të cilën janë transformuar ose konvertuar produktet, pasurinë e përfutur nga burime të ligjshme, nëse timet janë përzier, pjesërisht ose tërësisht, me një pasuri të tillë, deri në vlerën që vlerësohen timet e përziera, të ardhurat ose privilegje të tjera që rrjedhin nga timet, nga pasuria në të cilën janë transformuar ose konvertuar produktet nga krimi ose nga pasuria me të cilën janë përzier produktet nga krimi, deri në vlerën e që vlerësohen fitimet e përziera, në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtën masë sa edhe fitimet. Detyrimi tjetër I cili parashihet për shtetet nënshkruese është ndërmarrja e masave legislative dhe masa të tjera të nevojshme për të siguruar menaxhimin e duhur të pasurisë së ngrirë ose të bllokuar.¹³⁹

¹³⁹ Neni 5 dhe 6.

Detyrimi I shteteve për ndihmë prashihet në këtë konventë. Palët do t'i japin njëra-tjetrës në shkallën më të lartë të mundshme, asistencë për identifikimin dhe ndjekjen e mjeteve, produkteve dhe pasurive të tjera që i nënshtrohen konfiskimit. Kjo asistencë do të përfshijë çdo masë që jep dhe garanton prova në lidhje me ekzistencën, vendndodhjen ose lëvizjen, natyrën, statusin ligjor apo vlerën e pasurisë së sipërpërmendur.¹⁴⁰

4. Konventa e Kombeve të bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe të lëndëve psikotrope

Qëllimi i kësaj Konvente është që të nxisë bashkëpunimin midis shteteve në mënyrë që ato të mund t'i trajtojnë në mënyrë më të efektshme aspektet e ndryshme të Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope që ka marrë përmasa ndërkombëtare. Gjatë zbatimit të detyrimeve të tyre, që rrjedhin nga kjo konventa shtete duhet të marrin masat e nevojshme, duke përfshirë masa legjislative dhe administrative, në përputhje me dispozitat themelore të sistemeve ligjore respektive të vendeve të tyre.¹⁴¹

Konventa parasheh detyrimin e secilës palë, sipas nevojës, të adoptojë masat për të parashikuar si veprimtari kriminale në bazë të ligjit të vendit të vet, kur kryhet në mënyrë të qëllimshme: shkëmbimin ose transferimin e pasurive duke ditur se këto pasuri kanë rrjedhur nga një veprimtari të kundërligjshme ose veprimtari të kundërligjshme ose nga akti i pjesëmarrjes në një veprimtari të kundërligjshme ose veprimtari të kundërligjshme të tilla, me qëllimin e fshehjes ose mbulimit të origjinës së paligjshme të pasurive ose me qëllimin e dhënies së ndihmës ndonjë personi që është përfshirë në kryerjen e një veprimtarie të kundërligjshme ose veprimtarive të kundërligjshme të tilla, për t'iu shmangur pasojave ligjore të veprimeve të tij, si dhe fshehjen ose mbulimin e natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, sistemimit, lëvizjes, të drejtave në lidhje me pasurinë ose pronësinë e pasurisë, duke ditur se një pasuri e tillë ka rrjedhur nga një veprimtari të kundërligjshme ose veprimtari të kundërligjshme ose nga akti i pjesëmarrjes në një veprimtari të kundërligjshme ose veprimtari të kundërligjshme të tilla.¹⁴²

Sipas kësaj konvente secila palë duhet, kur ta shohë të nevojshme, të marrë masa për të mundësuar konfiskimin e fitimeve që rrjedhin nga veprimtari të kundërligjshme të parashikuara në konventë, ose të pasurive, vlera e të cilave korrespondon me vlerën e këtyre

¹⁴⁰ Neni 16.

¹⁴¹ Neni 2.

¹⁴² Ibid., neni 3.

fitimeve dhe drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope, materialeve dhe pajisjeve ose mjeteve të tjera që janë përdorur ose që synojnë të përdoren në çfarëdo mënyre në veprimtaritë e kundërligjshme të parashikuara në konventë. Secila palë duhet, kur ta shohë të nevojshme, të marrë masa për të mundësuar autoritetet e veta kompetente të identifikojnë, të gjurmojnë dhe të ngrijnë ose të shtien në dorë fitimet, pasurinë, mjetet ose çdo gjë tjetër me qëllimin e një konfiskimi të mundshëm. Me qëllim që të zbatojë masat e parapara në konventë, secila alë duhet t'u japë fuqi të plotë gjykatave ose autoriteteve të tjera kompetente që të urdhërojnë që dokumentacioni bankar, financiar se tregtar të vihet në dispozicion ose të shtihet në dorë. Pala nuk duhet të refuzojë që të veprojë në bazë të dispozitave të këtij paragrafi për arsye të sekretit bankar.¹⁴³

¹⁴³ Neni 5.

ANALIZA E TË DHËNAVE STATISTIKORE PËR MASAT E SHQIPTUARA TË KONFISKIMIT DHE MARRJES SË SENDEVE DHE DISA RASTE TË KONFISKIMIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

1. Analiza e të dhënave statistikore nga Enti për statistika i Republikës së Maqedonisë

Gjatë hulumtimit të temës kam analizuar disa të dhëna të cilat janë marrë nga Enti shtetëror për statistika sa i përket numrit të masave të shqiptuara të konfiskimit për periudhën kohore prej vitit 2012 – 2016, pastaj kam analizuar raportet e Agjencionit për menaxhim me pronën e konfiskuar për periudhën kohore 2012 – 2015 dhe të dhënat nga Gjykata themelore Tetovë. Të dhënat e analizuar nga Gjykata themelore Tetovë kanë të bëjnë vetëm me marrjen e sendeve për periudhën 2013 – 2017 por jo edhe për masat e shqiptuara të konfiskimit pasi që gjykata nuk mban evidencë të posaçme për këto lloj masash.

Tabela 1. Numri i masave të shqiptuara konfiskim i pronës dhe dobisë pasurore në Republikën e Maqedonisë në vitin 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016

Viti kalendarik	2012	2013	2014	2015	2016
Gjithsejt	56	53	133	125	55
Vepra penale kundër jetës dhe trupit			3	1	5
Vepra penale kundër shëndetit të njerëzve	8	3	14	11	5
Vepra penale kundër pronës	9	8	4	30	19
Vepra penale kundër financave publike qarkullimit pagesor dhe ekonomisë	11	29	27	37	10
Vepra penale kundër sigurisë në komunikacionin publik			3	1	2
Vepra penale kundër qarkullimit juridik	1		4	3	9
Vepra penale kundër rendit publik	5		4	19	4
Vepra penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare	13	2	6	6	1
Vepra penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit	1			3	

Vepra penale kundër mjedisit jetësor dhe natyrës	1	1		1	
Vepra penale kundër detyrës zyrtare	6	10	66	12	
Vepra penale nga ligje të veçanta			2	1	
Vepra penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pronës	1				

Duke e analizuar tabelën e mësipërme nga të dhënat e Entit shtetëror për statistika në Republikën e Maqedonisë, mund të konstatojmë se masa e konfiskimit është shumë pak e shprehur duke pasur parasysh se të dhënat janë të grumbulluara nga të gjitha gjykatat në Republikën e Maqedonisë.

Në vitin 2012 gjithsejt janë shqiptuar 56 masa të konfiskimit të pronës dhe dobisë pasurore. Për veprat penale kundër pasurisë kjo masë është shqiptuar në tre raste për veprë penale jedhje, një jedhje e rëndë, një Mashtrim dhe tre raste tek vepra penale detyrim. Në 11 raste të veprave penale kundër finansave publike dhe qarkullimit pagesor, konfiskimi është shqiptuar në për veprë penale Larje e parave dhe të ardhurave të tjera nga vepra e dënueshme dhe për vepra penale Evazion fiskal. Një herë kojo masë është shqiptuar për veprë penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm, për veprën penale Keqpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit, një veprë penale falsifikim dokumenti, një veprë penale Bashkim kriminal, për veprë penale Mbajtje e palejuar e armëve. Konfiskimi në vitin 2012 është shqiptuar më së shumti për veprat penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare dhe atë për tre raste të veprës penale Tregëti me person të mitur dhe vepra penale të tjera.

Në vitin 2013 gjithsejt janë shqiptuar në 53 raste, që nuk paraqet ndonjë dallim të madh nga viti 2012. Më së shumti konfiskimi është shqiptuar për veprat penale kundër finansave publike dhe qarkullimit pagesor dhe atë për veprë penale Larje e parave dhe të ardhurave të tjera nga vepra e dënueshme, për Tregëti të palejuar, për Mashtrim doganor, për evazion fiskal dhe tre raste për vepra të tjera penale. Pastaj vijojnë veprat penale kundër detyrës zyrtare ku masa e konfiskimit është shqiptuar për dhjetë raste të keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe autorizimit. Për vepra penale kundër pronës janë shqiptuar gjithsejt 8 masa dhe atë dy për vjedhje të rëndë, një për mashtrim dhe 5 masa të konfiskimit për veprë penale Dëmtim dhe hyrje e palejuar në sistem kompjuterik. Në tre raste konfiskimi është shqiptuar për Prodhim i paautorizuar dhe lëshimi në qarkullim i drogave narkotike substancave prikotrope dhe prekursorëve.

Vii 2014 paraqet vitin në të cilin konfiskimi është shqiptuar më së shumti. Numri më i madh i veprave penale për të cilat është shqiptuar kjo masë është për veprat penale kundër detyrës zyrtare. Dhe atë konkretisht për vepër penale Keqpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit. Pastaj vijojnë veprat penale kundër financave publike, qarkullimit pagesor dhe ekonomisë ku më së shumti kjo masë është shqiptuar për larje parash, evazion fiskal dhe falsifikim të parave. Në 14 raste konfiskimi është shqiptuar për veprat penale kundër shëndetit të njerëzve dhe kryesisht për vepër penale Prodhim i paautorizuar dhe lëshimi në qarkullim i drogave narkotike substancave prikotrope dhe prekursorëve dhe mundësim të përdorimit të drogave narkotike substancave prikotrope dhe prekursorëve. Për veprat penale të tjera kjo masë është më pak e shqiptuar dhe atë për veprat penale vjedhje e rëndë, ndërtim i palejuar dhe mashtrim si vepra penale kundër pronës dhe rrezikim i sigurisë në komunikacion, falsifikim dokumenti dhe përdorim të dokumentit me përmbajtje jo të vërtetë, bashkim kriminal, mbajtje e palejuar e armëve, kontrabandë me emigrantë dhe për vepra penale si vrasje, lëndim trupor dhe rrezikim me mjet të rezikshëm gjatë rahjes ose zënkës.

Për periudhën e caktuar, shohim se edhe në vitin 2015 janë shqiptuar numër më i madh i masës së konfiskimit pas vitit 2014 dhe numri i masave të shqiptuara të konfiskimit është përafërsisht i njëjtë për veprat penalesi në vitin 2014. Numri më i madh i masave të konfiskimit është shqiptuar për veprat penale kundër qarkullimit pagesor dhe ekonomisë dhe atë më së shumti për vepra penale larje parash dhe përpunim dhe përdorim i kartelës së rrejshme pagesore, falsifikim parash dhe evazion fiskal. Pastaj vijojnë veprat penale kundër pronës ku konfiskimi është shqiptuar për vepra penale si vjedhje, vjedhje e rëndë, mashtrim, mbulim i vepër penale, vjedhje grabitqare dhe të tjera. Në grupin e veprave penale kundër rendit publik konfiskimi është shqiptuar në 19 raste dhe atë për vepra penale bashkim kriminal. Tek veprat penale kundër detyrës zyrtare masa e konfiskimit është shqiptuar për kërje të veprës penale keqpërdorim i detyrës zyrtare dhe pranim i shpërblimit për ndikim të kundërligjshëm. Ashtu si edhe në vitet e mëparshme edhe këtë vit për veprat penale Prodhim i paautorizuar dhe lëshimi në qarkullim i drogave narkotike substancave prikotrope dhe prekursorëve konfiskimi është shqiptuar disa herë përkatësisht 10 herë dhe një herë për mundësim të përdorimit të drogave narkotike substancave prikotrope dhe prekursorëve. Në këtë vit konfiskimi është shqiptuar edhe tek veprat penale vrasje, cenim i të drejtës së autorit, falsifikim parash, kontrabandë me emigrantë dhe tjera.

Në vitin 2015 vërejmë një rënie të numrit të masave të shqiptuara të konfiskimit për dallim nga dy vitet e mëparshme. Konfiskimi në vitin 2016 është shqiptuar në 55 raste dhe atë më së shumti për vepra penale kundër financave dhe qarkullimit pagesor dhe siç janë

përpunim dhe përdorim i kartelës së rrejtshme pagesore, kontrabandë, evazion fiskal, cenim i të drejtave të pronësisë industriale. Pastaj tek veprat penale kundër pronës konfiskimi është shqiptuar për vepra penale vjedhje, vjedhje e rëndë, mbulim i veprës penale. Kjo masë është shqiptuar edhe për vepër penale falsifikim dokumenti, rrezikim i sigurisë në komunikacion, tregti me njerëz, bashkim kriminal, armëmbajtje pa leje, dhunë dhe tjera.

Tabela 2. Numri i masave të shqiptuara “marrje e sendeve” në Republikën e Maqedonisë në vitin 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016

Viti kalendarik	2012	2013	2014	2015	2016
Gjithsejt	864	827	1041	968	760
Vepra penale kundër jetës dhe trupit	36	32	35	30	33
Vepra penale kundër shëndetit të njerëzve	195	212	263	232	185
Vepra penale kundër pronës	161	202	146	184	133
Vepra penale kundër financave publike qarkullimit pagesor dhe ekonomisë	39	63	54	82	40
Vepra penale kundër sigurisë në komunikacionin publik	11	11	16	9	13
Vepra penale kundër qarkullimit juridik	121	58	73	50	73
Vepra penale kundër rendit publik	130	78	192	137	126
Vepra penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare	54	73	110	177	75
Vepra penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit	11	18	6	13	11
Vepra penale kundër mjedisit jetësor dhe natyrës	45	26	23	10	14
Vepra penale kundër detyrës zyrtare	27	22	84	16	12
Vepra penale nga ligje të veçanta	4	3	17	7	11
Vepra penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pronës	18	15	10	4	5
Vepra penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor	2	7		3	2
Vepra penale kundër martesës, familjes dhe rinisë	1	2		1	4
Vepra penale kundër trashigimisë kulturore	3		1	2	4
Vepra penale kundër jurisprudencës	4	5	5	10	7

Vepra penale kundër zgjedhjeve dhe votimit			4		
Vepra penale kundër shtetit			2	1	11
Vepra penale kundër marrdhënieve të punës					1

Nga tabela nr.2 mund të vërehet se në periudhën kohore prej vitit 2012 – 2016 nuk ekziston ndonjë dallim i madh në numrin e masave të shqiptuara për marrjen e sendeve.

Mund të konstatojmë se kjo masë duke e pasur parasysh edhe natyrën e saj, në periudhën e dhënë kohore është shqiptuar më së shumti për veprat penale kundër shëndetit të njerëzve e që kryesisht në të gjithë periudhën e dhënë kohore ka të bëjë me vepër penale Prodhim i paautorizuar dhe lëshimi në qarkullim i drogave narkotike substancave prikotrope dhe prekursorëve dhe mundësim të përdorimit të drogave narkotike substancave prikotrope dhe prekursorëve. Pastaj për nga numri i masave të shqiptuara pasojnë veprat penale kundër pronës ku përfshihen veprat penale vjedhje, vjedhje e rëndë etj.

Më pas marrja e sendeve është shqiptuar në numër të madh edhe për veprat penale kundër rendit publik dhe veprat penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare, ku vërehet një ritje të shqiptimit të kësaj mase të këto lloje të veprave penale në vitet 2014, 2015 dhe 2016 e që ka të bëjë veçanërisht me vepër penale trafikim me migrantë, si pasojë e krizës së migrantëve në këtë periudhë kohore.

Për shkak edhe të natyrës së disa veprave penale, duke e pasur parasysh edhe mënyrën e kryerjes së tyre, marrja e sendeve shqiptohet shumë pak të këto lloje të veprave penale, këtu përfshihen veprat penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor, vepra penale kundër martesës, familjes dhe rinisë, vepra penale kundër trashigimisë kulturore, vepra penale kundër jurisprudencës, vepra penale kundër zgjedhjeve dhe votimit, vepra penale kundër shtetit, vepra penale kundër marrdhënieve të punës dhe vepra penale nga ligje të veçanta.

Tabela 3. Numri i masave të shqiptuara “marrje e sendeve” në Gjykatën themelore Tetovë në vitin 2013, 2014, 2015, 2016 dhe 2017

Viti kalendarik	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsejt	100	55	96	69	66
Vepra penale kundër jetës dhe trupit	6	5	22	6	12
Vepra penale kundër shëndetit të njerëzve	24	12	26	24	20
Vepra penale kundër pronës	17	9	12	12	14
Vepra penale kundër financave publike qarkullimit pagesor dhe ekonomisë	2	3			2
Vepra penale kundër sigurisë në komunikacionin publik	1	1	1	2	1
Vepra penale kundër qarkullimit juridik	2			1	
Vepra penale kundër rendit publik	6	13	12	8	9
Vepra penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit	3	3	4	2	2
Vepra penale kundër detyrës zyrtare				1	
Vepra penale të tjera	27	4	13	11	2
Vepra penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pronës		3	3	1	1
Vepra penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor	2	1	1		3
Vepra penale kundër zgjedhjeve dhe votimit		1			
Vepra penale kundër detyrës zyrtare			2		
Vepra penale kundër jurisprudencës				1	

Nga të dhënat e marra në Gjykatën themelore Tetovë për numrin e masave të shqiptuara marrje e sendeve, të paraqitura në tabelën nr.3 mund të konstatojmë se kjo masë është e shqiptuar shpesh dhe atë më së shumti për veprat penale kundër shëndetit të njerëzve, kundër pronës, rendit publik etj.

Te veprat penale kundër shëndetit nga të dhënat konstatojmë se kjo masë është shqiptuar më së shumti tek veprat penale Prodhim i paautorizuar dhe lëshimi në qarkullim i drogave narkotike substancave prikotrope dhe prekursorëve dhe mundësim të përdorimit të drogave narkotike substancave prikotrope dhe prekursorëve. Te veprat penale kundër pronës marrja e sendeve është shqiptuar më së shumti për veprat penale si vjedhje, vjedhje e rëndë, mashtrim

etij. Ndërsa te veprat penale kundër rendit publik kjo masë është shqiptuar më së shumti te veprat penale armëmbajte pa leje.

2. Analizimi i të dhënave të Agjencionit për menaxhim me pronën e konfiskuar për periudhën 2012 - 2015

Në vitin 2012 te Agjencioni për menaxhim me pronë të konfiskuar nga ana e gjykatave janë dorëzuar aktgjykime me të cilat nga të dënuarit duhet të konfiskohet dobia pasurore. Gjatë ekzekutimit të këtyre aktgjykimeve Agjencioni has në probleme të ndryshme për arsye se në të njëjtat nuk përcaktohet se cila pasuri duhet të konfiskohet përkatësisht për cilën pasuri duhet që të ekzekutohet aktgjykimi, ndërsa në shumicën e rasteve nuk janë shqiptuar masa për sigurimin e pasurisë nga personat e dënuar.¹⁴⁴ Në raportin e Agjencionit për menaxhim me pasurisë e konfiskuar nuk janë të dhëna numrat për shumën e përgjithshme të konfiskuar me vendime të plotëfuqishme gjyqësore por vetëm janë përmendur disa raste më specifike të konfiskimit të cilat i ka realizuar Agjencioni.

Gjatë vitit 2013 Agjencioni ka pranuar rreth 50 aktgjykime të plotëfuqishme gjyqësore për konfiskimin e dobisë paurore. Edhe gjatë vitit 2013 Agjencioni ka vazhduar me arkëtim dhe ka treguar suksese të konsiderueshëm në ekzekutimin e aktvendimeve që ka rezultuar me arkëtimin në buxhetin e Republikës së Maqedonisë të një shume parash prej 261.357.000,00 denarë ose 4.249.700,00 euro.¹⁴⁵ Në bazë të konfiskimit të dobisë pasurore nga personat e dënuar janë konfiskuar disa paluajtshmëri dhe me aktvendim të Agjencionit për menaxhim me pronë të konfiskuar ato janë bartur në pronësi të Republikës së Maqedonisë. Për një pjesë të këtyre paluajtshmërive është realizuar edhe vlerësim nga ana e Birosë për ekspertiza gjyqësore në shumë të përgjithshme prej 18.442.000,00 denarë ose 299.900,00 euro.

Për paluajtshmëritë e konfiskuara Agjencioni është drejtuar tek Ministria e drejtësisë Biroja për ekspertiza gjyqësore për të bërë vlerësimin e paluajtshmërive të konfiskuara me qëllim që për të njëjtat të realizohet procedura e shitjes. Për një pjesë të paluajtshmërive Agjencioni ka dorëzuar kërkesë për shpërngulje dhe zbrazje të pronës nga njerëzit dhe sendet me qëllim që paluajtshmëria të merret në pronësi të Republikës së Maqedonisë për tu realizuar vlerësimi dhe të fillohet procedura e shitjes. Sa u përket paluajtshmërive të cilat

¹⁴⁴ Raporti vjetor për vitin 2012 i Agjencionit për menaxhim e pronës së konfiskuar, dobisë pasurore dhe sendeve të marra në procedurën penale dhe kundërvajtëse.

¹⁴⁵ Raporti vjetor për vitin 2013 i Agjencionit për menaxhim e pronës së konfiskuar, dobisë pasurore dhe sendeve të marra në procedurën penale dhe kundërvajtëse.

duhet të konfiskohen për një pjesë të tyre ka barrë përkatësisht hipotekë në bazë të marrjes së kredisë nga banka apo ndonjë lloj tjetër huazimi.

Sa i përket konfiskimit të pasurisë dhe dobisë pasurore Agjencioni për menaxhimin e pronës së konfiskuar në vitin 2014 ka arkëtuar pasuri (patundshmëri, akcione, mjete financiare) në shmë prej 118.302.032,00 denarë.¹⁴⁶ Pas dorëzimit të aktgjykimeve të plotëfuqishme për ekzekutim nga ana e gjykatave Agjencioni ka filluar me procedurat për gjetjen e pasurisë së të akuzuarve nga të cilët konfiskohet dobia pasurore në dobi të Republikës së Maqedonisë. Edhe gjatë vitit 2014 Agjencioni ka bërë arkëtimin e pasurisë me çka ka treguar një sukses të veçantë në ekzekutimin e aktgjykimeve çka ka rezultuar edhe me arkëtimin e mjeteve në të holla në këtë bazë në llogarinë e Agjencionit për menaxhim me pronën e konfiskuar dhe atë me vlerë prej 66.716.662,00 denarë, nga të cilat në buxhetin e Republikës së Maqedonisë janë paguar 16.900.000,00 denarë. Në bazë të konfiskimit të dobisë pasurore nga personat e dënuar janë konfiskuar disa paluajtshmëri dhe me aktvendim të Agjencionit për menaxhim me pronë të konfiskuar ato janë bartur në pronësi të Republikës së Maqedonisë. Për një pjesë të këtyre paluajtshmërive është realizuar edhe vlerësim nga ana e Birosë për ekspertiza gjyqësore në shumë të përgjithshme prej 51.585.370,00 denrë.

Sa u përket paluajtshmërive në vitin 2014 janë konfiskuar gjithsejt 14 paluajtshmëri që përbëhen nga ndërtesa, banesa, shtëpi private, toka ndërtimore, të cilat kanë kaluar në pronësi të Republikës së Maqedonisë ose është realizuar procedura e shitjes së tyre. Për një pjesë të paluajtshmërive Agjencioni ka dorëzuar kërkesë për shpërngulje dhe ybrayje të pronës nga njerëzit dhe sendet me qëllim që paluajtshmëria të merret në pronësi të Republikës së Maqedonisë për tu realizuar vlerësimi dhe të fillohet procedura e shitjes.

Gjatë vitit 2015 Agjencioni për menaxhim me pronësn e konfiskuar në pajtim me Planin akcional për shitjen e pronës së konfiskuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka bërë shitjen e pasurisë së konfiskuar dhe sendeve të marra si paluajtshmëri. Në pajtim me detyrimet e dhëna në nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë Agjencioni për menaxhim me pronën e konfiskuar ishte i detyruar që të sjellë aktvendim për shitjen e pronës së luajtshme – duhan me çka në pajtim me çmimin e shitjes në llogarinë e veçantë të Agjencionit janë arkëtuar 35.398.073 denarë. Shitja e sendeve të tjera të luajtshme është bërë për një shumë prej 31.300,00 deanrë. Nga shitja e pasurisë së paluajtshme të konfiskuara me aktgjykim të plotfuqishëm në vitin 2014, tre patundshmërive në Gostivar janë arkëtuar 2.109.000,00 dhe një patundshmërie në Kumanovë janë arkëtuar 421.200,00. Në vitin 2014 Agjencioni me

¹⁴⁶ Raporti vjetor për vitin 2014 i Agjencionit për menaxhim e pronës së konfiskuar, dobisë pasurore dhe sendeve të marra në procedurën penale dhe kundërvajtëse..

shitjen e pronës së konfiskuar ka realizuar një shumë prej 37.507.073,00 të cilat janë arkëtuar në buxhetin e RM-së. Përveç procedurave të lartpërmendura kanë filluar procedura për shitjen e paluajtshmërive të tjera, akcioneve në disa shoqëri tregtare, automjete të vlerësuara si hekur i vjetër të cilat nuk kanë vlerë përdoruese etj. Sa i përket konfiskimit të pasurisë dhe dobisë pasuroe Agjencioni për menaxhimin e pronës së konfiskuar në vitin 2014 ka arkëtuar pasuri (patundshmëri, akcione, mjete financiare) në shumë prej 326.676.545,00 denarë.

Edhe gjatë vitit 2015 Agjencioni ka bërë arkëtimin e pasurisë me çka ka treguar një sukses të veçantë në ekzekutimin e aktgjykimeve çka ka rezultuar edhe me arkëtimin e mjeteve në të holla në këtë bazën llogarinë e Agjencionit për menaxhim me pronën e konfiskuar dhe atë me vlerë prej 317.925.545,00 denarë, nga të cilat në buxhetin e Republikës së Maqedonisë janë paguar 329.000.000,00 ден. Kjo shumë është më e madhe sepse disa mjete gjatë muajit dhjetor të vitit 2014 janë paguar në buxhet në vitin 2015.¹⁴⁷

Në bazë të konfiskimit të dobisë pasurore nga personat e dënuar janë konfiskuar disa paluajtshmëri dhe me aktvendim të Agjencionit për menaxhim me pronë të konfiskuar ato janë bartur në pronësi të Republikës së Maqedonisë.

Gjatë vitit 2015 Agjencioni për menaxhim me pronën e konfiskuar në pajtim me Planin akcional për shitjen e pronës së konfiskuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka bërë shitjen e pasurisë së konfiskuar dhe sendeve të marra si paluajtshmëri, sende të luajtshme, akcione etj.

Nga raportet e Agjencionit konstatojmë se ky institucion vepron gjithmonë nëse ka vendim të plotfuqishëm për konfiskim sepse nuk mund të iniciojë procedurë të konfiskimit nëse nuk ka urdhër nga gjkata.

3. Disa raste të konfiskimit në Republikën e Maqedonisë

Rasti I

Në vitin 2006 çobani i njohur I.Xh. ka aritur që nga shteti të përfitojë përafërsisht 730.000,00 euro për granatimin e stanit të tij gjatë konfliktit të vitit 2001. Edhe pse organet kompetente pas një viti e kanë zbuluar skemën kriminale të I.Xh. dhe bashkëpunorëve të tij (noterë, avokatë, funksionarë shtetëror) ajo i ka kushtuar shtetit rreth 5 milion euro. Në momentin kur mjetet duhej të kthehen në buxhetin e Republikës së Maqedonisë u vërtetua se

¹⁴⁷ Raporti vjetor për vitin 2015 i Agjencionit për menaxhim e pronës së konfiskuar, dobisë pasurore dhe sendeve të marra në procedurën penale dhe kundërvajtëse.

një pjesë e pronës së patundshme të I.Xh. është nën hipotekë. Hipotekat u anuluan por ajo i shkaktoi një dëm të vërtetë shtetit.

I akuzuari i parë në këtë rast N.S. që nga fillimi i punës së tij si noter, ka kryer shërbime noteriale për të akuzuarin e dytë I.Xh. Në pajtim me nenin 32 paragrafi 3 të Ligjit për Kryerjen e Çështjeve të Noterisë, nuk ishte e lejuar të punonte njëkohësisht si avokat. Megjithatë, në kundërshtim me nenin e cituar, pasi i akuzuari I.Xh. ka pranuar të paraqitet si paditës, N.S ka ngritur padi kundër Republikës së Maqedonisë. Qëllimi për të shkaktuar pagesën e dëmeve për shkak të kafshëve të vrara dhe të dëmtuara në stanin e I.Xh. si rezultat i raketimit të kryer më 27 qershor 2001 nga helikopterët e ARM-së (gjatë konfliktit ushtarak në Republikën e Maqedonisë), pati sukses. Me vërtetime veterinarë të rreme, ata vërtetuan se 2,150 krerë dele, 17 lopë, 13 viça dhe 22 kuaj u vranë në sulmin e kryer nga helikopterët.

Pas sjelljes së aktgjykimit nga ana e Gjykatës themelore Shkup 1 Shkup nr. 2904/01 datë 18.06.2004, e paditura RM- Ministria e mbrojtjes ka qenë e detyruar që të akuzuarit I.Xh. në emër të kompensimit të dëmit to paguajë shumën prej 25.177.868,00 denarë me kamatë të llogaritur prej 11.12.2001 deri në pagesën përfundimtare si dhe ti kompenzojë shpenzimet e procedurës në shumë prej 206.180,00 denarë. Me ekzekutim të detyrueshëm pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nga llogaria e Ministrisë së mbrojtjes në llogarinë e I.Xh. janë lëshuar 44.462.585,00 denarë. Më vonë paratë janë lëshuar edhe në llogari të huaja. Fakti se i akuzuari I.Xh. me këtë mënyrë të bartjes së parave ka fshehur se të njëjtat rrjedhin nga vepra penale e kryer, të cilat i ka pranuar duke e ditur e rrjedhin nga vepra penale, është vërtetuar nga rethana se po të ishte kryer raketim i stanit të tij dhe kafshët të cilat ai thotë se janë vranë, pjesa më e madhe e vlerës së vërtetuara me aktgjykim ai do ta kishte marrë me vete, dhe nuk do ti kishte bartur paratë në pjesën më të madhe personave të tjerë, dhe atë atyre personave për të cilët ai thotë se as nuk ka marrë hua e as me të njëjtët ka pasur ndonjë marrëdhënie detyrimore.

Një pjesë nga këto para marrin rrjedhë tjetër. Me këto para janë bërë malverzime përkatësisht kontrata fiktive të huasë hipotekare me të cilat një person i huazon një personi tjetër një shumë të caktuar parash dhe e vë në hipotekë pronën e paluajtshme si garancë për huanë e marrë. Por duke e marrë parasysh faktin se nuk mund ti kthejë paratë huadhënësi e aktivizon hipotekën dhe e merr pronën e vënë në hipotekë. Në këtë mënyrë shteti është dëmtuar për një shumë rreth 5 milion euro ndërsa trashëgimtarët e pronës së denacionalizuar kanë qenë të dëmtuar për një shumë prej 40 mijë euro. Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor dhe të ekzekutueshëm të Gjykatës themelore Shkup 1 Shkup K. Бр. 297/07, e sjellur më

12.04.2007, të akuzuarit janë shpallur fajtor për veprat penale keqpërdorim të detyrës zyrtare, mashtrim, larje parash dhe të ardhurave të tjera nga vepra penale.¹⁴⁸

Në rastin “Baçillo” nga ana e Gjykatës themelore Shkup 2 Shkup është përfunduar me plotfuqishmëri procedura me të cilën janë anuluar hipotekat fiktive dhe të kontestueshme kurse nga ana e Agjencionit për menaxhim me pronën e konfiskuar është sjellë aktvendim për bartjen e pronësisë mbi paluajtshmëritë që kanë qenë lëndë e këtij kontesti.

Rasti II

Me aktgjykim të plotfuqishëm të Gjykatës themelore Shkup 1 Shkup KOK nr. 2/08 të datës 30.10.2008, M.M. është dënuar me dënim me burgim prej 4 vjet për veprën penale Larje parash dhe të ardhurave të tjera nga vepra penale. Me këtë aktgjykim nga i dënuari është marrë në dobi të Republikës së Maqedonisë dobi pasurore direkte dhe indirekte dhe të ardhura të tjera nga vepra penale në vlerë prej 544.207.000,00 denarë (rreth 9 milion euro). I dënuari ka qenë i detyruar që në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e vendimit ta ekzekutojë vendimin dhe ti paguajë mjetet në dobi të Republikës së Maqedonisë por nuk e ka bërë. Për këtë arsye me qëllim të ekzekutimit të aktgjykimit në dobi të Republikës së Maqedonisë janë marrë paluajtshmëri dhe letra me vlerë nga firmat në pronësi të dënuarit.¹⁴⁹

Rasti III

Me aktgjykim të plotfuqishëm Gjykatës themelore Shkup 1 Shkup K.nr. 1049/99 datë 22.12.2005, Zh.E. i cili ka qenë pronar i firmës Famatek nga Resnja është dënuar për vepër penale keqpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit dhe nga i njëjti është sekuestruar dobia e fituar nga vepra penale në vlerë prej 58.652.000,00 denarë. I dënuari ka qenë i detyruar që në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit ta kompenzojë dobinë pasurore në vlerë prej 58.652.000,00 denarë. Pasi i akuzuari nuk e ka përmbushur detyrimin në afatin e caktuar për këtë vlerë janë konfiskuar nga ai shtëpi dhe vila private.¹⁵⁰

Rasti IV

Në aktgjykim të plotfuqishëm Gjykatës themelore Shkup 1 Shkup K.nr. 809/05 datë 19.06.2008, dy persona janë të dënuar me 7 vjet burg përkatësisht 4 vjet e 6 muaj për kryreje

¹⁴⁸ <https://www.akademik.mk/sudenje/bachilo/>

¹⁴⁹ http://www.pravda.gov.mk/documents/konfiskacija_nova_0209010_2.ppt.

¹⁵⁰ http://www.pravda.gov.mk/documents/konfiskacija_nova_0209010_2.ppt.

të veprave penale keqpërdorim i detyrës zyrtare dhe falsifikim dokumenti. Me aktgjykim nga i dënuari konfiskohet dobi pasurore në vlerë prej 103.575.167,00 denarë dhe të dy të dënuarit detyrohen që në mënyrë solidare të kthejnë në buxhetin e Republikës së Maqedonisë këtë shumë. Pasiqë në afatin e caktuar nuk e kanë përmbushur detyrimin e dhënë me aktgjykim të plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm nga personat e lartpërmendur janë marrë paluajtshmëri dhe të njëjtat janë bartur në pronësi të Republikës së Maqedonisë dhe atë hapsirë afariste në sipërfaqe prej 202 m² dhe tokë ndërtimore me sipërfaqe 540 m² në komunën e Kumanovës.¹⁵¹

Rasti V

Me aktgjykim të plotfuqishëm të Gjykatës themelore Shkup 1 Shkup K.nr. 1534/06 të datës 28.11.2007, i akuzuari K.K. është akuzuar për vepër penale keqpërdorim i detyrës zyrtare me dënim me burgim prej 6 vjetësh. Me aktgjykim nga i dënuari konfiskohet dobia pasurore në shumë prej 97.612.997,00 në dobi të Republikës së Maqedonisë. I dënuari në afatin e paraparë nuk e ka përmbushur vullnetarisht detyrimin e caktuar me aktgjykim prandaj nga ai janë marrë pjesët që i takojnë në personin juridik SLLAVIJA 1 SHPK eksport import Shkup të cilat kanë qenë në pronësi të tij, në vlerë prej 218.667 euro.¹⁵²

Rasti VI

Një rast I rëndësishëm i konfiskimit I cili është I njohur si “Merimanga” ku me vendim të Gjykatës themelore Shkup 1 Shkup më 14.03.2011 është sjellë aktgjykimi I plotëfuqishëm dhe i ekzekutueshëm VI KOK nr.23/11 i cili është vërtetuar me aktgjykim të Gjykatës së apelit Shkup KOKЖ.бp.43/12 datë 25.02.2013. në këtë aktgjykim në pajtim me nenin 97 dhe 98 të Kodit penal, sloidarisht, nga televizioni A1 dhe personat e dënuar është konfiskuar dobi pasurore e cila përbëhet nga para me vlerë të përgjithshme prej 286.731.676,50 denarë e cila është fituar me shmangjen e pagesës së tatimit dhe kontributeve ndaj shtetit në vlerë prej 8.469.523,00 denarë të cilat janë fituar me mospagimin e detyrimeve tatimore ndaj shtetit. Më tej, në këtë aktgjykim është theksuar se nëse konfiskimi nuk do të mund të realizohet nga personat e dënuar fizik dhe juridik, do të konfiskohet edhe çdo lloj tjetër pasurie os prone, ose aktive, të drejta materiale ose jomateriale, si dhe pasuri tjetër e cila përgjigjet vlerës së fituar të dobisë pasurore, ndërsa një pjesë e pronës është e siguruar përkohësisht me aktvendim të gjykatësitet hetues. Në agjencionin për menaxhim me pronë të

¹⁵¹ http://www.pravda.gov.mk/documents/konfiskacija_nova_0209010_2.ppt.

¹⁵² http://www.pravda.gov.mk/documents/konfiskacija_nova_0209010_2.ppt.

konfiskuar nga ana e Gjykatës themelore Shkup 1 Shkup përkrah aktgjykimit janë dorëzuar edhe aktvendimet e lartpërmendura me të cilat është sigurur pasuria e cila duhet të konfiskohet në pajtim me aktgjykimin e plotëfuqishëm dhe atë në rastin konkret për televizionin A1 është dorëzuar aktvendim me të cilin bëhet ngrirja e përkohshme dhe mbajtja e shumës së parave prej 124.223.343,00 nga llogaritë bankare të personit juridik Televizioni A1. Agjencioni ka vepruar sipas urdhëresës për ekzekutim të Gjykatës themelore Shkup 1 Shkup si dhe aktvendimeve për sigurimin e përkohshëm të pasurisë nga ku del se ekziston bazë për konfiskim të shumës pasurore prej 124.223.343,00 denarë nga llogaritë bankare të personit juridik Televizioni A1.¹⁵³

Rasti VII

Konfiskimi i pasurisë së paluajtshme në vitin 2015 kryesisht ka të bëjë me rastin e njohur si “Kerozin”ku me aktgjykim të plotëfuqishëm gjyqësor gjashtëmbëshjetë të akuzuar janë shpallur fajtorë dhe janë dënuar me mbi 80 vjet burgim. Ato janë të dënuar nën akuzën se si grup kriminal nëpërmjet firës negociuese “Alma Komerc” kanë furnizuar më pak naftë nga ajo që është paraparë me kontratë për furnizimr publike dhe me këtë e kanë dëmtuar buxhetin e Republikës së Maqedonisë me reth 3 milionë euro. Dënimet në këtë rast kanë të bëjnë me veprat penale bashkim kriminal, evazió n fiskal dhe dhënie të mitos.¹⁵⁴ Nga personi juridik “Alma Komerc Angel Pecov SHPK eksport – import Negotinëjanë konfiskuar ndërtesa, banesa, shtëpi private, toka ndërtimore.¹⁵⁵

Rasti VIII

Në rastin e njohur si “Pepel 2 Bajrush dhe të të tjerë” me aktgjykim të plotëfuqishëm të Gjykatës themelore Shkup 1 Shkup, është dhënë urdhër që të sekuestrohet dhe të konfiskohet nga të dënuarit, ku janë përfshirë paluajtshmëri të firmave për të cilat kontratat për shitje janë anuluar dhe është urdhëruar që kjo pasuri të konfiskohet. Nga ana e Agjencionit me aktvendim për bartjen e pronësisë e cila është dorëzaur edhe te Agjencioni për kadastrën e paluajtshmërive, është urdhëruar marrja e pasurisë në pajtim me aktgjykimin.

Nga të gjitha këto raste tek të cilat është realizuar konfiskimi konstatojmë se kjo masë është e realizueshme edhe pse ajo është e rrallë. Për realizimin e konfiskimit në praktikë duhet

¹⁵³ Raporti vjetor për vitin 2013 i Agjencionit për menaxhim me pronë të konfiskuar.

¹⁵⁴ <https://www.akademik.mk/apelatsija-gi-namali-kaznite-za-del-od-osudenite-vo-kerozin-3/>

¹⁵⁵ Raporti vjetor për vitin 2015 i Agjencionit për menaxhim me pronë të konfiskuar

që të ekzistojë bashkëpunimi ndërmjet shumë institucioneve të cilat kanë kompetenca që të ndërmarrin veprime lidhur me konfiskimin. Domethënë se përveç gjykatave të cilat e sjellin vendimin për konfiskim duhet që prokuroria të propozojë konfiskim dhe të bëjë të besueshme se një kryes i veprës penale ka përfituar dobi pasurore të paligjshme, prandaj barra nuk ngelet vetëm tek gjykata.

PËRFUNDIM

Në luftën kundër kriminalitetit shtetet kanë në disponim masa të shumta ligjore. Një ndër këto masa është edhe konfiskimi i pasurisë dhe dobisë pasurore dhe marrja e sendeve të fituara me vepër penale. Edhe pse kjo masë është e karakterit të dhunshëm, retributiv dhe zbatohet ndaj kryerësit të veprës penale kundër vullnetit të tij, pa dyshim kjo masë ka një domethënie të madhe preventive dhe atë si në aspektin e preventivës gjenerale ashtu edhe speciale. Me zbatimin e kësaj mase kryerësit të veprës penale por edhe kryerësve të tjerë potencialë të veprave penale u jepet një sinjal se me kryerjen e veprës penale nuk mund të risin pasurinë e tyre.

Republika e Maqedonisë në legjislacionin e saj penal ka bërë reforma të shumta sa i përket konfiskimit të pasurisë dhe dobisë pasurore. Konfiskimi i pasurisë dhe dobisë pasurore dhe i marrjes së sendeve rregullohet në Kodin penal të Republikës së Maqedonisë ndërsa procedura për konfiskim rregullohet në Ligjin e procedurës penale.

Përmbajtja e kësaj mase të veçantë pealo-juridike është marrja e detyrueshme nga kryerësi i veprës penale ose nga persona të tretë, e dobisë pasurore direkte apo indirekte e cila është e fituar me vepër penale. Askush nuk mund ta mbajë dobinë pasurore direkt apo indirekt të fituar me vepër penale. Dobia pasurore konfiskohet me vendim gjyqësor me të cilën është vërtetuar kryerja e veprës penale, sipas kushteve të parapara me ligj. Baza e saj është parimi i drejtësisë se nga padrejtësia nuk mund të bëhet drejtësi. Përpos dobisë pasurore direkt të fituar me vepër penale, kodi penal parasheh se nga kryesi i veprës penale do të konfiskohet edhe dobia e indirekte e cila përbëhet nga pasuria në të cilën është transformuar apo shëndruar dobia e fituar me vepër penale, prona e fituar nga burime ligjore në qoftë se dobia e fituar me vepër penale është e përzier, pjesërisht ose tërësisht, me atë pronë,

Si risi më e rëndësishme në Kodin penal paraqitet konfiskimi i zgjeruar, si një masë me të cilën realizohet efekti i konfiskimit të dobisë pasurre të fituar me kryerjen e veprës penale. Konfiskimi i zgjeruar aplikohet vetëm tek disa vepra penale të veçanta siç janë vepra penale të kryera në shoqëri kriminale, veprat penale të larjes së parave ose terorizmit. Nga kryesi i veprës penale e cila është kryer në kuadër të shoqërisë kriminale me të cilën realizohet dobi pasurore dhe për të cilën është paraparë dënim me burg më së paku katër vjet si dhe veprat penale në lidhje me terorizmin për të cilat është paraparë dënim me burg nga pesë vjet ose dënim më i rëndë ose është e lidhur me kryerjen e veprës penale larje parash për të cilën është paraparë dënim me burg më së paku katër vjet, do të konfiskohet pasuria e fituar

në periudhën kohore para dënimit të cilën gjyqi e përcakton sipas rrethanave të rastit por jo më i gjatë se pesë vjet para kryerjes së veprës penale, kur në bazë të të gjitha rrethanave gjyqi me bazë është i bindur se prona i tejkalon të arduart ligjore të kryesit dhe rrjedh nga ajo vepër penale. Kjo pronë konfiskohet edhe nga anëtarët e familjes si dhe personat e tretë për të cilat është realizuar me krerjen e veprës penale. Kjo pronë konfiskohet edhe nga anëtarët e familjes së kryerësit tek të cilët është bartur kur është e dukshme se nuk kanë dhënë kundërkompensim i cili korespondon me vlerën e saj ose nga personat e tretë nëse nuk dëshmojnë se për sendin apo pasurinë kanë dhënë kundërkompensim i cili i përgjigjet vlerës së tij.

Sendet të cilat janë paraqitur nga kryerja e veprës penale apo të cilat kanë qenë të destinuara ose të përdorura për kryerjen e veprës penale do të merren nga kryerësi pa marrë parasysh se a janë pronë e tij apo pronë e ndonjë personi të tretë nëse këtë e kërkojnë interesat e sigurisë së përgjithshme, shëndeti i njerëzve apo arsytet e moralit.

Procedura për konfiskim dhe marrjen e sendeve është e rregulluar me Ligjin për procedurë penale. Ligji i procedurës penale përcakton mënyrën e zbatimit të masës së konfiskimit por edhe marrjes së sendeve të fituar me vepër penale si një masë siguroese për konfiskim i cili do të shqiptohet me aktgjykimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor. Kështu, në ligjin për procedurë penale parashihet marrja e perkohshme e sendeve. Sendet që sipas Kodit penal duhet të merren ose që mund të sherbejnë si prova në procedurën penale perkohesisht do të konfiskohen dhe do t'i dorezohen në ruajtje prokurorit publik ose organit të percaktuar me ligj të veçante ose në menyre tjeter do të sigurohet ruajtja e tyre. Marrja e sendeve dhe konfiskimi i dobisë pasurore të fituar me vepër penale bëhet pasiqë të jetë shpallur fajtor i akuzuari me aktgjykim të plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm gjyqësor.

Kur janë të plotësuar kushtet për konfiskim gjyqi me propozim të prokurorit publik mund të urdhërojë sjelljen e masave të perkohshme për sigurimin e pasurisë. Këto masa mundet që të zbatohen e edhe ndaj personave të tretë kur ekziston dyshimi se te ato persona është bartur pasuria dhe dobia pasurore pa kompensim adekuat. Kjo zgjidhje ligjore është e nevojshme pasiqë kriminelët të cilët përfitojnë dobi pasuri nga kryerja e veprës penale shpesh e fshin pasurinë e tyre duke e bartur atë pasuri te persona të tretë. Në praktikë shpesh hasen raste ku me aktgjykim të plotfuqishëm është urdhëruar konfiskimi i pasurisë por ky aktgjykim nuk mund të realizohet në praktikë pasiqë i akuzuar nuk ka anjë lloj pasurie mbi të cilën do të mund të realizohej konfiskimi. Prandaj edhe ligji ka paraparë ngrirjen e perkohshme të pasurisë si masë sigurimi që ajo pasuri të konfiskohet pasiqë të shpallet fajtor i akuzuari. Githashtu edhe çdo disponim i pasurisë ose të gjitha veprimet mbi pronen dhe sendet që jane

lende e sigurimit e të cilat janë ndermarre pas parashtrimit të kërkeses për konfiskim, janë të pavlefshme. Pasi që të ketë përfunduar procedura penale me sjelljen e aktgjyqkimit shqiptohet edhe masa e marrjes së sendeve.

Me ligjin për menaxhimin me pronen e konfiskuar, me perfitimin pronesor dhe me sendet e konfiskuara në procedurën penale dhe kundervajtese, në Republikën e Maqedonisë është themeluar Agjencia për menaxhimin me pronen e konfiskuar e cila menaxhon me perfitimin pronesor dhe me sendet e konfiskuara në procedurën penale dhe kundervajtese, me qëllim administrimin e produkteve të sekuestruara dhe të konfiskuara. Krijimi i kësaj agjencie ka sjellë përqendrimin, e produkteve të sekuestruara dhe të konfiskuara në një institucion të vetëm. , rregullohet menaxhimi, shfrytëzimi dhe disponimi me pronen e konfiskuar perkoheisht, me perfitimin pronesor dhe me sendet e konfiskuara perkoheisht, si edhe me pronen e konfiskuar, me perfitimin pronesor dhe me sendet e konfiskuara me vendim të plotfuqishem në procedurën penale dhe të kundervajtjes, si edhe themelimi, kompetencat, menaxhimi, udheheqja dhe çështjet të tjera, që kanë të bëjnë me punën e Agjencisë për menaxhimin me pronen e konfiskuar.

Në Republikën e Kosovës konfiskimi i pasurisë dhe dobisë pasurore është i rregulluar me Kodin penal dhe Ligjin për procedurë penale. Sipas Kodit penal të Republikës së Kosovës, konfiskimi parashihet si dënim plotësues. Ligji i procedurës penale i Republikës së Kosovës parasheh dy lloje procedurash të konfiskimit dhe atë para ngritjes së aktakuzës dhe pas ngritjes së aktakuzës.

Në Republikën e Shqipërisë njeihen dy lloje konfiskimesh të produkteve të veprave penale, atë brenda procedimit penal ose i quajtur ndryshe konfiskimi i produkteve të veprave penale dhe atë jashtë procedimit penal ose i quajtur ndryshe procedimi parandalues. Konfiskimi penal në Shqipëri ka qenë pjesë integrale e dënimit penal dhe tradicionalisht e ka shoqëruar atë. Ai është parashikuar në të drejtën materiale penale. Konfiskimi jashtë procedimit penal në Shqipëri, ndryshe nga ai penal, është një risi për sistemin Shqiptar të së drejtës,. Në ligjin ‘antimafia’ konfiskimi parashikohet si masë parandaluese dhe zbatohet për pasuritë e personave mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicie për një sërë veprash penale, si krim i organizuar dhe trafikim, pastrim parash, etj. Për këtë arsye konfiskimi është një procedim i veçantë i pavarur nga procesi penal, ndaj garancitë e procesit penal nuk mund të gjejnë zbatim në procesin e konfiskimit.

Konsideroj se konfiskimi i vlerës rezulton si modeli më i mirë ligjor për privimin e autorëve të veprave penale nga përfitimet e paligjshme, pasi ai vepron mbi autorin e veprës

penale. Ai normalisht mund të zbatohet edhe në pronën e cila është fituar ligjërisht dhe nuk ka lidhje me veprën penale për të cilën është urdhëruar konfiskimi.

Pavarësisht se masa e konfiskimit të pasurisë dhe dobisë pasurore dhe marrjes së sendeve në legjislacione të ndryshme është e rregulluar në mënyra të ndryshme, mund të konstatoj se ekzistimi i kësaj mase në legjislacionet pozitive të shteteve moderne është më se i domosdoshëm pasi që masat ekzistuese të cilat i kanë shtetet në disponim nuk zbatohen në praktikë dhe nuk janë të mjaftueshme për luftimin dhe parandalimin e suksesshëm të kriminalitetit.

BIBLIOGRAFIA

LIBRA

1. Kadriu, Osman. *Hyrje në të drejtën civile*, Tringa Design, Tetovë 2008
2. Kambovski, Vllado & Zejneli, Ismail. *E drejta penale*, Pjesa e përgjithshme, Tetovë 2018.
3. KAMBOVSKI, Vllado. *E drejta penale; pjesa e përgjithshme*, Furkan ISM, Shkup 2007.
4. SAHITI, Ejup & ZEJNELI Ismail. *E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë*, Universiteti i Europës juglindore në Tetovë, Fakulteti i drejtësisë, Tetovë 2017.
5. SAHITI, Ejup. *E drejta e procedurës penale*, Universiteti i Prishtinës në Prishtinë, Fakulteti juridik, Prishtinë 2005.
6. Камбовски, Владо. *Научен и практичен коментар на Кривичниот законик на Република Македонија*, Второ изменето издание, Матица, Скопје 2015

BURIME TË TJERA

7. *Analizë mbi kornizën ligjore kundër pasurisë së përvetësuar në mënyrë të paligjshme*, Publikim i lëvizjes FOL, Prishtinë 2011.
8. Brun, Jean-Pierre & Gray, Larissa & Scott, Clive & M. Stephenson, Kevin. *Asset Recovery Handbook A Guide for Practitioners*, The International Bank for Reconstruction and Development The World Bank, 2011
9. Граѓанскoправно одузимање (конфискација in rem), Појашњење и студија о uticaju, Savet Evrope Kancelarija u Beogradu, Beograd 2013
10. HAZIRI, Fatos. *Vështrim krahasues juridikopenal i fenomenit të shpërlarjes së parave në Kosovë dhe disa shtete të Bashkimit evropian dhe ballkanit perendimor*, JURIDICA, Instituti Evropian për Studime Juridike dhe Administrim Publik, Prishtinë 2015
11. Manual on International Cooperation for the Purposes of Confiscation of Proceeds of Crime, United Nations, New York 2012
12. *Pandëshkueshmëria në Kosovë: Pasuria e pajustificueshme*, Publikuar nga Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave, Prihtinë 2013
13. *Veprimi kundrejt reformimit, Konfiskimi i pasurisë në Kosovë*, Publikuar nga Organizata për Demokraci, Antkorrupsion dhe Dinjtet, Çohu!, Prishtinë 2017.

14. VESELI, Latif. *Luftimi I korupsionit dhe konfiskimi I dobisë pasurore të fituar me vepër penale*, JURIDICA, Instituti Evropian për Studime Juridike dhe Administrim Publik, Prishtinë 2011.
15. ИНГИЛИЗОВА – РИСТОВА, Лилјана. *Конвенција на обединетите нации против транснационалниот организиран криминал и казната – конфискација на имот*, Судиска ревија, Здружение на судиите на Република Македонија, Година VIIIбр.4/2002, Скопје 2002.
16. КАМБОВСКИ, Владо & МИСОСКИ, Бобан. *Материјално - правни и процесно - правни аспекти на конфискацијата на имотна корист и на имот*, Истражување во рамки на проектот „Реформа на казненото право и почитување на човековите права - подготовки за доследна примена на новиот ЗКП—, Скопје, 2009.
17. Напредни обуки за новиот ЗКП, МОДУЛ: 2, ИСТРАЖНА ПОСТАПКА – Прирачник, Академија за судии и јавни обвинители “Павел Шатев,, Скопје 2013.
18. Финансиски истраги и конфискација на приходи стекнати од криминал, Прирачник за обука на органите за кривичен прогон и судство, Совет на Европа, 2006

KODE DHE LIGJE

1. Kodi i procedurës penale i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.7905, datë 21.3.1995, ndryshuar me
2. Kodi penal i Republikës së Kosovës nr.04/L-082, *Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.19/13*
3. Kodi penal i Republikës së Maqedonisë *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 37/1996, 80/1999, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/11, 135/11, 185/11, 142/12, 166/12, 55/13, 82/13, 14/14, 27/14, 28/14, 115/14, 132/14 u 160/14*
4. Kodi penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7895 datë 27.1.1995.
5. Ligji i procedurës penale, *Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.37/2012 datë 28.12.2012*
6. Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë 2/2006*
7. Ligji për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfitur me vepër penale, nr. 04/1-140
8. Ligji për menaxhimin me pronen e konfiskuar, me perfitimin pronesor dhe me sendet e konfiskuara në procedurën penale dhe kundervajtese, *Gazeta zyrtare e Republikës së*

Maqedonisë nr.98/2008, 145/10, 104/2013, 187/13, 43/14, 160/14, 97/15, 148/15, 64/18

9. Ligji për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, nr. 10 192, datë 3.12.2009
10. Ligji për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, nr. 9284 datë 30.09.2004
11. Ligji për përmbarrim, *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë 72/2016*
12. Ligji për procedurë penale i Republikës së Maqedonisë, *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010*
13. Ligji për pronësi dhe të drejtat e tjer sendore (*Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.18/2001*)

KONVENTA NDËRKOMBËTARE

1. Konventa e Këshillit të Europës për pastrimin, depistimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe financimin e terrorizmit
2. Konventa e Kombeve të bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar
3. Konventa e Kombeve të bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe të lëndëve psikotrope
4. Konventa europiane për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit